



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
TATIMEVE

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
TATIMEVE

Tiranë, Shtator 2023

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	6
II.	HYRJA	6
1.	Objekti i auditimit	6
2.	Qëllimi i auditimit	7
3.	Identifikimi i çështjes	7
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	7
5.	Përgjegjësitë e audituesve	7
6.	Kriteret e vlerësimit	7
7.	Standardet e auditimit	8
8.	Metodat e auditimit	8
9.	Dokumentimi i auditimit	8
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	8
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	9
2.1	Veprimet Operacionale	
a.	Menaxhimi i ndryshimeve dhe veprimeve operacionale në proceset e informatizuara	9-15
b.	Përdoruesit e sistemeve, administrimi i të drejtave dhe siguria	15-21
2.2	Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit	
a.	Investimet në teknologjinë e informacionit	21-22
b.	Marrëveshjet e nivelit të shërbimit	22-55
2.3	Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input / Output	56-62
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	
A.	Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	63-63
B.	Masa Organizative	63-70

✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

KLSH	- Kontrolli i Lartë i Shtetit
DPT	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
AKSHI	- Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit
AKCESK	- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKSHI	- Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit
VKM	- Vendim i Këshillit të Ministrave
TIK	- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TI (IT)	- Teknologji Informacioni
COBIT-	- Objektivat e kontrollit për Teknologjinë e Informacionit
ISSAI	- Standardet Ndërkombëtare të institucioneve Supreme të Auditimit
AK	- Autoriteti Kontraktor
OE	- Operator Ekonomik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nga data 27.04.2023 deri në 14.07.2023.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në DPT, është pjesë e Planit Vjetor 2023 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH.

Përzgjedhja e këtij subjekti, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që janë zhvilluar nga DPT dhe në rastet kur vetë insituicioni ka qenë përfitues shërbimi i kontratave që janë lidhur nga AKSHI.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 359/1, me datë 27.04.2023.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Ref. me Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi u konstatua se sistemi e-Taxation është transferuar nga një infrastrukturë kritike në një infrastrukturë të rëndësishme me përditësimet e infrastrukturave miratuar me VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave”, megjithëse rëndësia e tij është jetike jo vetëm për funksionimin e DPT, por për të gjithë sistemet informatike me të cilat japin dhe marrin të dhëna në sistemin e-Taxation. Të dhënat e sistemit e-Taxation i nevojiten dhe sistemit të Fiskalizimit, ku të dhënat e tatimpaguesve kalojnë në sistemin e Fiskalizimit në fund të çdo dite që do të thotë se në mungesë të të dhënave nga e-Tax funksionimi i rregullt i Fiskalizimit është i cenuar në lidhje me: subjektet e reja, ndryshimet e të dhënave për statusin e aktivitetit, niveli i taksimit, ndryshimet tek punonjësit si dhe kalimi automatik i librave të shitjes dhe të blerjes. Sistemi i pajisjeve fiskale Nexus i kategorizuar si sistem kritik nuk është më në përdorim.	Faqe 57-63	e Lartë	Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit të marrin masa për të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimet për ndryshimet ligjore në Shtojcën 1 të VKM nr.761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, ku sistemi e-Taxation nga një sistem i rëndësishëm në Shtojcën 2 të kategorizohet si një sistem kritik në Shtojcën 1, ndërsa sistemi Nexus nga sistem kritik i përcaktuar në Shtojcën 1 të hiqet nisur nga fakti që ky sistem nuk është aktualisht në përdorim nga DPT.

2	<p>Nga auditimi u konstatua se pajisjet fizike të sistemit e-Taxation janë në një situatë tejet kritike, një sistem ky shumë i rëndësishëm për DPT, nisur nga veprimet operacionale që kryhen aty si nga ana e biznesit, administratës tatimore ashtu dhe nga institucionet e tjera me të cilat janë ndërtuar ndërveprime me të dhëna të këtij sistemi. Ky konstatim bazohet në të dhënat mbi hapësirën e lirë në servera dhe në storage e cila paraqitet rreth masës 90 %, pra pothuajse në ezaurim. Megjithëse gjatë auditimit në terren u hap procedura për mirëmbajtjen e sistemit e-Taxation, ne vlerësojmë se ndërprerja nuk do të mund të sigurohet, për arsye se sistemet informatike nuk mund të jenë funksional nëse pajisjet janë në ezaurim të hapësirës së tyre dhe funksionojnë në limitet e ciklit jetësor dhe me sisteme operimi jashtë suportit teknik që do të thotë i pasigurt. Mundësia për ndërprerjen dhe pamundësia për ta venë në funksion në një kohë të shkurtër sistemin e-Taxation është shumë e lartë.</p> <p>Hapësira fizike e zënë për serverët dhe pajisjet storage me përfundimin e auditimit në terren ishte në masën 90%, pothuajse në ezaurim. Hapat e ndërmarrë ndërmjet DPT-s dhe AKSHI-t për rinovimin e pajisjeve fizike ku qendron sistemi e-Taxation janë në nivel diskutimi dhe akoma nuk është arritur në një vendimmarrje. DPT ka planifikuar një fond për të cilin AKSHI shprehet se nuk është i mjaftueshëm, por në kushtet kur DPT nuk i disponon më asetet rrjedhimisht planifikimi i fondeve për rinovim duhet të plotësohet nga administratori dhe poseduesi i këtyre asetëve që është AKSHI.</p>	Faqe 57-63	e Lartë	<p>Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin masa për të siguruar pajisjet fizike që nevojiten të rinovohen ku qendron i hostuar sistemi informatik e-Taxation, si një sistem i cili ndodhet në kushtet teknike në ezaurim dhe me mundësi të lartë të ndërprerjes së funksionimit, çfarë do të pengonte aktivitetin e DPT-s dhe të institucioneve të tjera të cilat marrin të dhëna nga ky sistem.</p>
3	<p>Nga auditimi u konstatua se, problemet dhe incidentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh dhe në mungesë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedurave të standardizuara mbi ndryshimet, incidentet dhe problemet që kryhen në teknologjinë e informacionit, përfshirë dhe ato emergjente; - Dokumentimit dhe aprovimit të ndryshimeve që janë kryer në teknologjinë e informacionit dhe sistemet informatike që mbështesin aktivitetin e institucionit. 	Faqe 10-15	e Lartë	<p>Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë TIK të AKSHI-t, atashuar pranë DPT, të marrin masa për hartimin e procedurave të standardizuara për ndryshimet që kryhen në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet emergjente. Gjithashtu, DPT të sigurohet për dokumentimin specifik të çdo ndryshimi, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe impaktin që kanë sjellë ndryshimet e aplikuara në sistem e rrjedhimisht në të dhëna.</p>

4	Nga auditimi u konstatua se DPT nuk disponon një infrastrukturë Business Continuity Center (BCC), si dhe nuk ka një plan mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjet nga katastrofat në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.	Faqe 15-22	e Lartë	Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pa ndërprerje për sistemet informatike, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për hartimin dhe miratimin e një plani mbi vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat.
---	--	------------	---------	---

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, grupi i auditimit konstaton se pajisjet fizike ku hostohet sistemi e-Taxation, i cili përmban të dhëna të rëndësishme për vendin dhe jetike për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, janë në ezaurim të hapësirës së tyre dhe funksionojnë në limitet e ciklit jetësor, si dhe me sisteme operimi jashtë suportit teknik çka do të thotë që operojnë në kushte jo optimale sigurie. Në aktet ligjore mbi infrastrukturën kritike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, nuk e kanë vlerësuar me rëndësi kritike sistemin e-Taxation, duke mos krijuar kushtet për përmbushjen në kohë të detyrimeve për sigurinë kibernetike të kësaj infrastrukture. Aksesimi në të dhëna nga struktura TIK e AKSHI-t atashuar pranë DPT, menaxhimi i pagjurmueshëm i ndryshimeve të funksionaliteteve të sistemeve, si dhe monitorim jo i vazhdueshëm i aksesit të përdoruesve, mund të krijojnë hapësira për veprime në tejkalim të kompetencave të AKSHI-t. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si administrator i të dhënave, nevojitet të luajë rol interaktiv në lidhje me Teknologjinë e Informacionit, për sa kohë në sistemet informatike kryhen veprime nga përdorues të brendshëm dhe të jashtëm dhe të dhënat e sistemeve janë tregues i aktivitetit të institucionit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 359/1, datë 27.04.2023 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 27.04.2023 deri në 14.07.2023, në DPT, ku periudha e audituar është 01.01.2021 deri në 30.04.2023, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. EC, përgjegjëse e grupit;
2. AA, anëtar;
3. AK, anëtare;
4. HK, anëtar.

II.1 Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatorë, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2 Qëllimi i auditimit

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve TIK dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efikente.

II.3 Identifikimi i çështjeve

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 359/1 Prot, datë 27.04.2023:

1. Veprimet Operacionale
 - a. Menaxhimi i ndryshimeve dhe veprimeve operacionale në proceset e informatizuara.
 - b. Përdoruesit e sistemeve, administrimi i të drejtave dhe siguria.
2. Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit
 - a. Investimet në teknologjinë e informacionit.
 - b. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit.
3. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input / Output

II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Misioni i Administratës Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar. Për arritjen e këtyre qëllimeve, Administrata Tatimore i asiston tatimpaguesit me shërbime në mënyrë që ata t'i përmbushin vetë detyrimet e tyre tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Administrata Tatimore është e ngarkuar me ligj dhe e detyruar që, të monitorojë, të vlerësojë dhe të ndëshkojë, çdo sjellje të çdo tatimpaguesi, që nuk zbaton, keq zbaton me dashje apo jo, përmbushjen e detyrimeve ligjore. Administrata Tatimore është mbështetëse për qeverinë, në hartimin e politikave tatimore.

II.5 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi DPT, mbi periudhën e veprimtarisë prej datës 01.01.2021 deri në 30.04.2023, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, si dhe standardeve ndërkombëtare të Teknologjisë së Informacionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 359/1 Prot., datë 27.04.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon DPT, si dhe legjislacioni për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

II.6 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit, si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji për procedurat tatimore dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij rregullojnë procedurat për administrimin e detyrimeve tatimore, parimet e organizimit e të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligj nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 945, datë 2.11.2012 “Për miratimin e rregullores “administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”;
- VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”, i ndryshuar;
- VKM nr.553, datë 15.7.2020 “për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të Rëndësishme të informacionit”
- VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të këshillit të ministrave, “për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”
- Rregulloret e miratuara nga AKCESK;
- Standardet TIK, etj.

II.7 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

II.8 Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Dokumentacioni i arkivuar i dosjeve të prokurimit, etj.

II.9 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është një nga institucionet më të rëndësishme në vend me mision mbledhjen e të ardhurave tatimore. Zhvillimi i teknologjisë së informacionit në DPT ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë këtyre viteve. Sistemet informatike janë shumë të rëndësishme në DPT pasi aty mbështetet aktiviteti institucional dhe arritja e objektivave.

Me vendimin nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” i ndryshuar, DPT ka në institucionin e vet IT të atashuar nga AKSHI dhe nuk ka më një strukturë të vetën për teknologjinë e informacionit që prej vitit 2018. Në fund të vitit 2022 ka përfunduar dhe transferimi tek AKSHI i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit ku përfshihen jo vetëm pajisjet fizike servera, router etj, por dhe sistemet informatike që janë ndërtuar dhe janë funksionale aktualisht.

Kontratat e shërbimit të implementimit dhe mirëmbajtjes janë zhvilluar nga AKSHI i cili është dhe Autoriteti Kontraktor, ndërsa për ndjekjen dhe zbatimin e tyre janë ngritur grupe të përbashkëta ndërmjet AK dhe institucionit përfitues që është DPT.

Me qëllim mbarëvajtjen e shërbimeve TIK, është nënshkruar ndërmjet AKSHI-t dhe DPT-s një marrëveshje bashkëpunimi, protokolluar në AKSHI me shkresën nr. 1745/1 prot., datë 08.04.2019 dhe protokolluar në DPT me nr. 7160 prot., datë 05.04.2019, ku përcaktohet niveli i shërbimit që duhet ti ofrohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

III.2 PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

III.2.1 Veprimet Operacionale

a. *Menaxhimi i ndryshimeve dhe veprimeve operacionale në proceset e informatizuara.*

Procesi i menaxhimit të ndryshimit si dhe kontrollat e ndërtuara mbi të, nevojiten për të siguruar se të gjithë konfigurimet e ndryshimeve të sistemeve janë të autorizuar, testuara, dokumentuara dhe kontrolluara në mënyrë që sistemet të mbështesin operacionet e institucionit dhe që gjithë gjurmët të dokumentohen. Ndryshimi i pa-aprovuar dhe i pa kontrolluar mund të sjellë risqe të ndryshme me impakt funksional apo financiar për institucionin.

Nga auditimi u konstatua se, nuk disponohen procedura të standardizuara mbi ndryshimet që kryhen në teknologjinë e informacionit, përfshirë dhe ato emergjente. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve nuk rezulton të ketë dokumentuar dhe miratuar ndryshimet që janë kryer në teknologjinë e informacionit dhe sistemet informatike që mbështesin aktivitetin e institucionit gjatë periudhës së audituar. Megjithëse procesi i punës ka vijuar dhe ndryshimet në sisteme kanë ndodhur çdo herë që ka rezultuar e nevojshme, DPT nuk rezulton të ketë dokumentuar, vlerësuar, prioritarizuar, testuar dhe rishikuar nga ana e saj. Aprovimi i çdo ndryshimi në sistem nuk ka marrë miratim nga strukturat përkatëse përgjegjëse të DPT-s për impaktet e mundshme që sjellë secili prej tyre. Nuk ka asnjë dokument gjurmueshmërie për kalimet nga testimet në sistemin “Live”.

Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë dhe në shqyrtim edhe Rregulloren “Për Sigurinë e Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, miratuar me nr. 12445/1 prot., datë 03.07.2020, me objekt përcaktimin e parimeve dhe rregullave të Përgjithshme të Sigurisë së Informacionit në DPT dhe përcaktimin e përgjegjësive që lidhen me sigurinë me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aseteve të informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në këtë rregullore përcaktohet se:

- Përpara se të bëhen zhvillime/ndryshime aplikimesh, duhet të hartohen masa/procedura sigurie, të miratuara nga Drejtorja TIK e AKSHI-t në DPT;
- Të gjitha ndryshimet në pajisjet dhe në sistemet që përpunojnë informacionin, duhet ti nënshtrohen procedurave zyrtare të administrimit të ndryshimeve;
- Për sistemet e informacionit, duhet të hartohet dhe mbahet në mënyrë të vazhdueshme një regjistër që mbulon të gjitha asetet kryesore për çdo sistem duke përfshirë: asetet e informacionit, programet dhe asetet fizike;

- Gjithashtu, për krijimin e çdo lloj programi i cili kalon në tre ndarje logjike dhe zakonisht edhe fizike të mjediseve të cilat janë Zhvillim, Testim dhe Produkt duhet të bëhet në përputhje me procedurat e Administrimit të ndryshimeve në DPT të cilat kërkojnë ndjekjen e disa hapave të cilat dokumentohen deri në funksionimin në mjedisin produkt;
- Për të gjitha rastet e ngjarjeve që lidhen me sigurinë duhet të ndiqet një procedurë formale për raportimi e incidenteve;
- Sipas rregullores mbi të cilën kryhen detyrat funksionale në DPT përcaktohet se të gjitha procedurat që lidhen me teknologjinë e informacionit duhet të dokumentohen.

Menaxhimi i incidenteve dhe problemeve ka si qëllim të zgjidhë çështjet nëpërmjet investigimit dhe me analiza të thella, të incidenteve të mëdha ose të përsëritura, për të gjetur shkakun e ndodhjes. Pasi problemi është identifikuar dhe është kryer analiza e gjetjes së shkakut, më tej të zhvillohet një zgjidhje për të trajtuar atë dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen. Për këtë duhet të ketë procedura të dokumentuara për zbulimin dhe regjistrimin e kushteve të parregullta.

Ndihma, mbështetja teknike dhe logjike për veprimet operacionale të strukturës së AKSHI-t për Teknologjinë e Informacionit, që ndihmon mbarëvajtjen e punës në DPT, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale ose nëpërmjet e-mail.

Nga auditimi u konstatua se, nuk janë hartuar rregulla apo procedura mbi menaxhimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Për periudhën nën auditim, problemet dhe incidentet janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh dhe janë raportuar nëpërmjet komunikimeve elektronike.

Një tjetër dokument që i është vendosur në dispozicion grupit të auditimit si manual i cili aplikohet nga drejtorja e teknologjisë së informacionit në DPT, në kryerjen e detyrave funksionale të tyre është *“Manuali për Politikën dhe Procedurat e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”*. Ky manual është miratuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve në vitin 2017, periudhë kjo në të cilën struktura e teknologjisë së informacionit ishte pjesë e strukturës së institucionit. Ky manual ka patur si qëllim ofrimin e politikave dhe procedurave që ndiqen në përzgjedhjen e teknologjisë së përdorur nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve.

Nga auditimi u konstatua se, ky manual është i pa përditësuar nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, megjithëse në këtë dokument citohet për azhurnimet e herë pas herëshme që duhet të bëhen në lidhje me këtë manual. Struktura e AKSHI-t për teknologjinë e informacionit i referohet dhe vepron bazuar në këtë manual, megjithëse i papërditësuar me ndryshimet e ndodhura në strukturë dhe në teknologjinë e informacionit të këtij institucioni prej vitit 2017 deri më sot.

Grupi i auditimit ka shqyrtuar edhe marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet AKSHI-t dhe DPT-s, nënshkruar ndërmjet palëve me shkresën nr. 1745/1 prot., datë 08.04.2019 protokolluar në AKSHI dhe me nr. 7160 prot., datë 05.04.2019 protokolluar në DPT, me qëllim përcaktimin e nivelit të shërbimit që AKSHI duhet ti ofrojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas përcaktimeve të Aneksit 1 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje. Synimi i marrëveshjes është ofrimi i shërbimeve me qëllim rritjen e efektivitetit, kufizimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës, etj. Kjo marrëveshje bazohet në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar. Në këtë marrëveshje thuhet se cili është objekti i marrëveshjes, të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit. Një nga pikat e kësaj marrëveshjeje është administrimi i incidenteve, problemeve dhe disponueshmërisë. Ofruesi i shërbimit (AKSHI) duhet të zotërojë një bazë të dhënash të gabimeve të njohura dhe historikun e incidenteve të mëparshme. Me anë

të procedurës së administrimit të problemeve ofruesi i shërbimit (AKSHI) duhet të kryej analizën e prirjes së informacionit për të identifikuar rrënjët e incidenteve dhe mundësitë për të parandaluar ndodhjen e tyre. Ofruesi i shërbimit (AKSHI) duhet të jetë i disponueshëm për të ofruar shërbim në institucionin përfitues të këtij shërbimi që është DPT.

Nga auditimi u konstatua se, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nuk bëhet dokumentimi sipas marrëveshjes, për shërbimet që ofrohen nga AKSHI saktësisht për administrimin e incidenteve, problemeve dhe disponueshmërisë. Gjithashtu, nuk ka raporte monitorimi dhe shërbimi nga AKSHI në kundërshtim me pikën 4 të marrëveshjes në nivel shërbimit ndërmjet dy institucioneve.

Nuk është e dokumentuar ndarja e përgjegjësiave mbi të dhënat, mënyrat se si garantohen si dhe në rast ndërprerje vazhdimësia e ofrimit të shërbimit duke siguruar në këtë mënyrë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për integritetin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre mbi shërbimet TIK të ofruara. Nuk ka zëra specifike dhe të detajuar të shërbimit që i ofrohen këtij institucioni bazuar në specifikat përkatëse të tij.

Në VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *“Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*, i ndryshuar, saktësisht në pikën 18, citohet si në vijim: *“Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018”*. Me Urdhër të përbashkët, janë ngritur grupet e punës për evidentimin e sistemeve IT dhe infrastrukturave hardware, si dhe përcaktimin e listës së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara objekt kalimi kapital. Në zbatim të kësaj VKM-je me urdhër të brendshëm nr. 9379 prot., datë 09.05.2019 është ngritur grupi i punës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të përcaktuar listën e inventarit të aktiveve për infrastrukturën hardware dhe sistemet IT, të DPT-së. Me urdhër të brendshëm nr. 125, datë 29.09.2022 *“Për ngritjen e grupit të punës për kalimin kapital të sistemeve dhe infrastrukturës TIK ekzistuese tek AKSHI”* është caktuar grupi i punës për të ripërcaktuar listën e inventarit të aktiveve për infrastrukturën hardware dhe sistemet e IT dhe të bëhet kalimi i aktiveve në inventar të AKSHI-t konform procedurave ligjore deri në datën 31.10.2022.

Me urdhër të përbashkët nr. 1, datë 19.10.2022 *“Për kalim kapital”* protokolluar në DPT me nr. 13801/10 prot., datë 19.10.2022 dhe në AKSHI me nr. 6541 prot., datë 19.10.2022 për kalimin e kapitalit nga DPT te AKSHI, të sistemeve: Fiskalizimi-t, AEOI-Sistemi i Shkëmbimit të Informacionit, E-TAX si dhe M-TAX (që është versioni mobile i E-Tax).

Nga grupi i punës *“Për kalimin kapital të sistemeve dhe infrastrukturës TIK ekzistuese te AKSHI”* është bërë kërkesë për shtyrje afati deri në datën 30.11.2022 protokolluar në DPT me nr. 18375 prot., datë 28.10.2022.

Në datë 30.11.2022 është mbajtur nga komisionet përkatëse nga DPT dhe AKSHI procesverbali me nr. 13801/11 prot., datë 30.11.2022 në DPT dhe nr. 7535 prot., datë 30.12.2022 në AKSHI, për aktivet që kalojnë për llogari të AKSHI si institucion marrës në ngarkim të këtyre aktiveve.

Me shkresën nr. 7535/1 prot., datë 07.12.2022 nga AKSHI dhe nr. 1380/12 prot., datë 07.12.2022 nga DPT është konfirmuar marrja në dorëzim e aktiveve të pajisjeve teknologjike nga DPT në AKSHI, kjo në përmbushje të VKM nr. 673, datë 22.11.2017.

Grupi i auditimit nga verifikimi në terren saktësisht në DRT Fier ju drejtoi punonjësve në mënyrë anonime një pyetësor me disa pyetje lidhur me problematikat që ata kanë hasur, raportimin dhe zgjidhjen e tyre. U plotësuan 23 pyetësor nga punonjësit që ishin të disponueshëm të cilët ishin përdorues të një ose më shumë sistemeve teknologjike si: CATS, Fiskalizimi, AEOI, Nexus nga të cilët rezultoi se nga pyetjet drejtuar këtyre punonjësve nga grupi i auditimit problematikat më të shpeshta në pothuajse çdo përgjigje të dhënë prej tyre ishin ngadalësimi i veprimtarisë së

sistemeve, apo edhe bllokimi i njërës prej tyre kur hapen dy sisteme në të njëjtën kohë, si dhe problematika tjetër më e hasur ishte vjetërsia e pajisjeve teknologjike. Këto problematika sipas përgjigjeve të punonjësve raportohen te stafi i IT që ushtron funksionin në DRT Fier.

Gjithashtu, u vlerësua si e rëndësishme të testoheshin kontaktet e publikuara në faqen zyrtare web <https://www.tatime.gov.al/c/9/157/drejtore-rajonale> për çdo Drejtori Rajonale Tatimore - DRT. Grupi i auditimit kontaktoi Qendrat e Shërbimit për Tatimpaguesit e Drejtorive Rajonale Tatimore. Procesi i testimit të zhvilluar kishte për qëllim disponueshmërinë dhe mënyrën e raportimit të problematikave që raportohen nga subjektet lokale. Nga testimi i kontakteve rezultoi se dy numra telefoni nuk ekzistojnë, saktësisht Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Tiranë dhe Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Kukës, ndërsa dy numra nuk funksionojnë që i përkasin Qendrës së Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Elbasan dhe Qendrës së Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Lezhë.

Tabela nr. 1: Numrat e telefonit nga Qendrat e Shërbimeve për Tatimpaguesit e DRT-ve

Nr.	Drejtoria Rajonale	Nr. Telefoni	Emri i zyrës	Përgjigjur
1.	Tiranë	04 2425 903	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Tiranë	Nuk ekziston
2.	Durrës	052 222 061	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Durrës	Po
3.	Vlorë	033 237 055	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Vlorë	Po
4.	Berat	032 235 994	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Berat	Po
5.	Fier	034 222 405	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Fier	Po
6.	Elbasan	054 515 001	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Elbasan	Numri nuk funksionon
7.	Korçë	0822 43 304	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Korçë	Jo
8.	Lezhë	0215 22 467	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Lezhë	Numri nuk funksionon
9.	Shkodër	022 254 866	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Shkodër	Po
10.	Dibër	0218 222 29	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Dibër	Jo
11.	Gjirokastrë	084 262 205	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Gjirokastrë	Jo
12.	Kukës	0242 22 628	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Kukës	Nuk ekziston
13.	Sarandë	0852 25 264	Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Sarandë	Po

Burimi: Grupi i auditimit

Në thirrjet e bëra në varësi të përgjigjes së subjekteve u kërkua informacion në lidhje me pyetjen si më poshtë vijon: “*Se si vepron Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit kur subjektet lokale konstatojnë problematika në sisteme?*”

Nga auditimi u konstatua se, problematikat që raportohen nëpërmjet numrit të telefonit të publikuar në faqen web të DPT merren si njoftim dhe raportohen në varësi të situatës që është raportuar. Për këtë nuk ka një regjistër të mbajtur për rastet e raportuara dhe delegimin te personat përgjegjës.

1. Titulli i gjetjes: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon procedura të standardizuara për ndryshimet që kryhen në teknologjinë e informacionit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, problemet dhe incidentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh dhe në mungesë të:

- Procedurave të standardizuara mbi ndryshimet, incidentet dhe problemet që kryhen në teknologjinë e informacionit, përfshirë dhe ato emergjente.
- Dokumentimit dhe aprovimit të ndryshimeve që janë kryer në teknologjinë e informacionit dhe sistemet informatike që mbështesin aktivitetin e institucionit.

Kriteri: Rregullore “Për Sigurinë e Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”, miratuar me nr. 12445/1 prot., datë 03.07.2020. Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit si dhe praktikave më të mira.

Ndikimi/Efekti: Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, mungesë të gjurmueshmërisë së ndryshimeve të ndodhura.

Shkaku: Mos zbatim i Rregullores “Për Sigurinë e Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve” si dhe praktikave më të mira.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë TIK të AKSHI-t, atashuar pranë DPT, të marrin masa për hartimin e procedurave të standardizuara për ndryshimet që kryhen në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet emergjente. Gjithashtu, DPT të sigurohet për dokumentimin specifik të çdo ndryshimi, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe impaktin që kanë sjellë ndryshimet e aplikuara në sistem e rrjedhimisht në të dhëna.

2. Titulli i gjetjes: Manuali për politikave dhe procedurat e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është i papërditësuar me ndryshimet në TIK.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, Manuali për politikave dhe procedurat e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është i pa përditësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, megjithëse në këtë dokument citohet se duhet të bëhen azhurnime të herë pas herëshme. Struktura e AKSHI-t atashuar pranë DPT i referohet dhe vepron bazuar në këtë manual, megjithëse i pa përditësuar me ndryshimet e ndodhura në strukturat përkatëse të dy institucioneve.

Kriteri: Manuali për Politikave dhe Procedurat e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.

Ndikimi/Efekti: Risk në mos përmbushjen e objektivave të përcaktuara dhe kryerje të detyrave jo në përputhje me manualin, si dhe mungesë të ndryshimeve të nevojshme strukturore dhe infrastrukturore.

Shkaku: Mos menaxhimi i ndryshimit në aktet rregullative.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Politikave dhe Procedurave të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, me qëllim reflektimin e ndryshimeve të strukturës dhe të teknologjisë së informacionit, të ndodhura ndër vite.

3. Titulli i gjetjes: Hartimi i një marrëveshje tip dhe jo me specifika të veçanta në përshtatje me shërbimet që DPT ofron.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nuk bëhet dokumentimi sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet DPT dhe AKSHI-t, për shërbimet që ky i fundit ofron, saktësisht për administrimin e incidenteve, problemeve dhe disponueshmërisë. Nuk është e dokumentuar ndarja e përgjegjësisë mbi të dhënat, mënyrat se si garantohen si dhe në rast ndërprerje vazhdimësia e ofrimit të shërbimit duke siguruar në këtë mënyrë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për integritetin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre mbi shërbimet TIK të ofruara.

Kriteri: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet AKSHI-t dhe DPT-s, nënshkruar ndërmjet palëve me shkresën nr. 1745/1 prot., datë 08.04.2019 protokolluar në AKSHI dhe me nr. 7160 prot., datë 05.04.2019 protokolluar në DPT.

Ndikimi/Efekti: Pamundësi në monitorimin e zbatimit të MNSH ndërmjet DPT dhe AKSHI.

Shkaku: Mos hartim i raporteve të parashikuara në marrëveshje.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për rishikimin dhe zbatimin e Marrëveshjes në Nivel Shërbimi, duke vendosur zëra të detajuar në përputhje me shërbimet që i ofrohen këtij institucioni.

4. Titulli i gjetjes: Një pjesë e numrave të telefonit për ofrimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve publikuar në faqen web nuk janë funksional.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, nuk ka një regjistër mbi problematikat të çdo Drejtorie Rajonale Tatimore, të cilat raportohen nëpërmjet numrit të telefonit të publikuar në faqen web <https://www.tatime.gov.al/c/9/157/drejtorite-rajonale>, si dhe nuk realizohet delegimi i tyre tek personat përgjegjës.

Nga testimi i numrave të vënë në dispozicion për Tatimpaguesit, rezultoi se:

- Dy numra telefoni nuk ekzistojnë saktësisht Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Tiranë dhe Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Kukës;
- Dy numra nuk funksionojnë që i përkasin Qendrës së Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Elbasan dhe Qendrës së Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Lezhë.

Kriteri: Ligji 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ndikimi/Efekti: Mungesë në shërbimin ndaj taksapaguesve.

Shkaku: Mos funksionimi i numrave të telefonit për ofrimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë masa për vënien në funksion të numrave të kontaktit që janë të afishuar në faqen web për Drejtoritë Rajonale të Tatimpaguesve, me qëllim garantimin e shërbimit kundrejt qytetareve dhe bizneseve.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/10, datë 13.07.2023, si dhe trajtuar në faqet 7-13 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione nga AKSHI me shkresën nr.359/4, datë 04.09.2023 dhe observacione nga DPT me shkresën nr. 359/5, datë 06.09.2023.

Pretendimi i AKSHI-t: AKSHI në përmbushje të rekomandimeve të lëna nga KLSH ka hartuar dhe miratuar versionin 3.0 të dokumentit “Politikat e menaxhimit të ndryshimeve” të cilat janë objekt i përditësimit të vazhdueshëm. Jemi në proces të rishikimit të MNSH-ve me çdo institucion.

Pretendimi i DPT-s: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve shpreh angazhim për përditësimin dhe saktësim të procedurave të ndryshimeve, incidenteve dhe problemeve.

DPT anagazhohet të rishikojë dhe monitorojë marrëveshjen në nivel shërbimi që ofrohet nga AKSHI. DPT do të marrë masa për saktësimin dhe funksionimin e kontakteve të publikuara në faqen zyrtare të DPT-s.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sikurse kemi sqaruar dhe në Projekt raportin e Auditimit, procedura e hartuar nga AKSHI është miratuar gjatë periudhës kur ne kemi qenë në auditim, çfarë vërteton se nuk ka patur një dokument udhëzues mbi ndryshimet që specialistët IT në DPT kryenin në sistemet e DPT-s. Gjithashtu, procedura e menaxhimit të ndryshimeve nuk përcakton institucionin se ku kjo procedurë zbatohet. Ndryshime në sistemet informatike nuk mund të jenë të njëanshme, për sa kohë të dhënat që impaktohen në to janë të DPT-s. Për sa

më sipër, në mungesë të dokumentit të miratuar që ju i referoheni, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

b. Përdoruesit e sistemeve, administrimi i të drejtave dhe siguria.

Rregullorja e brendshme për sigurinë e informacionit me nr. 12445/1prot, datë 03.07.2020 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT-s.

Për zhvillimin e rregullave të komunikimit në DPT është hartuar një Manual për Politikën dhe Procedurat e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Ky manual përshkruan politika dhe procedura që do të ndiqen në përzgjedhjen e teknologjisë së përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë punonjësit dhe shërben si udhëzues për një administrim dhe menaxhim të pajisjeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit.

Mbi verifikimin se si DPT siguron vazhdimësinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat

Auditimi i mbi verifikimin e vazhdimësinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat BCP Business Continuity Plan, dhe BCC- Business Continuity Center, u krye me objektivin për të parë se si DPT ka hartuar plane, politika e investime në rastin e ndodhjes së një fatkeqësie në sistemet TIK të saj për të vazhduar funksionimin kur veprimet operacionale të përditshme janë ndërprerë për realizimin të misionit të Administratës Tatimore në mbledhjen e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

DPT nuk disponon një infrastrukturë BCC - Business Continuity Center të ngritur jashtë ambienteve të DataCenter qendror, në kundërshtim me VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”.

Nuk ka bërë të mundur evidentimin e sistemeve kritike për ofrimin e shërbimit 24 orë në 7 ditë të javës.

DPT nuk disponon dokument të politikave të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (Disaster Recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash.

1.Titulli i Gjetjes: DPT nuk disponon një infrastrukturë BCC, për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se DPT nuk disponon një infrastrukturë Business Continuity Center (BCC), si dhe nuk ka një plan mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjet nga katastrofat në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

Kriteri: Kërkesat për ofrimin e vazhdimësisë bazohen në VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, ku citohet se:

- Pika 1 - “Çdo institucion i cili ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbimit të informacionit për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës (Business Continuity) dhe sistemit të ruajtjes së informacionit (Backup), me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes, ose të shkatërrimit aksidental të të dhënave”;

- Pika 1(c) - “Dokumentimi i politikave mbi planin e vazhdueshmërisë së punës dhe rikuperimit nga katastrofat, si dhe të bëhet i mundur evidentimi i sistemeve të cilat janë kritike për ofrimin e shërbimit 24/7”.

Ndikimi/efekti: humbje e të dhënave , mos mbledhjen e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, mos zbatim njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, mos financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e ofrimin e vazhdimësisë bazuar në VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pa ndërprerje për sistemet informatike, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për hartimin dhe miratimin e një plani mbi vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat.

Fig.1 Organigrama e TIK në DPT




Tabela 1: Struktura plan/fakt TIK në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Pozicion i strukturës	Numri punonjësve të miratuar	Numri aktual punonjësve	Numri vendeve vakant
Drejtor Drejtorie	1	1	0
Sektori operacioneve	5	1	4
Sektori i zhvillimit dhe mirëmbajtjes së Programeve	4	2	2
Sektori Rrjetit dhe Infrastrukturës	6	3	3
Sektori ndihmës Teknike	3	2	1
Sektori I sigurisë së të dhënave	3	0	3
Sektori DRT TR,DR,EL,DTM	9	6	3
Sektori DRT FR,BR,KO	4	4	0
Sektori DRT DB,KU,LZH	5	4	1
Sektori DRT VL,GJ,SR	4	3	1

Burimi i të dhënave: Drejtoria TIK në DPT

Nga auditimi u konstatua se AKSHI ka publikuar njoftim për të rekrutuar punonjës të rinj për vendet vakante, por periudhën objekt auditimi drejtoria TIK ushtron aktivitetin e saj me 25 punonjës edhe pse struktura e miratuar është e përbërë nga 44 punonjës.

Duke u nisur nga rëndësia specifike e sigurisë së të dhënave në DPT konstatohen mungesa në staf në disa pozicione të rëndësishme si:

- Sektori i sigurisë së të dhënave;
- Sektori i mirëmbajtjes së programeve;
- Sektori rrjetit dhe infrastrukturës;
- Zyrrat Rajonale.

Për sa më sipër, mangësitë në pozicionet e mësipërme përbëjnë risk të lartë në përmbushjen e detyrave të rëndësishme lidhur me sigurinë e të dhënave.

2.Titulli i Gjetjes: Drejtoria TIK pranë DPT funksionon me mungese personeli.

Situata: Nga auditimi mbi strukturën TIK të AKSHI-t, atashuar pranë DPT u konstatua se nga një strukturë e miratuar me 44 punonjës, pranë DPT aktualisht janë 19 pozicione vakante ose afërsisht 43% e vendeve të strukturës. Në Sektorin e Operacioneve, Sektorin e Rrjetit dhe Infrastrukturës, Sektorin e sigurisë së të dhënave, si dhe në Sektorin e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së Programeve, rezultoi se janë strukturat me vende vakante me të larta.

Kriteri: Urdhri nr. 191, datë 18.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

Ndikimi/Efekt: Risk në mos përmbushje të objektivave të përcaktuara.

Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e TIK të miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike. Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverave (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike. Duke qenë se dhoma e serverave është një pikë e rëndësishme e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit. Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të DPT-së vizitoi on-site pajisjet fizike të DPT. Për funksionimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në DPT është në funksionim një dhomë serverash.

3.Titulli i Gjetjes: Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën me të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve të AKSHIT.

Situata: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me Rregulloren 1.0 , datë 02.12.2008 miratuar nga AKSHI që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Disa nga mangësitë e konstatuara janë:

- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverave;
- Sistemi i kondicionimit nuk ishte efektiv për të arritur ftohjen e duhur të serverave. Një kondicioner punonte në gjendje alert (alarm) dhe tjetri ishte i fikur, duke ndikuar negativisht në mbajtjen e parametrave optimale dhe nuk favorizon qarkullimin natyral të ajrit. Po ashtu dhe kondicioneri back up është në gjendje kritike;
- Sistemin backup UPS aktualisht nuk mundëson një autonomi të infrastrukturës nga ndërprerja e energjisë elektrike. Të dy UPS janë në gjendje alert (alarm);

- Nuk janë kryer kolaudime për sistemin kundër zjarrit;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Management System) sistemi i alarmit. Sistemi i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik;
- Nuk ka raporte periodike për verifikimin e logeve të aksesit në dhomën e serverave.

Kriteri: Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverave (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), praktikata me të mira.

Ndikimi/Efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit risk në shkatërrim të aseteve.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me praktikata me të mira, si dhe standardet e përcaktuara në udhëzimet e AKSHI-t.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për standardizimin e dhomës së serverave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në përputhje me praktikata më të mira, si dhe standardet e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Fjalëkalimet e përdoruesve. Nga auditimi i të drejtave të përdoruesve, mënyrës së çeljes së përdoruesve dhe politikave të vendosjes së fjalëkalimeve të përdoruesve, si dhe siguria e tyre rezultoi se krijimi i një përdoruesi të ri në sistemin e Fiskalizimit, C@ts bëhet në bazë të urdhrave të emërimit dhe formularit tip i cili plotësohet nga drejtoria përkatëse në bazë të profilit të specialistit dhe nevojave të drejtorisë, të bazuara në aktin e emërimit të punonjësit. Kjo procedurë mbi profilin, sigurinë dhe login është e përshkruar edhe manuali i përdorimit të sistemit. Përdoruesit e jashtëm të sistemit të Fiskalizimit e aksesojnë sistemin me kredenciale mbi emrin e përdoruesit dhe fjalëkalim.

4.Titulli i Gjetjes: Nuk janë dokumentuar kritere për fjalëkalimet e përdoruesit të jashtëm në sistemin e Fiskalizimit.

Situata: Nga auditimi mbi përdoruesit e jashtëm të sistemit të Fiskalizimit, u konstatua se:

- Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e vështirësisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave, si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit;

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikave të implementuar për përdoruesit fundor të sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre të aplikohen, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike”, miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikave të implementuar për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b., të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

Kriteri: Pika 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a, e rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; Forcimin e fjalëkalimit si element sigurie.

Ndikimi/Efekti: : Mos administrim i fjalëkalimeve të përdoruesve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike, si dhe mosnjohje e të drejtave dhe detyrimeve që kanë të gjithë përdoruesit e sistemit.

Shkaku: Mungesa e rregullave të dokumentuara dhe implementimi i tyre mbi sigurinë e fjalëkalimeve të përdoruesve.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrin masa për dokumentimin politikave të sigurisë për

përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullatore të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë.

Auditimi i procedurave të krijimit dhe mbylljes së përdoruesve. Kërkesat për krijimin e një përdoruesi të ri kalon disa faza vendimmarrëse duke filluar nga drejtoritë përkatëse të cilat përcjellin kërkesat në drejtorinë e Burimeve Njerëzore në DPT. Janë Burimet Njerëzore struktura që përcjell kërkesën për të vepruar në Drejtorinë TIK me qëllim krijimin, ndryshimin si dhe mbylljen apo ç 'aktivizimin e një përdoruesi në sistem.

Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve të sistemeve të Fiskalizimit, e-Taxation, AEOI dhe Llogarive Bankare realizohet nga Sektori i Rrjetit dhe Infrastrukturës, strukturë e drejtorisë TIK

Sistemi i Fiskalizimit aksesohet me *single sign on* nga 1,553 përdorues të ndarë në aktiv dhe jo aktiv. Përdorues aktiv janë 1,328 të ndarë sipas roleve përkatëse në sistemin..

Nga auditimi mbi përdoruesit e sistemit të Fiskalizimit, u konstatua se:

- Me emërtimin "Shofer" janë aktiv 26 përdorues të cilët nuk kane asnjë rol të miratuar;
- Me emërtimin "Pastrues" janë aktiv 19 përdorues të cilët nuk kane asnjë rol të miratuar;
- Me emërtimin "Korrier" janë aktiv 4 përdorues të cilët nuk kane asnjë rol të miratuar;
- Me status aktiv janë 55 përdorues të cilët nuk identifikohen se çfarë procesesh mbulojnë në sistem;
- Gjatë auditimit u kërkua lista e punonjësve të larguar nga DPT për periudhën Janar 2021 deri në Mars 2023, u kryen verifikime dhe rezultoi se ka punonjës me rol të miratuar në sistem që janë me status aktiv;
- Janë miratuar formate për krijim dhe mbyllje llogarie në sistemin e Fiskalizimit, por nuk ka formate të hartuara për ndryshim llogarie nga një rol në një tjetër për punonjës që ndryshojnë pozicionin në strukturë.

Sistemi *e-Taxation* aksesohet me user name dhe password nga 2,240 usera të ndarë në aktiv dhe jo aktiv, ku përdorues aktiv janë 1,553, të ndarë sipas roleve përkatëse.

Nga auditimi me zgjedhje i 20 përdoruesve të sistemit e-Taxation, ku 10 përdorues janë punonjës të KLSH-s, ndërsa 10 përdorues ish punonjës të DPT-s, u konstatua se:

- Në 2 raste kërkesa për mbylljen e përdoruesve, është bërë afërsisht 2 muaj më vonë se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me DPT;
- 10 Përdorues të cilët kanë ushtruar auditime të jashtme në periudha të caktuara në DPT rezultojnë me status aktiv megjithëse ushtrimi i detyrës ka përfunduar;
- Në 2 raste nuk është bërë kërkesë për mbyllje të përdoruesve;
- 6 Punonjës të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me rol të miratuar janë përdorues aktiv;
- Janë miratuar formate për krijim dhe mbyllje llogarie në sistemin e-Taxation, por nuk ka formate të hartuara për ndryshim llogarie nga një rol në një tjetër për punonjës që ndryshojnë pozicionin në strukturë;
- U konstatua se ka përdorues që nuk janë të unifikuar pasi nuk kanë të drejta të njëjta si kopjimi dhe eksporti i të dhënave.
- Drejtorët e Drejtorive megjithëse është përcaktuar në Rregulloren për Sigurinë e Informacionit pika 4.1 nuk monitorojnë nëse kërkesat për hapje, ndryshim dhe mbyllje llogarie janë zbatuar nga struktura e IT, duke siguruar mbylljen dhe kontrollin e të gjithë ciklit të administrimit të përdoruesve;

Për sa më sipër, Burimet Njerëzore, Drejtorët e Drejtorive megjithëse ju është përcaktuar në Rregulloren për Sigurinë e Informacionit pika 4.1 nuk monitorojnë nëse kërkesat për hapje, ndryshim dhe mbyllje llogarie janë zbatuar nga struktura e IT, duke siguruar mbylljen dhe

kontrollin e të gjithë ciklit të administrimit të përdoruesve që kanë akses në sistemet informatike. Në DPT rezulton se, hapja e këtyre përdoruesve mbetet pothuajse e pa monitoruar, pasi vetë institucioni nuk kryen monitorime që lidhen me këtë veprim, duke rritur riskun e keq menaxhimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e të dhënave për sistemin e Fiskalizimit, si dhe atë të e-Taxation.

5.Titulli i Gjetjes: Keq administrim i përdoruesve të sistemit të Fiskalizimit si dhe atë të e-Taxation, duke krijuar kushte për shkelje të sigurisë.

Situata 1: Nga auditimi mbi përdoruesit aktiv, të ndarë sipas roleve përkatëse në sistemin e e-Taxation, u konstatua se:

- Në 2 raste kërkesa për mbylljen e përdoruesve, është bërë afërsisht 2 muaj më vonë se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me DPT;
- 10 Përdorues të cilët kanë ushtruar auditime të jashtme në periudha të caktuara në DPT rezultojnë me status aktiv megjithëse ushtrimi i detyrës ka përfunduar;
- Në 2 raste nuk është bërë kërkesë për mbyllje të përdoruesve;
- 6 punonjës të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me rol të miratuar janë përdorues aktiv;
- Janë miratuar formate për krijim dhe mbyllje llogarie në sistemin e-Taxation, por nuk ka formate të hartuara për ndryshim llogarie nga një rol në një tjetër për punonjës që ndryshojnë pozicionin në strukturë;
- Ka përdorues që nuk janë të unifikuar pasi nuk kanë të drejta të njëjta si kopjimi dhe eksporti i të dhënave;
- Drejtorët e Drejtorive megjithëse është përcaktuar në Rregulloren për Sigurinë e Informacionit pika 4.1 nuk monitorojnë nëse kërkesat për hapje, ndryshim dhe mbyllje llogarie janë zbatuar nga struktura e IT, për të pasur akses të sigurtë;

Nga auditimi mbi përdoruesit aktiv, të ndarë sipas roleve përkatëse në Sistemin e Fiskalizimit, u konstatua se:

- Me emërtimin “Shofer” janë aktiv 26 përdorues të cilët nuk kanë asnjë rol të miratuar;
- Me emërtimin “Pastrues” janë aktiv 19 përdorues të cilët nuk kanë asnjë rol të miratuar;
- Me emërtimin “Korrier” janë aktiv 4 përdorues të cilët nuk kanë asnjë rol të miratuar;
- Me status aktiv janë 55 përdorues të cilët nuk identifikohet se çfarë procesesh mbulojnë në sistem;
- Gjatë auditimit u kërkua lista e punonjësve të larguar nga DPT për periudhën Janar 2021 deri në Mars 2023 u kryen verifikime dhe rezulton se 13 punonjës me rol të miratuar në sistem që janë me status aktiv;

Janë miratuar formate për krijim dhe mbyllje llogarie në sistemin e Fiskalizimit, por nuk ka formate të hartuara për ndryshim llogarie nga një rol në një tjetër për punonjës që ndryshojnë pozicionin në strukturë.

Kriteri: Rregullore e Sigurisë së Informacionit.

Ndikimi/Efekt: Risk për aksesim të paautorizuar në të dhënat e sistemeve. Risk për mos-evidentimin dhe mos-parandalimin e problematikave që lidhen me sigurinë e të dhënave.

Shkaku: Mos zbatim i akteve rregullative.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të marrin masa për sistemin e problematikave mbi përdoruesit aktivë renditur më sipër të cilët rezultojnë aktivë megjithëse janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Gjithashtu, të merren masa për ç’aktivizimin e të gjithë përdoruesve të cilët nuk janë të lidhur me përdorues të identifikueshëm.

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për hartimin e procedurave të plota për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve të cilët bazuar në pozicionin e tyre nevojitet të aksesojnë sistemet informatike dhe të dhënat që ruhen në këto sisteme.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.2, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/9, datë 13.07.2023, si dhe trajtuar në faqet 13-20 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione nga AKSHI me shkresën nr.359/4, datë 04.09.2023 dhe observacione nga DPT me shkresën nr. 359/5, datë 06.09.2023.

Pretendimi i AKSHI-t: AKSHI ka rivlerësuar dhe analizuar detyrat dhe përshkrimet e punës për secilin pozicion pune dhe kemi kryer rishpalljen e vendeve vakante për plotësimin e tyre. AKSHI është duke hartuar rregulloren për personat e autorizuar që hyjnë në dhomën e serverave. AKSHI ka observuar lidhur me konstatimet në ambientin fizik të dhomës së serverave lidhur me BMS, UPS, sistemin antizjarr si dhe raportet e monitorimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sipas verifikimit në pretendimet e AKSHI-t, sqarojmë se nuk kundërshtohet gjetja dhe as rekomandimi. Observacioni është më tepër një sqarim mbi situatën e konstatuar.

Pretendimi i AKSHI-t: Për përdoruesit e jashtëm që logohen me password të vecantë iu kërkua palës zhvilluese të sistemit që të aplikojë politikën për implementimin e fjalëkalimit. Zhvillimi i sistemit në këtë drejtim ka kaluar në Live në datën 02.08.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit është në dijeni të krijimit të cështjes nga ana e IT, tek OE që ofron mirmëbajtjen, por nuk na është vënë në dispozicion një dokument politikash të cilat janë kaluar në Live. Ky verifikim do të bëhet në vazhdimësi të auditimeve mbi zbatimin e rekomandimeve.

Pretendimi i AKSHI-t: Kërkesat për krijimin dhe mbylljen e përdoruesve të sistemeve veprohet nga drejtoria TIK pas përcjelljes së shkresë nga burimet njerëzore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nisur nga rëndësia që ka monitorimi i përdoruesve, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim. DPT ka për të marrë gjithashtu masat e nevojshme për zbatimin e tij.

Pretendimi i DPT-s: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, shpreh gadishmërinë për të bashkëpunuar për hartimin e një plani mbi vashdimësinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat si dhe krijimin e ambientit të dhomës së serverave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

DPT ka marrë masat e nevojshme për përditësimin e përdoruesve aktivë. Gjithashtu drejtoria e BNj në bashkëpunim me TIK do të rishikojnë formularët e për saktësimin e roleve në sistem, ku për cdo ndryshim në shtim/pakësim, do të ketë formular specifik.

Për sa më sipër, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi gjetjet dhe rekomandimet e këtij drejtimi të auditimit paraqitur në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

III.2.2 Zhvillimi dhe blerja në teknologjinë e informacionit.

a. Investimet në teknologjinë e informacionit

Procedurat mbi pajisje të teknologjisë së informacionit, realizuar nga DPT për periudhën objekt auditimi, janë:

Nr	Procedura	Periudha e zbatimit	Vlera totale e kontratës në lekë, pa TVSH
1	Blerje certifikate SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit (CTS)	2022	78,000
2	Riparimi i printerëve	2023	323,000

Nga procedurat e realizuara në DPT, grupi auditoi procedurën me vlerë të vogël e cila ka përfunduar brenda periudhës objekt auditimi me objekt “Blerje certifikate SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit (CTS)”, me vlerë 78,000 lekë pa TVSH.

Procedura e prokurimit me objekt “Blerje certifikatat SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit CTS” është iniciuar me kërkesë të drejtorit të TIK në datë 13.09.2022, përcjellë me email tek drejtoria e shërbimeve mbështetëse, për marrjen e masave të procedurës së blerjes të një certifikate SSL për “Production Environment”.

Grupi i ngritur në datën 15.09.2022 ka mbajtur procesverbal mbi llogaritjen e fondit limit të blerjes me objekt “Blerje certifikate SSL për DPT-në”, ku vlera e përlllogaritur është bazuar në vlerën e mëparshme.

Me shkresën nr. 15540/1 prot., datë 15.09.2022 është dokumentuar ftesa për ofertë drejtuar 3 operatorëve.

Në datën 04.10.2022 është bërë njoftim anulimi për shkak se nuk u paraqit asnjë ofertë e përshtatshme në këtë procedurë. Në datën 05.10.2022 është bërë njoftim anulimi për shkak se nuk u paraqit asnjë ofertë e përshtatshme në këtë procedurë.

Mbas anulimit dy herë të procedurës, për arsye se të gjitha ofertat ishin më të larta se fondi i llogaritur me procesverbalin e datës 06.10.2022 është bërë rillogaritja e fondit limit duke u bazuar në mesataren e ofertave të paraqitura në datën 05.10.2022 në vlerën 153 875 lekë pa TVSH.

Për shkak të paraqitjes së ofertave të papërshtatshme, në datën 07.10.2022 është bërë sërish njoftim anulimi i procedurës.

Me shkresën nr. 15540/2 prot., datë 12.10.2022 ka dalë urdhri për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të shërbimit të prokuruar me objekt “Blerje certifikatat SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit CTS”.

Në datën 27.12.2022 është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim bazuar në urdhrin nr.15540/2 prot., datë 12.10.2022. Në çdo rast të zhvillimit të procedurës janë nënshkruar formularët e deklarimit të konfliktit të interesit nga të tre pjesëtarët e grupit.

Për veprimet e hedhjes në sistemin e prokurimit është mbajtur proces verbal ndërmjet personave përgjegjës të prokurimeve në të cilin dy nga anëtarët autorizojnë një nga anëtarët për kryerjen e veprimeve të hedhjes së procedurës në sistem.

Për këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël me objekt “Blerje certifikatat SSL për nevojat e aksesimit të Sistemit të Përbashkët të Transmetimit CTS” u konstatua se në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk gjendet urdhri i prokurimit të procedurës, në kundërshtim me nenin 74/ pika 3.c e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, proces-verbali i shpalljes së fituesit nuk rezulton të jetë mbajtur nga njësia e prokurimit dhe të jetë bërë pjesë e dosjes.

a. Marrëveshjet e nivelit të shërbimit

Procedurat e prokurimit që ka kryer AKSHI, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 - 30.04.2023, ku përfitues është DPT, janë:

Nr	Procedura	Periudha e zbatimit	Vlera totale e kontratës në lekë, pa TVSH
1	Mirëmbajtja e infrastrukturës hostuese e sistemit e-Taxation	2021 - 2023	64,390,560
2	Mirëmbajtja e sistemit e-Taxation	2021 - 2023	191,322,240
3	Rritja e kapaciteteve hardware për sistemin e fiskalizimit për DPT	2022 - 2023	354,461,430
4	Mirëmbajtja e Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit për DPT	2023 - 2025	705,428,160

Procedurat e prokurimit që ka kryer AKSHI jashtë periudhës objekt auditimi, por zbatohen në periudhën objekt auditimi 01.01.2021 - 30.04.2022, ku përfitues është DPT, janë:

Nr	Procedura	Periudha e zbatimit	Vlera totale e kontratës në lekë, pa TVSH
1	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DRT/DPT (faza 2)	2020 - 2022	105,290,000
2	Automatizimi dhe Monitorimi aktiviteti për inspektoret - DPT	2020 - 2021	99,891,000
3	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja.	2020-2024	89,900,000
4	Përmirësim i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit	2018 - 2022	1,188,978,048

Në kuadër të digjitalizimit të sistemit të faturimit elektronik, nga AKSHI është vlerësuar si e nevojshme, që administrimi i dokumentacionit dhe faturave të kryhet në formë elektronike në mënyrë që të shmangen problematikat që hasen gjatë ndjekjes së zbatimit të kontratave.

AKSHI ka njoftuar me shkresën nr.7789 prot., datë 10.11.2021 institucionet publike, ndërmjet tyre dhe DPT-n, se ndjekja dhe zbatimi i kontratave do të kryhet nëpërmjet një sistemi informatik të dedikuar për menaxhimin e kontratave - SMK, ku popullimi së pari do të jetë me kontratat ku AKSHI është në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Në këtë njoftim thuhet se ky sistem ju vjen në ndihmë AK, kontraktuesve, institucioneve përfituese dhe personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave, duke ruajtur të gjithë dokumentacionin teknik, si dhe duke monitoruar mbarëvajtjen e gjithë procesit deri në përfundimin e zbatimit të kontratës. AKSHI ka theksuar se vënia në punë e këtij sistemi, do të zëvendësojë 100% koston financiare në bazë materiale si letër, printer, bojë, fotokopje si dhe kohë fizike në përcjelljen e dokumentacionit nga punonjësi në punonjës si dhe nga institucioni në institucion.

Gjithashtu, në këtë komunikim thuhet se, menaxhimi i zbatimit të kontratave nëpërmjet këtij sistemi sjellë përfitime dhe për kontraktuesit, duke shmangur letrën e printuar për raportin dhe faturën apo dërgimin e dokumentacionit fizikisht pranë zyrave të protokolleve të institucioneve, ku më pas delegohet tek punonjësi përkatës për miratim dhe pranë degëve të thesarit për likuidim.

Në këtë shkresë thuhet gjithashtu se sistemi po pilotohet me kontratat ku AKSHI është në cilësinë e AK, për të monitoruar fillimisht ecurinë e procesit dhe në momentin që do të konsolidohet, do të implementohet dhe tek institucionet e tjera që luajnë rolin e AK në kontrata të ndryshme.

AKSHI ka kërkuar pajisjen me nënshkrim elektronik të punonjësve që do të mbajnë role me funksionet si më poshtë:

1. Ndjekësi i kontratës, me rol aksesimin e raportit dhe faturës së ngarkuar nga operatori ekonomik në sistem, me qëllim miratimin e saj me nënshkrim elektronik.
2. Punonjësi përgjegjës i zyrës së financës, me rol aksesimin dhe miratimin e faturës së shërbimit të kontraktuar në mënyrë që automatikisht fatura të dërgohet pranë degëve të Thesarit për likuidim, ose në sistemin financiar të pagesave në rastin e institucioneve me vetëfinancim. Rregullorja e përdorimit të sistemit të menaxhimit të kontratave - SMK është miratuar me urdhrin nr. 7157 prot., datë 20.10.2021 të titullarit të AKSHI-t.

Kontrata e re regjistrohët në sistemin e menaxhimit të kontratave nga njësia e prokurimit dhe nënshkruhet nga Autoriteti Kontraktor sipas urdhrin të titullarit të AKSHI me nr.7157 prot., datë 20.10.2021.

Nga auditimi mbi vënien në funksion të ndjekjes së zbatimit të kontratave nëpërmjet sistemit SMK, problematikat u konsideruan të ndara në këto drejtime:

- Problematika të informimit dhe udhëzime të nevojshme për veprimet që do të kryhen nga rolet ndjekës i kontratës si dhe nëpunës zbatues, të cilat nevojiten ti adresohen Autoritetit Kontraktor;
- Problematika të cilat nevojiten të zgjidhen në nivel sistemi, të cilat nevojiten ti adresohen Autoritetit Kontraktor;
- Konstatime nga ndjekja e kontratave të cilat janë trajtuar në vijim.

1. Titulli i Gjetjes: Problematika të informimit dhe udhëzime të nevojshme për veprimet që do të kryhen nga rolet ndjekës i kontratës si dhe nëpunës zbatues, të cilat nevojiten ti adresohen Autoritetit Kontraktor.

Situata: Nga auditimi mbi rregulloren dhe manualin e përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Kontratave, që shërbejnë si dokumentacionin udhëzues për ndjekësit e kontratës si dhe nëpunësin zbatues punonjës të DPT-s, u konstatua se nuk jepen udhëzime:

- Se veprime kryhen nga përdoruesi që është në rolin ndjekës i kontratës dhe punonjës i financës, dy role që përdoren nga DPT;
- Mbi rastet që kthehen për korrigjim, dokumentet kthehen “në grup” apo vetëm dokumenti ku është konstatuar një parregullsi apo mangësi;
- Nënshkrimi elektronik kryhet për secilin dokument apo në të njëjtën kohë për gjithë grupin e dokumenteve;
- Se cili dokument periodik protokollohet, si element kontrolli i ndjekësve të kontratës;
- Se cili dokument nevojitet të aprovohet dhe nënshkruhet elektronikisht nga ndjekësit dhe cili dokument aprovohet dhe nënshkruhet nga punonjësit e financës;
- Se çfarë raportesh realizohen në këtë sistem si ndjekës kontrate, punonjës finance.

Kriteri:

- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Rregullorja e përdorimit të sistemit të menaxhimit të kontratave - SMK;

Ndikimi/Efekti: Ndjekja e kontratës nëpërmjet këtij sistemi nuk mundëson gjurmimin e nevojshëm të hapave të ndjekur dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Shkaku: Mangësi të sistemit, mangësi të informimit të plotë mbi çfarë kërkohet dhe si.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të kërkojë përditësimin e rregullores së hartuar për pozicionet që DPT angazhon, të cilët janë: ndjekës i kontratës dhe punonjës i financës.

2. Titulli i Gjetjes: Problematika të cilat nevojiten të zgjidhen në nivel sistemi, të cilat nevojiten ti adresohen Autoritetit Kontraktor.

Situata: Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratave nëpërmjet sistemit SMK u konstatuan disa problematika të vetë sistemit që i paraqiten ndjekësit të kontratës dhe punonjësit të financës, të cilat janë:

- Dokumenti i paraqitur nga OE pasi është kthyer nga ndjekësit e kontratës për korrigjim nuk pajiset me numrin e protokollit që ka marrë dokumenti kur ngarkohet për herë të parë, por ndjekësit janë të detyruar të nënshkruajnë dokumentin e radhës pa numër dhe datë protokollit;
- Sistemi është konceptuar dhe ndërtuar për nënshkrime në grup të dokumenteve periodike si dhe dokumenteve përfundimtare të zbatimit të kontratës, megjithëse aprovimi dhe nënshkrimi i dokumenteve do të duhej të ishte më dinamik, duke patur parasysh se fatura nuk mund të nënshkruhet nëse raporti nuk është pranuar, ose procesverbali i pranimi të shërbimit nuk mund të nënshkruhet përpara se raporti të jetë nënshkruar;
- Plani i zbatimit të kontratës nuk nënshkruhet nga OE dhe ky dokument nuk pajiset me numër dhe datë protokollit;

- Procesverbali i gjeneruar automatikisht nga sistemi në fakt duhet të ishte një akt-pranimi me të drejta editimi dhe jo një model i standardizuar për arsye se grupi në rast se duhet të dokumentojë një veprim, i nevojitet të mbajë një tjetër dokument të quajtur procesverbal dhe ta ngarkojë atë në sistem në formatin pdf si dokumentet e tjerë;
- Dokumentet e ngarkuar nga ndjekësit e kontratës nuk marrin numër dhe datë protokolli;
- Nuk janë mundësuar kërkime me numër protokolli, raporte të ndryshme që nevojiten të gjenerojë çdo përdorues me qëllim kontrollimin e veprime të kryera prej tij;
- Sistemi nuk ka komunikime me sisteme të tjera që të lehtësojë veprimet operacionale të punonjësve të financës që kryejnë dhe monitorimin e procesit të nënshkrimit në sistemin e SMK megjithëse ky kontroll mund të ishte zgjidhur automatikisht.

Kriteri:

- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Rregullorja e përdorimit të sistemit të menaxhimit të kontratave - SMK;

Ndikimi/Efekti: Mangësitë e sistemit SMK, janë hapësira që krijojnë mundësinë që ndjekja të mos jetë në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë zbatimin e kontratës.

Shkaku: Mënyra e konceptimit, ndërtimi i sistemit jo konform me aktet ligjore që rregullojnë ndjekjen e kontratave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të adresojë tek Autoriteti Kontraktor i sistemit të ndjekjes së kontratave - SMK problematikat e konstatuara nga auditimi, për të cilat nevojiten të merren masa sistemuese me qëllim sigurimin e veprimeve të duhura, në dy pozicionet që përfshihet DPT, si ndjekës kontrate dhe punonjës finance.

- Rritja e kapaciteteve hardware për sistemin e fiskalizimit - për DPT

Ecuria e zbatimit të kontratës nr. 30 prot., datë 20.10.2022, lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI dhe OE “H” me NIPT K..... Kontrata ka për objekt “Rritja e Kapaciteteve hardware (fizike) për Sistemin e Fiskalizimit për DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”. Vlera totale e Kontratës është 354,461,430 lekë, pa TVSH dhe 425,353,716 lekë me TVSH. Kontrata ka afat lëvrimi 9 muaj nga nënshkrimi, 20.10.2022 – 19.07.2023.

Kjo Kontratë për rritje kapacitetesh hardware, ka si objektiv zgjerimi i kapacitetit ekzistues të infrastrukturës fizike për sistemin e fiskalizimit, në mbështetje të kontratës nr.6756 prot., datë 27.11.2018, me Objekt “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”.

Nëpërmjet zgjerimit të kapaciteteve hardware synohet të realizohet:

- Rritja e kapacitetit të procesorëve të nyjeve të bazës së të dhënave;
- Rritja e kapacitetit të memories së nyjeve të bazës së të dhënave;
- Rritja e kapaciteteve të Servera-ve Storage Exadata.
- Rritja e kapaciteteve të Hardwer-it kryesor të pajisjes virtuale.
- Aktivizimi i kapacitetit shtesë Oracle Exadata Storage Server Software.
- Aktivizimi i Licencave shtese 12-CPU për softwerin:
- Oracle Database Enterprise Edition
- Oracle Partitioning
- Oracle Advanced Compression
- Oracle Advanced Security
- Oracle Diagnostic Pack
- Oracle Tuning Pack
- Oracle Active Data Guard

- Oracle Audit Vault and Database Firewall
- Aktivizimin e Licencave shtese 12-CPU e Oracle Real Application Clusters
- Aktivizimin e Licencave shtese 20-CPU e Oracle Weblogic Enterprise Edition

Qëllimet e kësaj Kontrate janë si më poshtë:

- Përmirësim i kapaciteteve hardware për sistemin e fiskalizimit;
- Përmirësimi i kapaciteteve serverëve të bazës së të dhënave Exadata;
- Përmirësimi i kapaciteteve të hapësirës ruajtëse të jashtme ZFS;
- Përmirësimi i Infrastrukturës së Serverit të Aplikacionit;
- Shitimi i kapacitetit të rrjetit (network switch);
- Përmirësimin e komunikimit me sisteme të tjera;
- Ulje pengesave të performancës Bottleneck;
- Rritja e performancës së sistemit për përballimin e rritjes së kërkesave të transaksioneve me para në dorë (B2C) dhe me para jo cash (B2B);

Sipas paragrafit 4.3 të ofertës, rezultatet që do të arrihen nga kontraktori, në fund të këtij shërbimi janë:

- Furnizim, instalim dhe konfigurim me sukses i Oracle Exadata serverave të bazës së të dhënave, CPU dhe memory RAM dhe aktivizimin e këtyre kapaciteteve;
- Instalim dhe konfigurim me sukses i Serverave të ruajtjes së të dhënave (data) për bazën e të dhënave;
- Instalimi dhe konfigurimi i Harduerit kryesor të Serverave të Aplikacionit;
- Instalimi dhe konfigurimi i hapësirës ruajtëse ZFS Storage;
- Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të rrjetit (network switch); _ Implementimin software Oracle Licencë dhe aktivizimin e tyre; _ Rritja e performancës në çdo komponent të sistemit.
- Testim i hardware-it dhe software-it me një shërbim, me një user në një rol të caktuar;

Në kushtet e veçanta të Kontratës, neni 5, pika 1, kushtet e dorëzimit kanë specifikuar se dorëzimi i mallrave do të bëhet brenda 4 javëve kalendarike nga data e nënshkrimit të Kontratës, ndërsa në nenin 8, pika 8.5.2 e planit të zbatimit të Kontratës specifikohet se afati kohor i implementimit të projektit, do të jetë dy muaj për furnizimet hardware.

Pavarësisht mospërputhjeve të afateve të përcaktuara në Kontratë dhe plan zbatimi lidhur me dorëzimin e mallrave, grupi i auditimit i është referuar afatit më të gjatë përcaktuar në planin e zbatimit të hartuar nga ndjekësit e kontratës, që është 2 muaj nga nënshkrimi.

Si pjesë e kushteve të veçanta të Kontratës, citohet se Operatori Ekonomik dorëzon:

- Raportin Fillestar brenda pesë ditëve nga fillimi i implementimit;
- Draft Raporti përfundimtar, jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave;
- Raporti final, pesë ditë pas marrjes në dorëzim të mallit/ shërbimit, si dhe komenteve në draft Raportin përfundimtar. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me Faturën përfundimtare.

Sipas pasqyrave dhe raporteve periodike rezulton se raporti fillestar është ngarkuar në sistem përtej këtij afati nga ana e OE. Personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës kanë vepruar konform ligjit dhe rregullave duke i kërkuar OE reflektimin e përmirësimeve në këtë draft Raport, gjë të cilën OE konstatohet se e ka përmbushur.

Kjo Kontratë është përcaktuar të mbikëqyret përmes sistemit elektronik të ndjekjes, mbikëqyrjes së zbatimit të Kontratave. Raporti i Shërbimit mujor është kërkuar të ngarkohet përmes portalit qeveritar të menaxhimit të Kontratave – SMK.

Rregullorja për miratimin e mënyrës së funksionimit dhe përgjegjësitë e funksionaliteteve të Sistemit të Menaxhimit elektronik të ndjekjes së Kontratave- SMK, është miratuar nga ana e Drejtoreshës së Agjencisë Shtetërore për Shoqërinë e Informacionit- AKSHI, përmes Urdhrit nr.7157 datë 20.10.2021.

Sipas parashikimeve në Kontratë Operatori Ekonomik – OE H, duhet të dorëzojë Raport instalimi, Raport i arkitekturës HW, SW i sistemit, Inventari (HW, SW, etj.).

Nga auditimi sipas raportimeve periodike u konstatua se nuk janë hartuar dhe miratuar raporte instalimi nga personat ndjekës të kontratës. Kjo në kundërshtim me pikën 9.2 të Kushteve të Veçanta të Kontratës, ku specifikohet se:

Pranimi për software do të kryhet nëpërmjet testimeve të pranimit. Përfundimet e testimeve të pranimit do të dokumentohen në formë të shkruar dhe do të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesi. Në rast se brenda afatit të pranimit do të kërkohej nga përfaqësuesit e Autoriteti Kontraktor që të bëhen ndryshime në shërbim, atëherë pranimi i testimit për ato elemente shërbimi që janë kërkuar të ndryshohen, do të ribëhet pasi të jetë aprovuar ndryshimi dhe prezantimi i tij.

Por, me paraqitjen e draft Raportit final nga ana e OE, ngarkuar në sistemin e kontratave në datën 08.06.2023 dhe nënshkruar elektronikisht nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës në datën 14.06.2023, rezulton se janë kryer dhe dokumentuar testimet nga ana e grupit të ndjekjes së Kontratës dhe specialistëve të OE, sipas përcaktimeve kontraktuale.

Bazuar në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, kontraktuesi duhet të dorëzojë tek ndjekësit e Kontratës: “Akt Dorëzimit”, Faturën Tatimore të Mallrave, si dhe dokumentacionin shoqëruar të tyre, Certifikatat e origjinës/ cilësisë dhe Fletë garancitë përkatëse, të cilat rezultojnë të ngarkuara në sistem.

Kontrata ka filluar të zbatohet në datën e nënshkrimit 20.10.2022 dhe grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion nga ndjekësit e kontratës dokumentet e ngarkuar në sistem të paraqitura nga OE H.

Faturat për furnizime të pjesëshme deri në datën 12.01.2023 janë ngarkuar në sistemin SMK sipas datave: nr. 324, datë 21.11.2022, nr. 349 datë 14.12.2022, nr. 360, datë 20.12.2022, nr. 371 datë 27.12.2022, dhe nr. 372, datë 28.12.2022. Gjithashtu, në sistem janë ngarkuar dhe raportet përkatëse sipas përcaktimeve të kontratës. në datën 12.01.2023. Këto materiale rezultojnë të nënshkruara elektronikisht, përkatësisht në datë 14.02.2023 dhe datë 15.02.2022, nga personat përgjegjës.

Ndjekësit e Kontratës të caktuar përmes Urdhrit të AKSHI – it, me nr. 30/1, datë 20.10.2022, janë GjN, AG(A) specialist IT përfaqësues nga AKSHI, si dhe IL përfaqësuese e DPT-s.

Ndjekësit e Kontratës duhet të hartojnë Aktin e Marrjes në Dorëzim, në përputhje me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se komunikimi i parë përmes e-mail midis personit përkatës përfaqësues i OE dhe Institucionit përfitues është i datës 25.10.2022, përmes të cilit kërkohej takim për saktësimin e mënyrës së komunikimit për zbatimin e Kontratës. Përfaqësuesja e DPT, IL përmes email të datës 27.10.2022 i ka kërkuar personit

përgjegjës të OE që të sjelli planin për zbatimin e kontratës, pasi kjo kërkesë duhej përmbushur brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës. Megjithëse në përgjigje të këtij e-mail, EB në emër të OE i ka konfirmuar IL sjelljen e planit të zbatimit të kontratës brenda datës 27.10.2022, ky plan është hartuar nga grupi i ndjekjes së kontratës.

Nga auditimi rezulton se raporti fillestar nuk është paraqitur brenda afatit 5 ditor sipas përcaktimeve në kontratë. Gjithashtu, Plani për Zbatimin e Kontratës sipas pikës 5.2.4 të Rregullores nr.7157, datë 20.10.2021 “Për Menaxhimin dhe Ndjekjen e Kontratave”, është detyrim për t’u hedhur në sistem nga personat ndjekës të Kontratës.

Vënia në zbatim e rregullores së miratuar me urdhrin nr.7157 prot., datë 20.10.2021 të titullarit të AKSHI-t, nuk përjashton zbatimin rigoroz të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, që rregullojnë ndjekjen dhe zbatimin e kontratave.

Siç rezulton nga dokumentimi elektronik i planit për Zbatimin e Kontratës, ky dokument është krijuar në datë 3.11.2022, dhe është nënshkruar elektronikisht nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, në datë 9.11.2022 dhe datë 15.11.2022. Plani i zbatimit të kontratës i ngarkuar në sistem nuk është nënshkruar elektronikisht nga përfaqësuesit e OE.

Nga auditimi u konstatua se plani i zbatimit të kontratës është nënshkruar me një vonesë prej tre javë kalendarike nga data e nënshkrimit të Kontratës. Gjithashtu, u konstatua se dhe lëvrimi i mallrave për pajisjet hardware, si dhe licencat është kryer përtej afatit 60 ditësh, të përcaktuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Lidhur me sa më sipër, nga ana e personave ndjekës të kontratës, fillimisht nga GjN rezulton se është kërkuar sqarim lidhur me mospërputhjet në termat e Kushteve të Veçanta të Kontratës, përkatësisht neni 5, pika 5.1, si dhe afatit të përcaktuar në pikën 8.5 pika 2, ku specifikohet se lëvrimi i pajisjeve hardware do të bëhet brenda 2 (dy) muajve, në afatet e lëvrimeve 4 javore apo 60 ditore. Nga ana e Autoritetit Kontraktues, sektori i prokurimeve është konfirmuar se afati 60 ditor do të konsiderohet si afat për lëvrimin e mallrave.

Në vijimësi të zbatimit të Kontratës, IL, në cilësinë e anëtarit të grupit për ndjekjen e Kontratës, pas marrjes së një kërkesë përmes postës elektronike nga ana e OE në datën 20.12.2022 (kërkesë të cilën e ka trajtuar edhe me pjesëtarët e tjerë të grupit për ndjekjen e Kontratës), i është drejtuar AKSHI-t lidhur me afatin për lëvrimin e vonuar të mallrave nga ana e OE.

Në përgjigjen e Autoritetit Kontraktor- AKSHI-t, po të datës 20.12.2022 është interpretuar se datë për lëvrimin e mallrave duhet të konsiderohet afati tërësor prej 9 (nëntë) muajsh për furnizimet dhe instalimet, si pjesë e Kontratës. Komunikimi përmes postës elektronike midis personave përgjegjës për ndjekjen e kontratës dhe DSh është i datës 20.12.2022. Të vënë në dijeni për këtë komunikim nëpërmjet postës elektronike janë personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, disa adresa të postës elektronike të personave nga Autoriteti Kontraktor, si dhe adresa e postës elektronike të OE.

Lista e zërave për mallrat (produktet), licencat dhe shërbimet e deklaruara për t’u realizuar nga OE janë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi (Lekë)	Shuma (Lekë pa TVSH)
1	Përmirësimi i Oracle Exadata Database Rack – 1, X7-2 High Capacity – (HC)	Platformë	1	14,540,226	14,540,226
2	Përmirësimi i Oracle Exadata Database Rack – 2, X7-2 High	Platformë	1	14,540,226	14,540,226

	Capacity – (HC)				
3	Përmirësimi i Oracle Exdata Storage Rack – 1 për kapacitetin Oracle Exdata Storage Node	Platformë	1	17,692,602	17,692,602
4	Përmirësimi i Oracle Exdata Storage Rack – 2 për kapacitetin Oracle Exdata Storage Node	Platformë	1	17,692,602	17,692,602
5	Përmirësimi i Oracle Database Backup Storage	Platformë	1	7,329,662	7,329,662
6	Përmirësimi i shtresës së aplikacioneve	Server	8	3,039,140	24,313,120
7	Përmirësimi i shtresës së aplikacioneve, RAM për serverët aktuale 32GB moduli	Copë	28	56,850	1,591,800
8	Network Switch	Copë	2	1,468,828	2,937,656
9	Exdata Storage Server Softuer Licencë	Disk	48	931,217	44,698,416
10	Oracle Database Enterprise Edition	CPU	12	4,204,484	50,453,808
11	Oracle Real Application Clusters	CPU	12	2,035,856	24,430,272
12	Oracle Partitioning	CPU	12	1,017,928	12,215,136
13	Oracle Advanced Compression	CPU	12	1,017,928	12,215,136
14	Oracle Advanced Security	CPU	12	1,327,732	15,932,784
15	Oracle Diagnostic Pack	CPU	12	663,866	7,966,392
16	Oracle Tuning Pack	CPU	12	442,578	5,310,936
17	Oracle WebLogic Enterprise Edition	CPU	20	2,212,886	44,257,720
18	Oracle Active Data Guard	CPU	12	1,017,928	12,215,136
19	Oracle Audit Vault and Database Firewall	CPU	12	531,091	6,373,092
20	Instalim dhe rikonfigurim i infrastrukturës së përditësuar të sistemit të fiskalizimit	Copë	1	17,754,708	17,754,708
	Totali pa TVSH				354,461,430
	TVSH				70,892,286
	Totali me TVSH (Lekë)				425,353,716

Lista e mësipërme është audituar dhe vlerësuar nga grupi auditues, sipas zërave të praktikave dhe faturave të sjella nga ana e Operatorit Ekonomik – OE dhe të pranuar nga personat ndjekës të Kontratës, sipas Urdhrit nr.30/1, datë 20.10.2022. Mbetet për t'u realizuar testuar e pranuar nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës pas datës 30.04.2023, zëri me nr. 20: Instalim dhe ri konfigurim i infrastrukturës së përditësuar të sistemit të fiskalizimit.

Përmes Aktit të Marrjes në Dorëzim me nr. 324/2022, datë 21.11.2022, të nënshkruar elektronikisht në sistemin SMK në datën 7.12.2022 dhe datën 8.12.2022, është kryer pranimi për dy pajisjet Switch-t e para të furnizuara nga OE- H. Flet-Hyrja me Nr. 14 në magazinën e DPT mban datën 21.11.2022. Ky furnizim përbën zërin Nr.8, në listën e mallrave, pajisjeve për t'u ofruar, Shtojca Nr. 2, lista e çmimeve të shërbimeve.

Urdhër Shpenzimi për këtë furnizim/ pranim mban numrin 1284, i datës 20.12.2022. Shuma e vlerës së paguar është 3 525 187 lekë.

Përmes Akt Marrjes në Dorëzim të datës 14.12.2022 është bërë pranimi për dy zërat sipas Ofertës së Operatorit Ekonomik:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi për Njësi pa TVSH	Vlefte pa TVSH
1	Përmirësimi i Oracle Database Backup Storage	1	7 329 662,00	7,329,662.00
2	Përmirësimi i shtresës së aplikacioneve RAM për serverët aktuale 32 GB Moduli	28	56 850,00	1,591,800.00
Vlera pa TVSH				8,921,462.00 ALL
TVSH				1,784,292.40
Vlera Totale me TVSH				10,705,754.40 ALL

Fatura e ngarkuar përmes SMK nga përfaqësuesi i OE është nënshkruar elektronikisht nga përfaqësuesja e DPT, në datë 20.12.2022, nga ana e GjN në datë 20.12.2022 dhe nga AG(A) në datën 21.12.2022. Kjo praktikë është nënshkruar elektronikisht nga ana e përfaqësuesit të OE në datën 23.12.2022.. Dokumenti për Letër Garancinë për këtë lëvrim mban datën 14.12.2022, e cila është dhe data e fillimit të afatit të garancisë.

Në kushtet e veçanta të kontratës, afati i përcaktuar për pranimin e lëvrimeve është 3 ditë nga data e ngarkimit të tyre nga ana e OE në sistem.

Fatura me informacionin për numrat serial të zërave të mësipërm për memoriet e ofruara është ngarkuar në sistemin SMK nga ana e OE në datën 14.12.2022, rezulton të jetë nënshkruar nga specialistët e AKSHI-it, ndjekës të Kontratës: GjN në datën 20.12.2022 dhe nga AG në datën 21.12.2022. Përmes Urdhër Shpenzimit me nr. 1311 datë 28.12.2022 është kryer likuidimi për faturën me numër 349, të datës 14.12.2022, në vlerën 10 705 754.40 lekë. Fatura e hyrjes në magazine nr. 20, datë 14.12.2022. Në këto kushte ndjekësit e kontratës kanë tejkaluar afatin 3 ditor të cilësuar në kontratë, për pranimin e lëvrimeve/ furnizimeve.

Praktika me nr. 198 prot., nga ana e OE e datës 21.12.2022, Akt Marrje në Dorëzim jep informacionin lidhur me furnizimin e zërave:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlefte pa TVSH
1	Përmirësimi i Oracle Exadata database Rack – 1, X7-2 High Capacity- (HC) Memory Upgrade 768GB (twelve 64GB) DIMM	2	5 755 690.00 ALL
2	Përmirësimi i Oracle Exadata database Rack – 2, X7-2 High Capacity- (HC) Memory upgrade 768 GB (twelve 64GB) DIMM	2	5 755 690.00 ALL
Vlera pa TVSH			11 511 380.00 ALL
TVSH			2 302 276.00 ALL
Vlera Totale me TVSH			13.813 656 ALL

Kjo praktikë është nënshkruar elektronikisht nga personat përgjegjës në datën 23.12.2022.

Akt marrja në dorëzim për furnizim pjesor për zërat e mësipërm është hedhur në SMK në datë 21.12.2022 dhe është nënshkruar elektronikisht nga personat përgjegjës, ndjekës të Kontratës në datën 23.12.2022. Shkresa përcjellëse e OE me nr. 200 prot. drejtuar AKSHI-it dhe DPT mban datën 20.12.2022 dhe është nënshkruar elektronikisht nga ana e personit të autorizuar të OE me datën 21.12.2022.

Raporti i ngarkuar nga OE me nr.199, datë 21.12.2022, cilëson si gjendjen e konstatuar në DPT ashtu edhe mallrat dhe shërbimet e kryera në këtë datë të raportimit. Aktivitetet kryesore të realizuara prej fillimit të implementimit deri në datën 21.12.2023 të këtij raportimi përfshijnë:

- Dorëzimi i pajisjeve fizike për përmirësimi i shtresës së aplikacioneve, RAM për Serverët aktuale 32 GB moduli;
- Dorëzimi dhe instalimi i pajisjeve fizike Network Switch;
- Dorëzimi dhe instalimi i pajisjeve fizike - Përmirësimi i Oracle Database Backup Storage;
- Përditësimi i lidhjeve "fiber" në switch-et ekzistues (HPE Aruba), e cila mundëson krijimin e hapësirës fibër për lidhjen e Server-at të Aplikimit që do të instalohen.

Në pjesën përmbledhëse në fund të këtij Raporti, përveç zërave të mësipërm përmendet edhe zëri:

- Dorëzimi **pjesor** i pajisjeve fizike 4 x Memory upgrade 768 GB - “Përmirësimi i Oracle Exadata database Rack -1, X7-2 High Capacity - (HC)”.

Në fund ky Raportim në pikën V. Vazhdimësia e punës, përmend veprimet që do të kryhen në vijimësi nga ana e OE, si pjesë e zbatimit të Kontratës me nr.30, datë 2.10.2022, megjithëse lëvrimi duhet të kishte përfunduar brenda një afati 2 mujor, të përcaktuar në planin e zbatimit të kontratës.

OE H sh.p.k. citon në këtë raport se do të vazhdojë me përgatitjen e dokumentit të detajuar teknik (LLD), konceptimin dhe dizenjimi lidhur me implementimin e Oracle Exadata për projektin “Rritja e kapaciteteve hardware për sistemin e fiskalizimit”, lëvrimi i pajisjeve fizike, instalimi dhe konfigurimi i tyre. Pikat që do të realizohen në vazhdimësi janë:

- Lëvrimi i pajisjeve fizike, instalimi dhe konfigurimi i tyre.
 - Konfigurimi i pajisjeve fizike Network Switch (ARUBA).
 - Dorëzimi i pajisjeve fizike CPU Exadata Database Machine X7-2.
 - Dorëzimi i pajisjeve fizike të ruajtjes së të dhënave për Oracle Exadata Storage Server.
 - Dorëzimi i pajisjeve fizike të shtresës së aplikacioneve
 - Pas dorëzimit të pajisjeve do të fillojë menjëherë instalimi dhe konfigurimi i tyre,
 - Instalim konfigurim për serverëve të bazës së të dhënave Exadata RACK 1 dhe Exadata RACK 2 të kapaciteteve CPU + Memory.
 - Instalim konfigurim i 8x Serverë të rinj Exadata Storage Nodes HC.
 - Instalim konfigurim i 1 x hapësirës ruajtëse të jashtme ZFS Storage, duke përfshirë cache-n lexuese dhe shkruajtëse ReadZilla dhe LogZilla.
 - Instalim konfigurim i shtresës së aplikacioneve, RAM për serverët aktuale.
 - Instalim konfigurim i 8 x serverave të Aplikacionit.
 - Instalim konfigurim i pajisje-ve të rrjetit (network switch).
- Dorëzimin e Oracle Licencë:
 - Licenca Oracle shtese 12-CPU:
 - Oracle Database Enterprise Edition
 - Oracle Partitioning
 - Oracle Advanced Compression
 - Oracle Advanced Security
 - Oracle Diagnostic Pack
 - Oracle Tuning Pack
 - Oracle Active Data Guard
 - Oracle Audit Vault and Database Firewall o Licencave shtese 12-CPU e Oracle Real Application Clusters o Licencave shtese 20-CPU e Oracle Weblogic Enterprise Edition

Ky dokument rezulton se është ngarkuar e nënshkruar elektronikisht nga ana e personit të autorizuar të OE në datën 23.12.2022. Dy prej personave ndjekës të Kontratës GjN dhe AG e kanë nënshkruar këtë dokument elektronikisht në datën 23.12.2022, ndërsa personi i tretë përfaqësues e DPT, ka nënshkruar dokumentin elektronik në datën 27.12.2022.

Përmes Aktit të Dorëzimit me nr.201 prot., të datës 21.12.2022 janë dorëzuar mallrat si më poshtë:

Artikulli	Nr. Produktit	S/N Numri Serial Produktit	Sasia	Vendndodhja
768GB DIMM Memory (twelve 64 GB)	7118250	w00r000224033bc3fb	1	AKSHI - DPT
68GB DIMM Memory (twelve 64 GB)	7118250	w00r000224033bc4a5	1	AKSHI - DPT
768GB DIMM Memory (twelve 64 GB)	7118250	w00r000224033bc1ee	1	AKSHI - DPT
768GB DIMM Memory (twelve 64 GB)	7118250	w00r000224033bc3c6	1	AKSHI - DPT

Ky dokument rezulton të jetë ngarkuar dhe nënshkruar elektronikisht nga ana e OE në datë 21.12.2022 dhe përkatësisht në datë. 23.12.2022 nga ana e personave të ngarkuar për ndjekjen e Kontratës. Shkresa përcjellëse e këtij lëvrimi mban numrin 202 nga ana e OE, është hedhur

në sistem dhe nënshkruar elektronikisht nga ana e OE në datë 21.12.2022, si dhe në datë 23.12.2022 nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës.

Letrat e Garancisë për memoriet e furnizuara me numrat përkatës serial i fillojnë efektet si datë në datën 21 Dhjetor 2022 dhe jo në datën e nënshkrimit elektronik të aktit të pranimit nga ana e personave përgjegjës, të ngarkuar për ndjekjen e Kontratës.

Akti për Marrjen në Dorëzim për këtë furnizim, si dhe fatura tatimore janë hedhur në sistemin për menaxhimin e SMK-ve në datë 23.12.2022 dhe është nënshkruar elektronikisht nga palët përkatëse po në këtë datë 23.12.2022. Përmes Urdhër Shpenzimit Nr.1312 të datës 28.12.2022, është kryer likuidimi për faturën nr. 360 datë. 20.12.2022, në vlerën 13 813 656 lekë.

Përmes shkresës përcjellëse me nr. 210, datë 27.12.2022, OE i ka përcjellë përfituesit Akt dorëzimi të pajisjeve Oracle Storage Servers “Përmirësimi i Oracle Exadata Storage Rack - 1 për kapacitetin Oracle Exadata Storage Node”, “Përmirësimi i Oracle Exadata Storage Rack - 2 për kapacitetin Oracle Exadata Storage Node” dhe Oracle Application Servers, “Përmirësimi i shtresës së aplikacioneve”. Nr.208 Prot., datë 27/12/2022. Ky dokument është hedhur në sistemin SMK në datën 27.12.2022 dhe nënshkruar elektronikisht nga dy prej personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës në datën 28.12.2022 GjN dhe AG.

Akti i Marrjes në Dorëzim lidhur me këtë lëvrim-furnizim mban datën 27.12.2022, dhe nga ana e OE H është dorëzuar lista e artikujve, sipas zërave në tabelën më poshtë:

Nr	Emërtimi	Sasia	Vlefte pa TVSH
1	Përmirësimi i Oracle Exadata Storage Rack - 1 për kapacitetin Oracle Exadata Storage Node	1	17 692 602,00
2	Përmirësimi i Oracle Exadata Storage Rack - 2 për kapacitetin Oracle Exadata Storage Node	1	17 692 602,00
3	Përmirësimi i shtresës së aplikacioneve	8	24 313 120,00
Vlera pa TVSH			59 698 324,00 ALL
TVSH			11 939 664,80 ALL
Vlera me TVSH			71 637 988,80 ALL

Letra e Garancisë me nr. 209 prot., datë 27.12.2022, është hedhur në sistemin SMK nga ana e personit të autorizuar të OE në datën 27.12.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës në datën 28.12.2022. Data për fillimin e efekteve të licencave është data 27.12.2022, pavarësisht se data e Aktit të Pranimit, të Marrjes në dorëzim është data 28.12.2022. Përmes Urdhër Shpenzimit Nr. 1325 datë 29.12.2022 është kryer likuidimi për faturën Nr. 371, në vlerën 71 637 989 lekë.

Përmes shkresës me nr. 212 prot., datë 28.12.2022 OE i ka përcjellë AK Akt dorëzimi (me Nr.211 prot, datë 28.12.2022), **Oracle Licencat** “Exadata Storage Server Softuer Licencë”, “Oracle Database Enterprise Edition”, “Oracle Real Application Clusters”, “Oracle Partitioning”, “Oracle Advanced Compression”, “Oracle Advanced Security”, “Oracle Diagnostic Pack”, “Oracle Tuning Pack”, “Oracle Weblogic Enterprise Edition”, “Oracle Active Data Guard”, “Oracle Audit Vault and Database Firewall”. Nr.211 Prot., datë 28.12.2022, Faturën Tatimore me Nr. 372/ 2022, datë 27.12.2022, për Licencat e sipërpërmendura, Licencat Oracle për Exadata. Po ashtu, AK i janë përcjellë edhe lista e Licencave me mekanizmin e aktivizimit Offline.

Dokumenti elektronik për Akt Marrjen në Dorëzim mban datën 28.12.2022, i mbajtur në një kopje dhe i ngarkuar në sistemin SMK ka të deklaruar se:

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se vlera e faturës korrespondon me vlerën e përcaktuar sipas Formularit të Ofertës bashkëngjitur Kontratës nr. 30 prot, datë. 20.10.2022, me objekt “Rritja e kapaciteteve hardware për sistemin e fiskalizimit”.

Sa më sipër përfaqësuesit e AKSHI-it dhe DPT konkluduan se pajisjet (licencat) e dorëzuara nga Operatori Ekonomik “H” shpk, janë sipas kushteve dhe specifikimeve të përcaktuara në Kontratën me nr. 30 prot., datë 20.10.2022, me objekt “Rritja e kapaciteteve hardware për sistemin e fiskalizimit”.

Këto dokumente rezultojnë të jenë ngarkuar dhe nënshkruar elektronikisht në sistemin SMK në datën 28.12.2022, si nga OE ashtu edhe nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës.

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi pa TVSH	Vlera pa TVSH
1	Exadata Storage Server Softuer Licencë	48	931 217,00	44 698 416,00
2	Oracle Database Enterprise Edition	12	4 204 484,00	50 453 808,00
3	Oracle Real Application Clusters	12	2 035 856,00	24 430 272,00
4	Oracle Partitioning	12	1 017 928,00	12 215 136,00
5	Oracle Advanced Compression	12	1 017 928,00	12 215 136,00
6	Oracle Advanced Security	12	1 327 732,00	15 932 784,00
7	Oracle Diagnostic Pack	12	663 866,00	7 966 392,00
8	Oracle Tuning Pack	12	442 578,00	5 310 936,00
9	Oracle Weblogic Enterprise Edition	20	2 212 886,00	44 257 720,00
10	Oracle Active Data Guard	12	1 017 928,00	12 215 136,00
11	Oracle Audit Vault and Database Firewall	12	531 091,00	6 373 092,00
Vlera pa TVSH				236 068 828,00 ALL
TVSH				47 213 765,60 ALL
Vlera Totale me TVSH				283 282 593,60 ALL

Me paraqitjen nga DPT, dhe shqyrtimin nga grupi i auditimit të draft Raportit përfundimtar: Raporti Implementimi për Rritjen e Kapaciteteve Hardware për Sistemin e Fiskalizimit, me nr. 120 prot., të datës 08.06.2023 të OE, si dhe duke iu referuar edhe komunikimit përmes postës elektronike ndërmjet personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës me Autoritetin Kontraktor – AKSHI-n, të datës 20.12.2022, rezulton se janë kryer siç duhet, konform parashikimeve në Kontratë testimet dhe instalimet për furnizimin e licencave të sipërpërmendura. Përmes Urdhër Shpenzimit nr. 1326 datë. 29.12.2022, është kryer pagesa, likuidimi për faturën 372/2022, në vlerën 283 282 594 lekë.

Përmes Aktit të Marrjes në dorëzim të datës 12 Janar 2023, të hedhur dhe nënshkruar elektronikisht në sistemin SMK të ndjekjes së zbatimit të Kontratave, përkatësisht në datat 14.02.2023 dhe 15.02. 2023, janë pranuar dy zëra për shërbimet e ofruara, përkatësisht:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Vlera pa TVSH
1	Përmirësimi i Oracle Exadata database Rack -1, X7-2 High Capacity - (HC) Exadata Database Machine X7-2 Eighth Rack to Quarter Rack Database Server Upgrade	1	8 784 536.00 ALL
2	Përmirësimi i Oracle Exadata database Rack -2 , X7-2 High Capacity - (HC) Exadata Database Machine X7-2 Eighth Rack to Quarter Rack Database Server Upgrade	1	8 784 536.00 ALL
Vlera pa TVSH			17 569 072.00 ALL
TVSH			3 513 814.40 ALL
Vlera Totale me TVSH			21 082 886,40 ALL

Akti i dorëzimit nga OE për këtë furnizim/ ofrim shërbimi është ngarkuar në SMK në datën 12 Janar 2023 dhe është nënshkruar elektronikisht në SMK, si dokument nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës në datat 14.02.2023 dhe 15.02.2023. Edhe Dokumentacioni shoqëruar për Licencat dhe Garancitë është hedhur në sistemin SMK në datën 12.01.2023 dhe është nënshkruar e pranuar nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës në datat 14.02.2023 dhe 15.02.2023.

Përmes Urdhër Shpenzimit nr. 225 të datës 17.03.2023, është kryer pagesa lidhur me Faturën elektronike të fiskalizuar me nr. 5 të datës 12.01.2023. Kjo Faturë ka edhe këto praktika bashkëngjitur: Letër Garancie nr. 14, datë 12.01.2023, Akt Marrje në Dorëzim, me datë 12.01.2023, Akt Dorëzimi të datë 12. 01.2023 dhe Akt Dorëzimi nr. 15 datë 12. 01.2023, si dhe shkresa përcjellëse nr. 16 datë 12.01.2023. Për sa më sipër e gjithë kjo praktikë është nënshkruar elektronikisht në datat 14.02.2023 dhe 15.02.2023. Fletë Hyrja Nr. 1 mban po datën 12.01.2023. Kemi një vonesë 1 mujore, në nënshkrim/ pranimin për lëvrimin / furnizimin nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kontratës.

Sqarojmë se afati i fundit i zbatimit të kësaj kontrate është data 19.07.2023 dhe objekti i punës audituese të Grupit të Punës është deri në datën 30.04.2023. Pavarësisht sa më sipër, ne si grup auditimi kemi disponuar, shqyrtuar dhe audituar edhe draft Raportin final të OE me nr. 120 prot., të datës 08.06.2023 të OE, raport në të cilin janë evidentuar dhe raportuar instalimet, testimet dhe konfigurimet e kryera përgjatë kohës së zbatimit të projektit/ Kontratës Nr. 30.

Nga auditimi u konstatua se pagesat janë kryer në një rast edhe përtej afatit 30 ditor të parashikuar në kushtet e Kontratës, veprim ky i justifikuar me vonesat në nënshkrim dhe me mungesën e fondeve. Përgjithësisht nënshkrimi ka data të ndryshme dhe në raste të caktuara ka edhe vonesa nga disa ditore deri në 1 (një) muaj nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të Kontratës.

Si përfundim, nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.30, datë 20.10.2022 me objekt “*Rritja e Kapaciteteve Hardware për Sistemin e Fiskalizimit-për DPT*”, me vlerë 425,353,716 lekë me TVSH, me afat zbatimi 9 muaj dhe ndjekës kontrate punonjësit GjN, AG(A), si përfaqësues të AKSHI-t dhe IL si përfaqësuese e DPT, u konstatua se:

- Dokumenti i ngarkuar në sistem si “Plani i zbatimit të kontratës” nuk përmban një numër protokollit dhe datë protokollit;
- Plani i zbatimit të kontratës është nënshkruar me një vonesë prej tre javë kalendarike nga data e nënshkrimit të Kontratës. Gjithashtu, plani i zbatimit të kontratës nuk është nënshkruar nga OE, në kundërshtim me nenin 124, pika 3 e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 107 në VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- Raporti fillestar nuk është paraqitur brenda afatit 5 ditor sipas përcaktimeve në kontratë.
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës vetëm në një rast janë bërë përtej afatit 1 muaj, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë perioda e pranimin të raportimit;

Parregullsitë e mësipërme janë në kundërshtim me:

Përcaktimet në pikat 2 dhe 3 të nenit nr. 124, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

Përcaktimet sipas pikës 7, të nenit 107, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”;

Përcaktimet në Kushtet e Veçanta të Kontratës nr. 30, si dhe në përcaktimet në pikën 54 të Udhëzimit nr.30 të datës 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

- **Mirëmbajtja e Infrastrukturës hostuese e sistemit e-Taxation - për DPT**

Ecuria e zbatimit të kontratës nr. 46 prot., datë 06.01.2021, lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI dhe OE IS shpk me NIPT J..... Kontrata ka për objekt “Mirëmbajtja e Infrastrukturës hostuese e sistemit e- Taxation për DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”. Vlera totale e Kontratës është 64,390,560 lekë, pa TVSH dhe

77,268,672 lekë me TVSH. Kontrata ka afat mirëmbajtje 24 muaj nga nënshkrimi, 06.01.2021 – 05.01.2023.

Kjo Kontratë për ofrimin e mirëmbajtjes së infrastrukturës hostuese e-Taxation, ka synuar në: Qëllimi: IS shpk ka ofruar ekspertizën e tij për mirëmbajtjen e infrastrukturës hostuese të Sistemit Tatimor e-Taxation për një periudhë 2 vjeçare.

Objekti kryesor i këtij shërbimi është “Mirëmbajtja e Infrastrukturës hostuese të Sistemeve E-Taxation”, në çdo komponent të tij, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në mbi 99.95%. Mbi këtë infrastrukturë janë ngritur dy sistemet e E-taxation, përkatësisht C@TS dhe e-filing.

Infrastruktura hostuese e sistemeve, në tërësinë e vet, përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

- Infrastruktura Server & Storage;
- Shërbimet mbështetëse Infrastrukturore;
- Infrastruktura e rrjetit e sistemit Tatimor.

OE IS në Ofertën e tij ka deklaruar se oferta në thelb synon procesin e mirëmbajtjes së pajisjeve të sipërpërmendura. Po ashtu, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mund t'i lindë nevoja që herë pas here të kërkojnë azhurnimin, përmirësimin apo modifikimin e Infrastrukturës. Kështu krahas objektit kryesor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet kësaj kontrate shërbimi do të përfitojë edhe shërbimet e mëposhtme:

Këshillimi teknik dhe konsulenca; Monitorimin aktiv të pajisjeve përbërëse të infrastrukturës Server, Storage dhe i Infrastrukturës së rrjetit; Monitorim të shërbimeve mbështetëse të infrastrukturës; Shërbime të tjera përmirësimi apo optimizimi në infrastrukturë.

Për sa është parashtruar për mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e kësaj infrastrukture shumë të rëndësishme të DPT-s është lidhur Kontrata nr. 46 prot., datë 06.01.2021 me objekt “Mirëmbajtja e Infrastrukturës hostuese e-Taxation”, ndërmjet Agjencia Shtetërore e Shoqërisë së Informacionit- AKSHI, si Autoriteti Kontraktor dhe IS shpk, Kontraktuesi, Ofruesi i Shërbimit, me përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve- DPT.

Në sistemin elektronik për menaxhimin e kontratave është ngarkuar Urdhri Nr. 46/8, datë 04.07.2022, për caktimin e personave ndjekës të Kontratës: MV, AA dhe FS. Në komunikimin ndërmjet AKSHI-t dhe DPT sqarohet se RM do të jetë personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të DPT. Të dhënat lidhur me personat përgjegjës për ndjekjen e kësaj kontrate kanë rezultuar nga emrat nënshkruar të raporteve periodike të mirëmbajtjes.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin dhjetor** 2022 me nr. 18/2023, datë 06.01.2023 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.12.2022 – 05.01.2023, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur dhe nënshkruar nga JDh (OE) në sistemin SMK në datë 09.01.2023. Fatura është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, AG në datën 25.01.2023, MV në datën 19.01.2023, FS në datën 19.01.2023. Raporti mujor prej 91 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 09.01.2023, është nënshkruar nga JDh (OE) në datë 09.11.2022. Ky Raport është nënshkruar nga përfaqësuesit e AKSHI-it, përkatësisht MV në datë 19.01.2023, AG në datë 25.01.2022 dhe FS në datën 19.01.2023. Nga nënshkrimi OE në datat e nënshkrimit të personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës në emër të AKSHI-it janë përkatësisht dhjetë ditë dhe pesëmbëdhjetë ditë kalendarike vonesë.

Nga auditimi rezulton se mungon Akt pranimi për këtë periudhë mirëmbajtje, në kundërshtim me përcaktimin në Kushtet e Veçanta të Kontratës germa b e pikës 10.2, të nenit 10 të Kontratës.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin nëntor** 2022 me nr. 2207/2022, datë 06.12.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.11.2022 – 05.12.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datën 07.12.2022 dhe nuk është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, AG, MV, FS. Raporti mujor prej 159 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 07.12.2022, është nënshkruar nga JDh (OE) në datë 07.12.2022. Ky Raport i shkarkuar nuk është nënshkruar nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV, AG dhe FS.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin tetor** 2022 me nr. 1973/2022, datë 07.11.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.10.2022 – 05.11.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datë 07.11.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, AG në datë 15.11.2022 dhe MV në datën 15.11.2022. Po ashtu edhe FS e ka nënshkruar faturën në datën 13.11.2022. Raporti mujor prej 139 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 07.11.2022, është nënshkruar nga JD (OE) në datë 07.11.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV në datën 15.11.2022, AG në datën 15.11.2022 dhe FS në datën 13.11.2022. PAGESA për këtë periudhë mirëmbajtje është kryer përmes Urdhër Shpenzimit Nr 1289 datë 20.12.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin shtator** 2022 me nr. 1734/2022, datë 06.10.2021 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.09.2022 – 05.10.2022, në vlerën 2,682,940 Lekë pa TVSH dhe 3,219,528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datën 07.09.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, AG në datë 03.10.2022 dhe MV datë 03.10.2022. Po ashtu, FS e ka nënshkruar faturën në datë 03.10.2022. Raporti mujor prej 68 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datën 07.10.2022, është nënshkruar nga JDh (OE) në datë 07.10.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV datë 19.10.2022, AG në datën 19.10.2022 dhe FS në datën 19.10.2022. Konstatohet nënshkrimi me vonesë në SMK. Likuidimi është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr.1144, datë 17.11.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin gusht** 2022 me nr. 1531/2022, datë 06.09.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.08.2022 – 05.09.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datën 07.09.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, AG në datën 03.10.2022 dhe MV datë 03.10.2022. Po ashtu, edhe FS e ka nënshkruar faturën në datë 03.10.2022. Raporti mujor prej 155 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 07.09.2022, është nënshkruar nga JDh (OE) në datë 07.09.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV datë 03.10.2022, AG në datën 03.10.2022 dhe FS në datën 03.10.2022. Konstatohet nënshkrimi me vonesë në SMK. Likuidimi është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr.1143, datë 15.11.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin korrik** 2022 me nr. 1350/2022, datë 08.08.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.07.2022 – 05.08.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datën 09.08.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, AG në datë 26.08.2022 dhe FS në datën 29.08.2022. Nuk është e lexueshme data e nënshkrimit prej OE dhe nga përfaqësuesja e AKSHI-it MV. Raporti mujor prej 92 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 08.08.2022, është nënshkruar nga JD (OE) në datë 08.08.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV datë 02.09.2022, AG në datë 26.08.2022. Në këtë raportim rezulton se ka nënshkruar edhe FS në datën 29.08.2022. Likuidimi është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr.1142, datë 15.11.2022.

Konstatohet nënshkrimi me 22 ditë vonesë nga dy personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin qershor** 2022 me nr. 1199/2022, datë 06.07.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.06.2022 – 05.07.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datën 07.07.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, AG në datë 26.08.2022 dhe FS datë 29.08.2022. Nuk është e lexueshme data e nënshkrimit prej OE dhe nga përfaqësuesja e AKSHI-it MV. Raporti mujor prej 307 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datën 06.07.2022, është nënshkruar nga JDh (OE) në datë 06.07.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it, përkatësisht MV datë 02.09.2022, AG datë 26.08.2022. Në këtë raportim rezulton se ka nënshkruar edhe FS në datën 29.08.2022. Nënshkrimi në SMK pothuajse 52 ditë me vonesë. Likuidimi është kryer përmes Urdhër Shpenzimit Nr.1040, datë 04.11.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin maj** 2022 me nr. 966/2022, datë 06.06.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.05.2022 – 05.06.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datë 06.06.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, MV datë 07.06.2022, si dhe në datë 08.06.2022 AG. Raporti mujor prej 288 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 06.06.2022, është nënshkruar nga JDh (OE) në datë 06.06.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV datë 08.06.2022 dhe AG në datën 07.06.2022. Likuidimi është kryer përmes Urdhër Shpenzimit Nr.1145, datë 17.11.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin prill** 2022 me nr. 766/2022, datë 06.05.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.04.2022 – 05.05.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datën 06.05.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, MV datë 12.05.2022. Nuk është qartësisht e lexueshme data e nënshkrimit elektronik për AG, si dhe përfaqësuesja e OE, JDh. Raporti mujor prej 280 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 06.05.2022, është nënshkruar nga JDh (OE) në datë 06.05.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV datë 12.05.2022 dhe AG, datë 13.05.2022. Afati kohor nga nënshkrimi OE dhe përfaqësuesit e AKSHI-it 6 dhe 7 ditë kalendarike. Pagesa nga ana e DPT është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr. 418 datë 02.06.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin mars** 2022 me nr. 605/2022, datë 06.04.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.03.2022 – 05.04.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datën 06.04.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, MV datë 19.04.2022 dhe AG datë 19.04.2022. Raporti mujor prej 217 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 07.04.2022, është nënshkruar nga JD (OE) në datë 11.04.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV datë 19.04.2022 dhe AG datë 19.04.2022. Afati kohor nga nënshkrimi OE dhe përfaqësuesit e AKSHI-it është 8 ditë kalendarike. Pagesa nga ana e DPT është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr. 417 datë 02.06.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin shkurt** 2022 me nr. 348/2022, datë 07.03.2022 për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.02.2022 – 05.03.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë është hedhur në sistemin SMK në datë 07.03.2022 dhe është nënshkruar nga personat përgjegjës për ndjekjen e kontratës në emër të AKSHI-it, MV datë 23.03.2022 dhe AG në datën 29.03.2022. Raporti mujor prej

232 faqesh për mirëmbajtjen i hedhur nga OE në datë 07.03.2022, është nënshkruar nga JD në datën 07.03.2022, si dhe nga përfaqësuesit e AKSHI-it përkatësisht MV datë 23.03.2022 dhe AG, datë 29.03.2022. Afati kohor nga nënshkrimi OE dhe përfaqësuesit e AKSHI-it 16 ditë dhe 22 ditë kalendarike. Pagesa nga ana e DPT është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr. 416, datë 02.06.2022.

Fatura elektronike e fiskalizuar për **muajin janar 2022** me nr. 166/2022, për periudhën e mirëmbajtjes 06.01.2022 – 05.02.2022, me vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Fatura është nënshkruar në sistemin elektronik në datë 22.02.2022 nga AG. Të dhënat për datën e nënshkrimit nga ana e OE dhe anëtari tjetër MV e AKSHI-it, janë të palexueshme. Raporti OE i datë 07.02.2022 prej 180 faqesh rendit ecurinë e ndjekjes së ofrimit të shërbimit nga ana e OE për komponentët e sistemit e-Taxation. Ky raport është nënshkruar në sistem në datë 09.02.2022 nga ana e JDh, në datë 22.02.2022 nga AG dhe në datë 23.02.2022 nga MV. Pagesa nga ana e DPT është kryer përmes Urdhër Shpenzimit Nr. 415, datë 02.06.2022.

Për muajin **janar 2021**, AKSHI përmes shkresës me Nr. 928/1 të datë 22.02.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Elektronike të OE-IS me nr. 48/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 06.01.2021 – 05.02.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara ndaj përfituesit (DPT), përpara kryerjes së pagesës. Po ashtu, përmes kësaj shkrese AKSHI i ka bërë me dije Institucionit përfitues DPT se personi përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kontratës Nr. 46 prot., të datë 06.01.2021 do të jetë RM, si përfaqësuese e DPT. Nuk ka të dhëna lidhur me Urdhrin për caktimin nga Autoriteti Kontraktor- AKSHI të dy personave përgjegjës për ndjekjen e kësaj kontrate. Si Fatura Elektronike ashtu edhe Raporti i OE janë nënshkruar nga AG, nga MV, si dhe nga ana e RM si përfaqësuese e DPT. Përmes Urdhër Shpenzimit nr. 183 datë 2.04.2021 është kryer pagesa nga ana e DPT. Si akt pranimi është konsideruar nënshkrimi i raportit periodik të OE.

Për muajin **shkurt 2021**, IS përmes shkresës me nr. 385 të datë 10.03.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Elektronike të IS me nr. 85/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 06.02.2021 – 05.03.2021, për shërbimet e ofruara ndaj përfituesit (DPT) për konfirmimin e tyre. Si Fatura Elektronike ashtu edhe Raporti i OE janë nënshkruar nga AG, nga MV, si dhe nga ana e RM si përfaqësuese e DPT. Përmes Urdhër Shpenzimit nr. 183, datë 2.04.2021 është kryer pagesa nga ana e DPT. Si Akti Pranimi është konsideruar firmosja e Raportit të OE.

Për muajin **mars 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 2161/1, datë 23.04.2021, i ka përcjellë DPT Faturën elektronike të IS me nr. 126/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 06.03.2021 – 05.04.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara ndaj përfituesit (DPT), përpara kryerjes së pagesës. Po ashtu, përmes kësaj shkrese AKSHI i ka bërë me dije përsëri, Institucionit përfitues DPT, se personi përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kontratës nr. 46 prot., të datës 06.01.2021 do të jetë RM, si përfaqësuese e DPT. Si Fatura Elektronike ashtu edhe Raporti i OE janë nënshkruar nga AG dhe nga MV dhe, Raporti mban datën 08.04.2021. Mungon nënshkrimi nga ana e RM. Përmes Urdhër Shpenzimit nr. 586 datë 05.07.2021 është kryer pagesa nga ana e DPT.

Për muajin **prill 2021**, AKSHI përmes shkresës me Nr. 3311/1 të datës 27.05.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Elektronike të IS me nr. 167/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 06.04.2021 – 06.05.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara ndaj përfituesit (DPT), përpara kryerjes së pagesës. Si Fatura Elektronike ashtu edhe Raporti i OE janë nënshkruar nga AG dhe MV, në datën 11.05.2021. Mungon nënshkrimi nga ana e RM. Likuidimi është kryer përmes Urdhër Shpenzimit Nr.453, datë 04.06.2021.

Për muajin **maj 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 3911/1, të datës 28.06.2021, i ka përcjellë përfituesit të shërbimit (DPT) Faturën elektronike me nr. 203/2021, datë 09.06.2021 për periudhën e 06.05.2021 – 05.06.2021. Fatura elektronike është nënshkruar nga RM, ndërsa Raporti për Shërbimin e ofruar nga ana e OE është nënshkruar nga MV, AG. Si akt pranimi është konsideruar firmosja e raportit përkatës të OE. Likuidimi është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr.599, datë 12.07.2021.

Për muajin **qershor 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 4745/1 të datës 27.07.2021, i ka përcjellë përfituesit të shërbimit (DPT) Faturën elektronike me nr. 255/2021, datë 08.07.2021 për periudhën e ofrimit të shërbimit 06.06.2021 – 05.07.2021. Fatura elektronike është nënshkruar nga MV, AG. *Në këtë praktikë pagese ka një shënim verbal, me laps: RM, larguar.* Pagesa është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr.669, datë 06.08.2021.

Për muajin **korrik 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 5269/1 prot., të datës 25.08.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të IS me nr. 386/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 06.07.2021 – 05.08.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Si Fatura Tatimore ashtu edhe Raporti i OE, janë nënshkruar nga ana e MV dhe AG. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 749 Prot. mungon nënshkrimi nga ana e RM. Pagesa është kryer nëpërmjet Urdhër Shpenzimit Nr. 749, datë 10.09.2021.

Për muajin **gusht 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 5837/1 prot., të datës 29.09.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të IS me nr. 588/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 05.08.2021 – 05.09.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Si Fatura Tatimore ashtu edhe Raporti i OE, janë nënshkruar nga ana e MV dhe AG në datën 09.09.2021. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 749, mungon nënshkrimi nga ana e RM. Pagesa është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr. 852 të datës 25.10.2021.

Për muajin **tetor 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 7667/1 prot., të datë 25.11.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të IS me nr. 914/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 06.10. 2021 – 05.11.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Si Fatura Tatimore ashtu edhe Raporti i OE, janë nënshkruar nga ana e MV dhe AG. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit Nr. 1090, mungon nënshkrimi nga personi përfaqësues i DPT. Pagesa është kryer përmes Urdhër Shpenzimit Nr. 1090 të datës 10.12.2021.

Për muajin **nëntor 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 8371/1 prot., të datës 15.12.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të IS me nr. 1097/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 06.11. 2021 – 05.12.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Fatura elektronike e fiskalizuar e OE për këtë periudhë mirëmbajtje 06.11.2021 – 05.12.2021, me Nr. 1097/2021, e datës 06.12.2021. Nga nënshkrimi elektronik kuptohen vetëm të dhëna për datën 16.12.2021 për anëtarin e ndjekjes së Kontratës AG, pasi të dhënat për anëtarin tjetër janë të mbivendosura. Raporti i Mirëmbajtjes për këtë periudhë raportimi, prej 283 faqesh, mban datën 06.12.2021, është nënshkruar nga JDh (OE) në datën 09.12.2021, në datën 16.12.2021 nga AG dhe në datën 17.12.2021 nga MV. Si Fatura Tatimore ashtu edhe Raporti i OE, janë nënshkruar nga ana e MV dhe AG. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 1090, mungon nënshkrimi nga personi përgjegjës për DPT. Pagesa është kryer përmes Urdhër Shpenzimit nr. 1209 të datës 24.12.2021.

Fatura elektronike e fiskalizuar **muaji dhjetor 2021** me nr. 13/2022 është hedhur në sistem në datën 06.01.2022, për likuidimin e shërbimit të ofruar për periudhën kohore 06.12.2021 – 05.01.2022, në vlerën 2 682 940 Lekë pa TVSH dhe 3 219 528 Lekë me TVSH. Kjo Faturë

është nënshkruar në sistem nga JD (OE) në një datë të palexueshme. Kuptohet vetëm data e nënshkrimit për AG, datë 07.02.2022. Raportimi mujor për periudhën 6 dhjetor 2021 deri në 5 janar 2022 prej 166 faqesh rendit problematikën e ndjekur dhe mbulimin e mirëmbajtjes nga ana e OE. Është nënshkruar në datën 06.01.2022 nga JD (OE), në datën 07.02.2022 nga AG dhe në datën 08.02.2022 nga MV. Afati kohor nga data e nënshkrimit të OE në datën e nënshkrimit të personave ndjekës të Kontratës nga AKSHI, 31 ditë kalendarike. Pagesa për këtë shërbim është kryer përmes Urdhër Shpenzimit Nr. 558 datë 22.06.2022. Ashtu si edhe për periudhat e tjera të raportimit nuk kemi Akt pranimit për shërbimin e mirëmbajtjes, por kemi vetëm nënshkrimin e Raportit të mirëmbajtjes sjellë nga OE.

Problematikat dhe çështjet e konstatuara nga auditimi, si mungesa e Akteve të Pranimit; nënshkrimet përtej afateve të përcaktuara në KVK; mungesë nënshkrimi nga RM; paqartësi në disa dokumente të ngarkuara përmes platformës së mbikëqyrjes elektronike të ecurisë së zbatimit të Kontratave. Nga auditimi rezulton se janë nënshkruar Raportet periodike të Operatorit Ekonomik – OE, nga ana e personave të caktuar për ndjekjen e Kontratës, por nuk ka Akte Pranimit.

Rregullorja për miratimin e mënyrës së funksionimit dhe përgjegjësitë e funksionaliteteve të Sistemit të Menaxhimit elektronik të ndjekjes së Kontratave- SMK, është miratuar nga ana e Drejtoreshës së Agjencisë Shtetërore për Shoqërinë e Informacionit- AKSHI, përmes Urdhrit nr. 7157, datë 20.10.2021. Kjo Rregullore është zbatuar për raportimet e vitit 2022.

Vënia në zbatim e rregullores së miratuar me urdhrin nr. 7157 prot., datë 20.10.2021 të titullarit të AKSHI-t, nuk përjashton zbatimin rigoroz të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, që rregullojnë ndjekjen dhe zbatimin e kontratave.

Si përfundim, nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.46, datë 06.01.2021 me objekt “Mirëmbajtja e Infrastrukturës hostuese e sistemit e- Taxation për DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, me afat zbatimi 24 muaj, nga data e nënshkrimit dhe ndjekës kontrate punonjësit MV, AG(x) si përfaqësues të AKSHI-t dhe RM, zëvendësuar me FS si përfaqësuese e DPT, u konstatua se:

- Janë nënshkruar vetëm raportet periodike të periudhave përkatëse, por mungojnë Aktet e Pranimit për shërbimet e ofruara;
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës, janë bërë përtej afateve të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit, prej tre ditësh;
- Pagesat e kryera përkatësisht në Prill, Qershor, Nëntor dhe Dhjetor dhe jo sipas muajve, për shërbimet e ofruara.

Parregullsitë e mësipërme janë në kundërshtim me:

Përcaktimet në pikën 1 të nenit nr. 59, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

Përcaktimet sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Përcaktimet në Kushtet e Veçanta të Kontratës nr.46,

Përcaktimet në Rregulloren nr. 7157 datë 20.10.2021, si dhe në përcaktimet në pikën 54 të Udhëzimit nr.30 të datës 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar

- **Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi qendëruar për DRT/DPT (Faza 2) për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve**

Ecuria e zbatimit të kontratës nr. 7047 prot., datë 28.12.2020, lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI dhe OE AXX shpk me NIPT Kxxxxxx. Kontrata ka për objekt “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistemi telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DRT/DPT (Faza 2)- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”. Vlera totale e Kontratës është 105,290,000 lekë, pa TVSH dhe 126,348,000 lekë me TVSH. Kontrata ka katër muaj implementim dhe afat mirëmbajtje 24 muaj, pas implementimit.

Objektivi i këtij projekti ishte përmirësimi i pajisjeve dhe topologjisë së rrjetit, sistemit CCTV, sistemit të kontrollit të aksesit dhe atij telefonik VoIP për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, duke përdorur teknologji bashkëkohore.

Projekti ka patur si qëllim përmirësimin e rrjetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale nëpër rrethe. Përmirësimi ka konsistuar në kuptimin e rritjes së shpejtësisë së transmetimit në rrjet, si dhe modifikimi i konfigurimit të rrjetit. Kjo është realizuar përmes zëvendësimit të pajisjeve të vjetërsuara dhe ri konfigurimit të topologjisë në mënyrë që të arrihet një funksionim më eficient të infrastrukturës së rrjetit.

Përmes zgjidhjes synohet të arrihet përbushja e kërkesave për realizimin e detyrave të përcaktuara, si:

- Zëvendësimi i pajisjeve të vjetërsuara të rrjetit, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të reja;
- Përmirësimi i topologjisë së rrjetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale, ri konceptimi i topologjisë së rrjetit;
- Zëvendësimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të sigurisë firewall / Router të pajisur me licenca sigurie dhe mbrojtje e përdoruesve fundorë, ri konceptimi i topologjisë së re të rrjetit;
- Zëvendësimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të rrjetit nëpër degët e drejtorive rajonale të tatimeve nëpër rrethe;
- Konfigurimi i pajisjeve të rrjetit dhe integrimi në topologjinë e re të pajisjeve aktuale;
- Implementimi i sistemit CCTV për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve;
- Implementimi i sistemit të kontrollit të aksesit për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve;
- Implementimi i sistemit telefonik VoIP për Drejtorinë Rajonale Tatimore;
- Testimet për mirëfunksionimin e pajisjeve dhe sistemeve;
- Trajnimi i punonjësve/ përdoruesve dhe stafit IT për të gjitha pjesët e Projektit
- Realizimi i mirëmbajtjes.

Rezultatet e pritura me implementimin e Projektit do të sjellin rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimeve IT për përdoruesit e brendshëm; rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit; rritjen e performancës së shërbimeve të brendshme; si dhe mbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve në gjendje pune, funksionale.

Përmes shkresës me nr. 7041 Prot., të datës 28.12.2020, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit- AKSHI i është drejtuar Operatorit Ekonomik AXX, përmes Formularit të Njoftimit të Fituesit, me njoftimin si ofertë fituese dhe i është kërkuar AXX që të paraqesë brenda 5 (pesë) ditëve Sigurimin e Kontratës. Kontrata është lidhur po në datën 28.12.2020, ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit –AKSHI dhe AXX.

Si përfundim, objektivi i këtij projekti, siç u përmend edhe më sipër, ka qenë përmirësimi i pajisjeve dhe topologjisë së rrjetit, sistemit CCTV të monitorimit me kamera, sistemi për kontrollin e aksesit dhe atij telefonik VoIP për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, duke përdorur teknologji bashkëkohore.

Në nenin 10 të Kushteve të Veçanta të Kontratës specifikohet mënyra e pranimit të shërbimeve të ofruara, si pjesë e kësaj Kontrate nëpërmjet testimeve të pranimit (pika 10.2).

Sipas parashikimit në pikën 9, të Kontratës, *Afati Kohor i Implementimit të Projektit*, afatet kohore për analizimin e situatës, lëvrimin e pajisjeve, instalimin, konfigurimin, testimin dhe trajnimin dhe marrjen në dorëzim, ishte parashikuar një periudhë kohore prej 4 (katër) muajsh, ndërsa pas muajit të katërt, me marrjen në dorëzim, do të fillonte periudha 24 mujore për shërbimin e mirëmbajtjes.

Përmes Urdhër Shpenzimit Nr. **188** të datës **21.04.2022** është kryer pagesa në vlerën 26 401 524 Lekë, OE AXX. OE - AXX përmes shkresës me nr. 23 prot., të datës 19.03.2021 ka kërkuar lëvrim të pjesshëm. Fatura elektronike e OE me numër 54/2021 është lëshuar po në datën 19.03.2021. Certifikata e Garancisë për artikujt, mallrat e lëvuara me sasi të, numrat e artikujve, si dhe numrat serial për një afat një vjeçar (një vit), nga data e lëshimit 19.03.2021. Akti i Dorëzimit për produktet dhe licencat e furnizuara rezulton të jetë i nënshkruar nga DF, si dhe MV për AKSHI-in, si dhe nga IK për Institucionin përfitues DPT, person ndjekës Kontrate në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve –DPT. Në emër të OE- AXX ka nënshkruar IT. Aktit të Dorëzimit i janë bashkëngjitur numrat serial të pajisjeve, produkteve, mallrave të furnizuara, si dhe fletët me të dhënat teknike të tyre.

Përmes Proces Verbalit me nr. **1708/1** të datës **19.03.2021**, nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, për Autoritetin Kontraktor – AKSHI: DF dhe MV dhe për Autoritetin Përfitues –DPT IK, dhe për Operatorin Ekonomik – OE (AXX) IT.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – **DPT** përmes Urdhër Shpenzimit nr.189, datë 21.04.2021, ka kryer likuidimin në vlerën **5 944 704 lekë**. Pavarësisht kësaj date, likuidimi, si i prapambetur, rezulton të jetë kryer në datë 30.06.2021.

AKSHI në datën 7.05.2021, përmes shkresës me nr. 2940/2 i ka përcjellë DPT-së dokumentacionin për zbatimin e Kontratës me nr. 7047 të datë 28.12.2020. Si pjesë e këtij dokumentacioni të përcjellë janë: Fatura Tatimore e fiskalizuar me nr. 77/2021, datë 28.04.2021; Akt Marrje në Dorëzim me nr. 2940/1, datë 28.04.2021. Proces Verbalit me nr.2940/1 datë 28.04.2021, është nënshkruar nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës: për Autoritetin Kontraktor (AKSHI): DF dhe MV, për Autoritetin Përfitues (DPT): IK, dhe për Operatorin Ekonomik – OE (AXX): IT. Shkresa përcjellëse e OE lidhur me sa më sipër më nr. 36/1 dhe 36/2 datë 28.04.2021 me objekt: “Njoftim Përfundim Punimesh”, i ka paraqitur Autoritetit Kontraktor – AKSHI dhe Institucionit përfitues – DPT:

1. Njoftimin për përfundimin e punimeve;
2. Raportin Përfundimtar;
3. Akt Dorëzimit;
4. Faturën Tatimore të fiskalizuar nr.77 datë 28.04.2021, me afat vlefshmërie / Maturimi datën 30.06.2021, si dhe
5. Proces Verbalet e Dorëzimeve, pranimeve nga Drejtoritë Tatimore Rajonale.

Të gjitha praktikat e sipërpërmendura janë nënshkruar nga DF, MV -AKSHI, nga IK DPT dhe për AXX - OE IT. Përmes Aktit të Marrjes në Dorëzim të datës 28.04.2021, është pranuar marrja në dorëzim sipas zërave të mallrave të furnizuar, me numrat serial, certifikatat e garancisë si dhe detajet e tjera për shumën (vlerën) totale prej 5 944 704 lekë me TVSh.

Për muajin **prill 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 3645/1 prot., datë 23.06.2021, i ka përcjellë DPT-s Faturën Tatimore të OE- AXX me nr. 98/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 28.04.2021 – 27.05.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV dhe DF, si dhe nga IK. Raporti i mirëmbajtjes me nr. 3645, datë 28.05.2021 i OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse, ndjekëse të Kontratës nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 587, datë 05.07.2021, mungon Akt Pranimi nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, por është nënshkruar raporti mirëmbajtjes.

Për muajin **maj 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 3645/1 prot., të datës 23.06.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të AXX me nr. 98/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 28.04.2021 – 27.05.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV dhe DF, si dhe nga IK Raporti i mirëmbajtjes me nr. 3645, datë 28.05.2021 i OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse (AKSHI), ndjekëse të Kontratës nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 587, datë 05.07.2021, mungon Akt Pranimi nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, por është nënshkruar raporti i mirëmbajtjes.

Për muajin **qershor 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 4447/1 prot., të datës 15.07.2021, i ka përcjellë DPT faturën tatimore të AXX me nr. 114/2021, si dhe raportin periodik të datës 28.06.2021, për shërbimet e kryera për periudhën 28.05.2021 – 27.06.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV dhe DF, si dhe nga IK. Raporti i mirëmbajtjes me nr. 54, datë 28.06.2021 i OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse, ndjekëse të Kontratës nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 666, datë 04.08.2021, mungon Akt Pranimi nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, por siç u sqarua edhe më sipër është nënshkruar raporti periodik i mirëmbajtjes.

Për muajin **korrik 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 5085/1 prot., të datës 23.08.2021, i ka përcjellë DPT faturën tatimore të AXX, me nr. 8/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 28.05.2021 – 27.06.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV dhe DF, si dhe nga IK. Raporti i mirëmbajtjes me nr. 5085, datë 28.07.2021 i OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse, ndjekëse të Kontratës Nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 751, datë 10.09.2021, mungon Akt Pranimi por mundet që nënshkrimi i Raportit të Mirëmbajtjes nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, mund të jetë konsideruar si akt pranimi.

Për muajin **gusht 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 5591/1 prot., të datës 14.09.2021, i ka përcjellë DPT faturën tatimore të AXX me nr. 43/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 28.07.2021 – 28.08.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës, të datës 30.08.2021. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV dhe DF. Raporti i mirëmbajtjes me nr. 5591, datë 30.08.2021 i OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse, ndjekëse të Kontratës nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 855, datë 25.10.2021, mungon Akt Pranimi nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, por është nënshkruar raporti i mirëmbajtjes.

Për muajin **shtator 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 6263/1 prot., të datës 06.10.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të AXX me nr. 77/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 28.08.2021 – 27.09.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës, me nr. 83 prot., datës 28.09.2021. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV dhe DF. Raporti i mirëmbajtjes me nr. 81, datës 28.09.2021 i OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse, ndjekëse të Kontratës nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 853, datës 25.10.2021, mungon Akt por nënshkrimi i Raportit periodik të mirëmbajtjes nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, mund të jetë konsideruar si akt pranimi.

Për muajin **tetor 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 7354/1 prot., të datës 06.10.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të AXX me nr. 132/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 28.09.2021 – 28.10.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV, DF, si dhe IK në emër të DPT. Raporti i mirëmbajtjes me nr. 92, datës 28.10.2021 i sjellë nga OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse, ndjekëse të Kontratës nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 1079, datë 06.12.2021, mungon Akt Pranimi nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, por nënshkrimi në Raportin e mirëmbajtjes është konsideruar në vijimësi si pranim për shërbimin periodik të ofruar nga AXX.

Për muajin **nëntor 2021**, AKSHI përmes shkresës me nr. 8226/1 prot., të datës 16.12.2021, i ka përcjellë DPT Faturën Tatimore të AXX me nr. 177/2021, si dhe raportin periodik për shërbimet e kryera për periudhën 28.10.2021 – 27.11.2021, për konfirmimin e shërbimeve të ofruara nga ndjekësit e Kontratës, përpara kryerjes së pagesës. Fatura Tatimore e OE, është nënshkruar nga ana e MV, DF, si dhe IK në emër të DPT. Raporti i mirëmbajtjes me nr. 103, datë 01.12.2021 i OE është nënshkruar nga DF, MV si specialiste mbikëqyrëse, ndjekëse të Kontratës nr. 7047 në emër të AKSHI, nga IK në emër të DPT në datë 1.12.2021, si dhe nga IT në emër të OE. Në praktikën bashkëngjitur Urdhër Shpenzimit nr. 1208, datë 24.12.2021, mungon Akt Pranimi nga ana e personave përgjegjës për ndjekjen e Kontratës.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. 357 të datës 17.05.2022 është kryer likuidimi për muajin **dhjetor 2021**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE AXX, kjo në vijim të Faturë Elektronike të fiskalizuar me numër 235/2021, datë 28.12.2021, si dhe Raportit për shërbimin e kryer për periudhën 28.11.2021 – 28.12.2021. Këto praktika i janë përcjellë Autoritetit përfitues- DPT nga ana e Autoritetit Kontraktues – AKSHI, përmes shkresës me nr. 446 Prot, datë 21.01.2022. Raporti përkatës i Mirëmbajtjes, pjesë e kësaj praktike, i datës 28.12.2021 është nënshkruar vetëm nga ana e IK si ndjekës Kontrate në emër të DPT dhe nga IT në emër të OE- AXX.

Raporti nuk është nënshkruar nga DF dhe MV, kjo pasi për periudhën janar – mars 2022, specialistët IT të AKSHI-it tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kanë qenë të pezulluar nga puna nëpërmjet aktit: Urdhër nr. 511, datë 24.12.2021, me nr. 8669 prot., të datës 24.12.2021, të nënshkruar nga Drejtoresha e Përgjithshme e Shoqërisë së Informacionit – AKSHI. Me rikthimin në punë, pas pezullimit raportet janë firmosur me vonesë.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. 373 të datë 20.05.2022 është kryer likuidimi për muajin **janar 2022**, në vlerën 1 485 000 në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës Elektronike të fiskalizuar nr. 293, datë 28.12.2021. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i Mirëmbajtjes për periudhën 28.01.2022 – 28.02.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e Mirëmbajtjes është kryer në datën 23.03.2022. Nga ana e Institucionit përfitues – DPT, IK ka nënshkruar fizikisht, jo me nënshkrim elektronik.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. 374, datë 20.05.2022 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **mars 2022**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës Elektronike të Fiskalizuar nr. 328, datë 28.03.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 28.02.2022 – 28.03.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës Nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e mirëmbajtjes është kryer në datën 04.04.2022. Nga ana e Institucionit përfitues –DPT, IK ka nënshkruar fizikisht, jo me nënshkrim elektronik. Nga praktikat bashkëngjitur Urdhër Shpenzimeve për të dy pagesat e fundit rezulton se ka nënshkrim elektronik nga personat

përgjegjës për ndjekjen e Kontratës, si për Proces Verbalet ashtu edhe për Raportet e Mirëmbajtjes për këto dy periudha kohore, në datë 4.04.2022.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **376** të datë 20.05.2022 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **Prill 2022**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës Elektronike të Fiskalizuar nr. 356, datë 28.04.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 28.03.2022 – 28.04.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e Mirëmbajtjes është kryer në datën 05.05.2022. Nga ana e Institucionit përfitues- DPT, IK ka nënshkruar fizikisht, jo me nënshkrim elektronik.

Për kryerjen e veprimeve të nënshkrimit të faturave elektronike të fiskalizuara përmes sistemit SMK personat përgjegjës nga muaji prill 2022 e në vijim të ndjekjes së kësaj kontrate, kanë vepruar sipas Rregullores 7157. Rregullorja për miratimin e mënyrës së funksionimit dhe përgjegjësitë e funksionaliteteve të Sistemit të Menaxhimit elektronik të ndjekjes së Kontratave- SMK, është miratuar nga ana e Drejtoreshës së Agjencisë Shtetërore për Shoqërinë e Informacionit- AKSHI, përmes Urdhrit nr. 7157 datë 20.10.2021. Kjo Rregullore është zbatuar nga personat ndjekës të kontratës për raportimet e vitit 2022.

Vënia në zbatim e rregullores së miratuar me urdhrin nr. 7157 prot., datë 20.10.2021 të titullarit të AKSHI-t, nuk përjashton zbatimin rigoroz të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, që rregullojnë ndjekjen dhe zbatimin e kontratave.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. 1298 të datë 22.12.2022 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin Qershor 2022, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e faturës elektronike të fiskalizuar nr. 428, datë 28.06.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 28.05.2022 – 28.06.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e mirëmbajtjes është kryer në datën 03.10.2022. Nga Proces Verballi që mban datën 03.10.2022, rezulton se nga ane Institucionit përfitues Faturën elektronike dhe Raportin periodik të Mirëmbajtjes e ka nënshkruar FO dhe MV. Edhe nga ana e Autoritetit Kontraktor kemi ndryshim personi për ndjekjen e Kontratës. Rezulton se kjo praktikë është nënshkruar elektronikisht në emër të AKSHI-it, përveç MV edhe nga IT.

Nga auditimi rezulton se përveç ndryshimit të emrave, kemi nënshkrime të vonuara përmes sistemit elektronik të ndjekjes së kontratave – SMK.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **1299** të datës 22.12.2022 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **korrik 2022**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e faturës elektronike të fiskalizuar nr. 468, datë 28.07.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 28.06.2022 – 28.07.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e Mirëmbajtjes është kryer në datat: 19.09.2022, 26.09.2022 dhe 30.11.2022.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **1300** të datës 22.12.2022 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **shtator 2022**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës elektronike të fiskalizuar nr. 563, datë 28.09.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 28.08.2022 – 28.09.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e Mirëmbajtjes është kryer në datat: 30.09.2022 dhe 30.11.2022.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **1301** të datës 22.12.2022 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **tetor 2022**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës Elektronike të Fiskalizuar nr. 615, datën 28.10.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 28.09.2022 – 28.10.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e mirëmbajtjes është kryer në datat: 3.11.2022 dhe 24.11.2022.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **1302** të datë 22.12.2022 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **nëntor 2022**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës elektronike të fiskalizuar nr. 652, datë 30.11.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 29.10.2022 – 28.11.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e mirëmbajtjes është kryer në datën 12.12.2022.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **367** të datës 19.04.2023 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **dhjetor 2022**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës elektronike të fiskalizuar nr. 726, datë 28.12.2022. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën kohore 29.11.2022 – 28.12.2022. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e mirëmbajtjes është kryer në datat: 29.12.2022 dhe 30.12.2022.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **368** të datës 19.04.2023 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **janar 2023**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës elektronike të fiskalizuar nr. 770, datë 30.01.2023. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 28.12.2022 – 29.01.2023. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e mirëmbajtjes është kryer në datën 30.01. 2023 nga ana e OE- IT dhe në datën 08.02.2023 nga ana e personave përgjegjës të ndjekjes së Kontratës në emër të DPT.

Nëpërmjet Urdhër Shpenzimit nr. **399** të datës 27.04.2023 rezulton të jetë kryer likuidimi për muajin **mars 2023**, në vlerën 1 485 000 Lekë në favor të OE – AXX, me paraqitjen e Faturës elektronike të fiskalizuar nr. 839, datë 29.03.2023. Bashkëngjitur kësaj fature është Raporti i mirëmbajtjes për periudhën 01.03.2023 – 28.03.2023. Nënshkrimi elektronik nga personat përgjegjës për ndjekjen e Kontratës nr. 7047 për faturën elektronike dhe Raportin e mirëmbajtjes është kryer në datën 29.03.2023 nga ana e OE- IT dhe në datën 30.03.2023 nga ana e personave përgjegjës të ndjekjes së Kontratës në emër të DPT. Ashtu si edhe për periudhat e tjera të raportimit nuk kemi akt pranimit për shërbimin e mirëmbajtjes, por kemi vetëm nënshkrimin e Raportit të mirëmbajtjes të sjellë nga OE.

Problematikat dhe çështjet e konstatuara nga auditimi kanë të bëjnë me mungesa të akteve të pranimit; nënshkrimet janë kryer përtej afateve të përcaktuara në KVK; janë vërejtur paqartësi në disa dokumente të ngarkuara përmes platformës së mbikëqyrjes elektronike të ecurisë së zbatimit të Kontratave- SMK.

Si përfundim, nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.7047, datë 28.12.2020 me objekt “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistemi telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DRT/DPT (Faza 2)- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” me afat zbatimi 4 muaj implementim dhe 24 muaj mirëmbajtje, nga data e nënshkrimit dhe ndjekës kontrate punonjësit DF, MV, si përfaqësues të AKSHI-t dhe IK, zëvendësuar me FO si përfaqësues i DPT dhe po ashtu shtuar IT përfaqësuese e AKSHI-t dhe, u konstatua se:

- Janë nënshkruar vetëm raportet periodike të periudhave përkatëse të mirëmbajtjes, por mungojnë Aktet e Pranimit për shërbimet e ofruara;

- Aktet e pranimit nuk janë bërë sipas praktikave të ngjashme. Në Kontratën me nr.46 të datës 06.01.2021, në Kushtet e Veçanta të Kontratës, në germën b të pikës 10.2 specifikohet që:... Përfaqësuesit (ndjekësit e Kontratës) përpilojnë Akt marrjen në dorëzim për shërbimet mujore të mirëmbajtjes, në përputhje me Udhëzimin 30.
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës, janë bërë përtej afateve të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit prej tre ditësh;
- Pagesat e kryera përkatësisht në Prill, Qershor dhe Dhjetor, gjithnjë pas nënshkrimit të dokumenteve, por në afate kohore përtej afatit 30 ditor të përcaktuar për kryerjen e pagesave.

Parregullsitë e mësipërme janë në kundërshtim me:

Përcaktimet në pikën 1 të nenit nr. 59, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

Përcaktimet sipas pikës 1, të nenit 77, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Përcaktimet në Kushtet e Veçanta neni 10, të Kontratës nr.7047;

Përcaktimet në Rregulloren nr. 7157 datë 20.10.2021;

Përcaktimet në pikën 54 të Udhëzimit nr.30 të datës 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

- **Përmirësim i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit - për DPT**

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.6756, datë 27.11.2018 me objekt “*Përmirësim i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit*”, me vlerë 1,865,153,906 lekë pa TVSH, me afat të realizimit të shërbimeve 24 muaj dhe afat mirëmbajtjeje në 24 muajt e ardhshëm pas implementimit.

Vlera e mirëmbajtjes së software dhe hardware që janë instaluar dhe konfiguruar si pjesë e këtij projekti është 447,016,416 lekë pa TVSH ose 18,625,684 lekë në muaj pa TVSH. Ndjekës të kontratës së mirëmbajtjes kanë qenë përfaqësues të AKSHI-t punonjësit GN, DM, GP deri në shkurt të vitit 2022 i zëvendësuar me EF si dhe përfaqësues të DPT GÇ deri në mars 2022 dhe BSh prej shkurt 2022 - nëntor 2022, që është dhe fundi i kontratës. Me largimin e GÇ, DPT është përfaqësuar vetëm me një anëtar për ndjekjen e kontratës, duke e lënë gjithë peshën dhe rëndësinë e ndjekësit të kontratës me nr. 6756, datë 27.11.2018 me objekt “*Përmirësim i Modulit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit*” vetëm tek një përfaqësues.

Kapaciteti i ndjekësve të kontratës për një nga sistemet më të mëdha, më të rëndësishme në vend është:

- Përfaqësuesit nga AKSHI - Një anëtar jo me formim në teknologji informacioni, ndërsa anëtari tjetër ka filluar marrëdhëniet e punës në drejtorinë e DPT në mars të vitit 2022;

- Përfaqësuesi nga DPT - Ka filluar marrëdhëniet e punës me institucionin në vitin 2021, pra nuk ka qenë prezent në zhvillimet e informatizimit të sistemit të fiskalizimit.

Gjithashtu, JP ka qenë ndjekës i kontratës së mirëmbajtjes së sistemit të fiskalizimit për periudhën 03.08.2021 – 10.12.2021 nga ana e OE, pra deri në përfundim të kontratës. Marrëdhëniet e punës me AKSHI-n për llogari të DPT i ka filluar në 12.12.2022 e në vazhdim. Nga auditimi u konstatua se të DPT nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur ndjekjes së zbatimit të kontratës së mirëmbajtjes me nr. 6756, datë 27.11.2018, për sistemin e fiskalizimit, si një nga sistemet më të rëndësishme në vend.

Nga auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e kontratave, ku ndjekja nëpërmjet sistemit SMK për këtë kontratë ka filluar në muajin shkurt 2022, u konstatuan disa problematika trajtuar sipas periudhave më poshtë:

- Për muajin *shkurt* 2022, janë nënshkruar elektronikisht nga ndjekësit e kontratës nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave këto dokumente: *Fatura përkatëse e muajit, Raporti mujor, Shkresa përcjellëse*. Të tre dokumentet e ngarkuar në sistem janë nënshkruar nga përfaqësuesi i OE dhe ndjekësit e kontratës. Shkresa përcjellëse e raportit mujor mban datën 28.02.2022, ndërsa është protokolluar me **nr. 6756/2**, por pa datë protokollit, ndërsa është nënshkruar nga OE në datën 04.03.2022. Vihet re se një prej ndjekësve të kontratës ka nënshkruar në datën 28.03.2022, ose 20 ditë kalendarike më vonë se anëtarët e tjerë të grupit. Në këtë periudhë është zëvendësuar ndjekësi i kontratës GP me EF, të dy punonjës të strukturës së AKSHI-t për DPT.

- Për muajin *mars* 2022, ka patur një kthim nga ndjekësit e kontratës me shënimin “*Kthyer për korrigjim raporti i mirëmbajtjes*”. Në sistemin SMK nuk ka asnjë informacion shtesë për mangësitë apo parregullsitë që janë konstatuar nga ndjekësit e kontratës, që do të thotë se për korrigjimet e nevojshme që duhet të pasqyrohen nga OE, komunikimi është zhvilluar jashtë sistemit. Për raportimin e kësaj periudhe nga ndjekësit e kontratës nuk është nënshkruar shkresa përcjellëse e pajisur me numër protokollit 6756/4 dhe as shkresa përcjellëse e ngarkuar sërish pas korrigjimeve pa numër protokollit. Të dy raportet që janë ngarkuar në sistem nuk kanë ndryshim nga njëri tjetri, megjithëse është kthyer për korrigjim. Me ngarkimin e raportit të fundit të mirëmbajtjes në datën 29.03.2022 u konstatua se nga dy anëtarë pranimit i tij është bërë në 12.05.2022, ndërsa anëtari i tretë e ka pranuar në datën 23.05.2022 dhe anëtari i fundit në datën 23.06.2022. Fatura përkatëse e muajit është nënshkruar në të njëjtat ditë të nënshkrimit të raportit përfundimtar. Shkresa përcjellëse e raportit mujor mban datën 28.03.2022, ndërsa është protokolluar me **nr.6756/4**, por pa datë protokollit dhe është nënshkruar nga OE po në datën 28.03.2022, ndryshe nga muaji i mëparshëm.

Në sistemin e menaxhimit të kontratave si ndjekës kontrate apo punonjës finance nuk është e mundur të kërkosh bazuar në numrin e protokollit të dokumentit me qëllim vlerësimin nëse prokollimi i shkresës me nr. 6756/3 mungon apo një tjetër dokument ka marrë këtë numër.

- Për muajin *prill* 2022, janë nënshkruar elektronikisht nga ndjekësit e kontratës nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave këto dokumente: *Fatura përkatëse e muajit, Raporti mujor, Shkresa përcjellëse*. Të tre dokumentet e ngarkuar në sistem janë nënshkruar nga përfaqësuesi i OE dhe ndjekësit e kontratës. Shkresa përcjellëse e raportit mujor mban datën 27.04.2022, ndërsa është protokolluar me të njëjtin numër me atë të periudhës së mëparshme me **nr. 6756/4**, por pa datë protokollimi, është nënshkruar nga OE në datën 27.04.2022. Diferenca në ditë ndërmjet nënshkrimit të OE në datën 27.04.2022 dhe ndjekësve të kontratës në datën 15.09.2022, rezulton të jetë afërsisht 140 ditë, megjithëse nuk ka asnjë gjurmë raportimi mbi problematika të mundshme të sistemit.

- Për muajin *maj* 2022, ka patur një kthim nga ndjekësit e kontratës me shënimin “*Kthyer për korrigjim raporti i mirëmbajtjes*”.

Shkresa përcjellëse e raportit mujor mban datën 27.05.2022 është protokolluar me **nr. 6756/7** por pa datë protokollit, ndërsa është nënshkruar nga OE po në datën 27.05.2022.

Në sistemin e menaxhimit të kontratave si ndjekës kontrate apo punonjës finance nuk është e mundur të kërkosh bazuar në numrin e protokollit të dokumentit me qëllim vlerësimin nëse paraqet probleme prokollimi i shkresës që nuk gjendet në muajin pasardhës me **nr. 6756/5**. Dokumenti me nr. 6756/6, datë 16.05.2022 rezulton të jetë një urdhër i AK për ndjekësit e kontratës.

Ndjekësit e kontratës kanë miratuar faturën përkatëse të muajit duke e nënshkruar elektronikisht e mbivendosur nënshkrimin mbi informacione të printimit të faturës, siç paraqitet dhe më poshtë.



Nga auditimi konstatohet se gjurmimi i datave të nënshkrimit elektronik rast pas rasti është i pamundur pasi paraqitet vizualisht i mbivendosur me një tekst të faturës elektronike.

Shkresa përcjellëse e raportit mujor nuk është nënshkruar nga ndjekësit e kontratës, pra nuk është ndjekur e njëjta praktikë si në muaj të mëparshëm, çfarë tregon se ky dokument nuk ju paraqitet nga sistemi ndjekësve të kontratës apo nuk nënshkruhet nga ana e tyre.

Raporti mujor i mirëmbajtjes është nënshkruar elektronikisht nga përfaqësuesi i OE si dhe ndjekësit e kontratës. Data në të cilën ka nënshkruar OE është 27.05.2022 ndërsa data e fundit e nënshkrimit të njërit prej ndjekësve është 23.06.2022, pra afërsisht 27 ditë kalendarike më vonë.

- Për muajin **qershor** 2022, janë nënshkruar elektronikisht nga ndjekësit e kontratës nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave këto dokumente: *Fatura përkatëse e muajit, Raporti mujor, Shkresa përcjellëse*. Të tre dokumentet e ngarkuar në sistem janë nënshkruar nga përfaqësuesi i OE dhe ndjekësit e kontratës. Shkresa përcjellëse e raportit mujor mban datën 27.06.2022, ndërsa është protokolluar me **nr.6756/8**, datë 27.06.2022, datë në të cilën paraqitet dhe si e nënshkruar nga OE. Ky dokument është nënshkruar nga të gjithë ndjekësit e kontratës, ndryshe nga muaji i mëparshëm. Në këtë periudhë duket se është rregulluar në sistemin SMK data e protokollit të shkresës përcjellëse të raportit periodik të mirëmbajtjes. Ndjekësit e kontratës kanë miratuar faturën përkatëse të muajit duke e nënshkruar elektronikisht e mbivendosur nënshkrimin mbi informacione të printimit të faturës, si në muajin maj. Datat e nënshkrimit ndërmjet OE dhe ndjekësve të kontratës kanë një diferencë prej 10 ditësh kalendarike.

- Për muajin **korrik** 2022, janë nënshkruar elektronikisht nga ndjekësit e kontratës nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave këto dokumente: *Fatura përkatëse e muajit, Raporti mujor, Shkresa përcjellëse*. Të tre dokumentet e ngarkuar në sistem janë nënshkruar nga përfaqësuesi i OE dhe ndjekësit e kontratës.

Shkresa përcjellëse e raportit mujor protokolluar me nr.6756/9 mban datën 10.08.2022, datë në të cilën është nënshkruar dhe nga OE. Datat e nënshkrimit ndërmjet OE dhe përfaqësuesit të DPT ka një diferencë prej 14 ditësh kalendarike. Nënshkrimi elektronik i ndjekësve të kontratës paraqitet i mbivendosur në informacione të faturës, si në muajin maj.

- Për muajin **gusht** 2022, janë miratuar nga ndjekësit e kontratës nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave këto dokumente: *Fatura përkatëse e muajit, Raporti mujor, Shkresa përcjellëse dhe Procesverbal*.

Shkresa përcjellëse e raportit mujor protokolluar me nr.6756/10 mban datën 29.08.2022, datë në të cilën është nënshkruar dhe nga OE. Datat e nënshkrimit ndërmjet OE dhe përfaqësuesit të AKSHI-t ka një diferencë prej 30 ditësh kalendarike. Nënshkrimi elektronik i ndjekësve të kontratës paraqitet i mbivendosur në informacione të faturës, si në muajin maj 2022.

Në raportimin e kësaj periudhe është shtuar në sistemin e menaxhimit të kontratave një dokument i cili gjenerohet automatikisht nga sistemi i tipit "*Procesverbal*" në të cilin thuhet se grupi i marrjes në dorëzim merr shërbimin e mirëmbajtjes në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës. Komisioni i mbikëqyrjes dhe marrjes në dorëzim rezulton të ketë dy herë të njëjtin anëtar, çfarë tregon se ky dokument ka qenë ende i pa konsoliduar. Ky dokument ngjan më shumë me një Akt-Pranimi mbi shërbimin, nisur nga fakti se në procesverbal nuk është cilësuar asnjë mangësi nga grupi i ndjekjes. Në rastet kur një parregullsi apo mangësi do

të vërehet, anëtarët janë të detyruar të mbajnë një tjetër dokument të quajtur “Procesverbal”, ku do të cilësohet çfarë është vërejtur si mangësi gjatë zbatimit të kontratës për këtë periudhë. Nga auditimi u konstatua se, megjithëse në Procesverbal thuhet se “Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës dhe marrjes në dorëzim pasi ka kontrolluar dhe verifikuar shërbimet e mirëmbajtjes për periudhën 28/08/2022 - 27/09/2022, merr në dorëzim shërbimin në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës”, data e nënshkrimit të këtij dokumenti është saktësisht e njëjtë me kohën në të gjitha dokumentet e tjera që janë nënshkruar nga secili anëtar. Kjo tregon se gjenerimi i këtij dokumenti bëhet automatikisht nga sistemi kur anëtari i fundit aprovon dokumentacionin e dorëzuar nga OE, ndërsa nënshkruhet elektronikisht në grup me gjithë dokumentet e tjerë.

- Për muajin **shator** 2022, janë nënshkruar elektronikisht nga ndjekësit e kontratës nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave këto dokumente: *Fatura përkatëse e muajit, Raporti mujor, Shkresa përcjellëse dhe Procesverbal*.

Shkresa përcjellëse e raportit mujor protokolluar me nr.6756/11 mban datën 27.09.2022, datë në të cilën është nënshkruar dhe nga OE. Datat e nënshkrimit ndërmjet OE dhe përfaqësuesit të DPT ka një diferencë prej 14 ditësh kalendarike. Nënshkrimi elektronik i ndjekësve të kontratës paraqitet i mbivendosur në informacione të faturës, si në muajin e mëparshëm.

Komisioni i mbikëqyrjes dhe marrjes në dorëzim edhe për këtë periudhë rezulton të ketë dy herë të njëjtin anëtar, çfarë tregon se ky dokument ka qenë ende i pa konsoliduar.

- Për muajin **tetor** 2022, ka patur një kthim nga ndjekësit e kontratës me shënimin “*Kthyer për korrigjim raporti i mirëmbajtjes*”.

Shkresa përcjellëse e raportit mujor protokolluar me nr.6756/12 mban datën 27.10.2022, datë në të cilën është nënshkruar dhe nga OE. Datat e nënshkrimit ndërmjet OE dhe përfaqësuesit të DPT ka një diferencë prej 33 ditësh kalendarike.

Nga auditimi u konstatua se anëtarët nuk e kanë nënshkruar shkresën përcjellëse me protokoll nr.6756/12 datë 27.10.2022, por nënshkrimi është bërë mbi një shkresë që nuk mban numër protokoll dhe datë duke ndërprerë në këtë mënyrë gjurmimin e dokumentacionit. Nisur nga fakti që ora e nënshkrimit është e njëjtë për çdo anëtar, kjo tregon se ky dokument është paraqitur automatikisht nga sistemi për nënshkrim, pra anëtari nuk ka të drejtë të zgjedhë se cilin dokument do të nënshkruaj e cilin jo, që tregon për një mangësi në sistemit të menaxhimit të kontratave, ku dokumenti i protokolluar është kthyer për korrigjim.

Komisioni i mbikëqyrjes dhe marrjes në dorëzim në dokumentin e gjeneruar nga sistemi si “*Procesverbal*” edhe për këtë periudhë rezulton të ketë dy herë të njëjtin anëtar, çfarë tregon se ky dokument ka qenë ende i pa konsoliduar.

Nënshkrimi elektronik i ndjekësve të kontratës paraqitet i mbivendosur në informacione të faturës, si në muajin si në muajin e mëparshëm.

- Për muajin **netor** 2022, janë nënshkruar elektronikisht nga ndjekësit e kontratës nëpërmjet sistemit të menaxhimit të kontratave këto dokumente: *Fatura përkatëse e muajit, Raporti mujor, Shkresa përcjellëse*.

Shkresa përcjellëse e raportit mujor protokolluar me nr.6756/13 mban datën 30.11.2022, datë në të cilën është nënshkruar dhe nga OE. Datat e nënshkrimit ndërmjet OE dhe përfaqësuesit të DPT ka një diferencë prej 14 ditësh kalendarike. Nënshkrimi elektronik i ndjekësve të kontratës paraqitet i mbivendosur në informacione të faturës, si në muajin e mëparshëm.

Komisioni i mbikëqyrjes dhe marrjes në dorëzim në dokumentin e gjeneruar nga sistemi si “*Procesverbal*” edhe për këtë periudhë rezulton të ketë dy herë të njëjtin anëtar, çfarë tregon se ky dokument ka qenë ende i pa konsoliduar.

Në raportet e mirëmbajtjes mbajtur për periudhën 2021-2022, çështjet e raportuara në lidhje me sistemin e fiskalizimit janë 368 problematika, nga të cilat 217 janë hapur në vitin 2021, ndërsa 151 në vitin 2022. Nisur nga analizimi i problematikave të raportuara vihet re se numri i tyre ka ardhur në rënie nga viti i pare në vitin e dytë të mirëmbajtjes.

Sipas raportit mujor, gjatë mirëmbajtjes së ofruar për periudhën 27.01.2022 – 27.02.2022, janë ndjekur në sistemin e suportit që ka ofruar BOE afërsisht 46 çështje, raportuar nga ndjekësi i kontratës, përfaqësues i DPT. Këto problematika të evidentuara dhe raportuara nga subjektet private, janë paraqitur në DPT nëpërmjet rrugëve të komunikimit që janë në dispozicion e më pas janë hapur si çështje në mjetin që është në dispozicion për raportimin dhe ndjekjen e problematikave gjatë veprimeve.

OE P si anëtar i BOE, ka ofruar një sistem gjurmimi të çështjeve të hapura për problematika të ndryshme të sistemit të fiskalizimit të cilat janë ndjekur nga përfaqësuesi i tatimeve si anëtar i ndjekjes së kontratës.

Nga të dhënat e marra për çështjet që janë hapur në këtë sistem u konstatua se janë afërsisht 600 raportime. Nga auditimi mbi këto problematika të raportuara u konstatua se:

- Disa prej çështjeve janë fshirë dhe nuk ka mbetur gjurmë mbi raportimin dhe statusin e tyre;
- Në një rast e njëjta problematikë është raportuar dy herë (380 dhe 374) sepse nga ana e OE që ofron suportin, çështja ka kaluar në statusin “Resolved” pa dhënë në mënyrë shteruese një përgjigje mbi zgjidhjen, çfarë ka sjellë si të nevojshme krijimin e çështjes nga e para me të njëjtin problem;
- Në këtë sistem statusi i çështjeve vendoset nga OE dhe jo nga marrësit e shërbimit, që në fakt duhet të ishte e kundërta. Nga ndjekësit e kontratës nuk është kërkuar që statusi i çështjeve të jetë nën vlerësimin e tyre duke marrë një rol aktiv në ndjekjen e kontratës si nga ana e AKSHI-t ashtu dhe e DPT-s.

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 6756, datë 27.11.2018 me objekt “Përmirësim i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, nëpërmjet sistemit SMK për ndjekjen e kontratës u konstatua se:

- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës nuk janë bërë duke u bazuar në afate të arsyeshme në kushtet kur në kontratë nuk është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit;
- Shënimet e vendosura nga ndjekësit e kontratës në rastet kur është kthyer për korrigjim, nuk japin arsye të plota shteruese për mangësitë apo parregullsitë që janë konstatuar, që do të thotë se komunikimi për korrigjimet e nevojshme që duhet të pasqyrohen nga OE është zhvilluar jashtë sistemit duke mos lenë gjurmë mbi arsyet e kthimit;
- Ndjekësit e kontratës kanë nënshkruar apriori dokumentet që paraqiten nga sistemi për nënshkrim, megjithëse në rastet e kthyera për korrigjim sistemi ju paraqet një dokument pa numër protokollit të pagjurmueshëm që nuk ka elementët e një dokumenti zyrtar.

Nga auditimi u konstatua se nuk është nënshkruar shkresa përcjellëse me protokoll, por nënshkrimi është bërë mbi një shkresë që nuk mban numër protokollit dhe datë duke ndërprerë në këtë mënyrë gjurmimin e dokumentacionit. Nisur nga fakti që ora e nënshkrimit është e njëjtë për çdo anëtar, kjo tregon se ky dokument është paraqitur automatikisht nga sistemi për nënshkrim, pra anëtari nuk ka të drejtë të zgjedhë se cilin dokument do të nënshkruaj e cilin jo, që tregon për një mangësi e sistemit të menaxhimit të kontratave protokollimi i një dokumenti i cili është kthyer për korrigjim.

- Në dokumentin e quajtur “*Procesverbal*” thuhet se “Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës dhe marrjes në dorëzim pasi ka kontrolluar dhe verifikuar shërbimet e mirëmbajtjes për periudhën A - B, merr në dorëzim shërbimin në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës”, data e nënshkrimit të këtij dokumenti është e njëjtë me kohën në të gjitha dokumentet e tjera që janë nënshkruar nga secili anëtar. Kjo tregon se gjenerimi i këtij dokumenti bëhet automatikisht nga sistemi kur anëtari i fundit aprovon dokumentacionin e dorëzuar nga OE, ndërsa nënshkruhet elektronikisht në grup me gjithë dokumentet e tjerë.

- Në sistemin e raportimit të problematikave mbi Fiskalizimin, statusi i çështjeve vendoset nga OE dhe jo nga marrësit e shërbimit, që në fakt duhet të ishte e kundërta. Nga ndjekësit e kontratës nuk është kërkuar që statusi i çështjeve të jetë nën vlerësimin e tyre duke marrë një rol aktiv në ndjekjen e kontratës dhe raportimit periodik si nga DPT-s ashtu dhe nga AKSHI;

- Ndjekësit e kontratës nuk kanë llogaritur asnjë penalitet mbi BOE që ka ofruar mirëmbajtjen megjithëse 9 çështje të hapura për sistemin e fiskalizimit kanë mbetur në statuset: “Waiting for support”, “Pending” dhe “Work in progress”. Nga këto, 5 çështje janë krijuar në vitin 2021, ndërsa 4 prej tyre janë krijuar në vitin 2022.

- Mirëmbajtja e Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit - për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Kontrata nr. 51 prot., datë 28.02.2023, ka si objekt “*Mirëmbajtja e Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit - për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve*” dhe vlerë 705,428,160 lekë pa TVSH, me afat zbatimi 24 muaj dhe ndjekës kontrate punonjësit EF, GjN, DM si përfaqësues të AKSHI-t dhe BSh si përfaqësues i DPT-s.

Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës me nr.51, datë 28.02.2023 me objekt “*Mirëmbajtja e Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit - për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve*, janë hartuar 3 urdhra për ndjekësit e kontratës me nr.51/1 me datë 28.02.2023, nr.51/2 me datë 06.03.2023, nr.51/5 me datë 18.04.2023. Në dy urdhrat e fundit DPT ka ndryshuar përfaqësuesit e saj, ku deri në datën 17.04.2023 ka qenë FM, ndërsa pas kësaj date BSh. Raportimi i parë i mirëmbajtjes, ngarkuar në sistemin SMK nga BOE ka qenë për periudhën 01.03.2023-31.03.2023, të cilat janë ngarkuar në datë 03.04.2023, pra brenda afatit.

Nga auditimi u konstatua se:

- Vlera e kontratës me nr. 51 prot., datë 28.02.2023 me objekt “*Mirëmbajtja e Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit - për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve*” është 258,411,744 lekë pa TVSH ose 57% më shumë se vlera e mirëmbajtjes së prokuruar me kontratën nr.6756, datë 27.11.2018 e cila ka pas si objekt “*Përmirësim i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit*”, por dhe mirëmbajtjen e tij për një periudhë 24 mujore.

- Plani për zbatimin e kontratës që ndodhet në sistemin SMK nuk mban datë hartimi dhe as numër protokollit, ndërsa është nënshkruar nga anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim në datat 06.03.2023, 07.03.2023 dhe 09.03.2023 ose 2 ditë më vonë se sa është parashikuar në nenin 124, pika 3 e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 107 në VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Plani i zbatimit të kontratës nuk është nënshkruar nga OE, në kundërshtim me nenin 124, pika 3 e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 107 në VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Dokumentet e ngarkuar nga OE sipas kushteve të veçanta të kontratës duhet të jenë fatura tatimore dhe raporti mujor për shërbimin e ofruar nga BOE.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem u konstatua se Raporti mujor i mirëmbajtjes nuk është nënshkruar nga ndjekësit e kontratës, ndërsa është nënshkruar shkresa përcjellëse që mban datën 12.04.2023, nënshkruar në datën 28.04.2023 nga FM si përfaqësues i DPT-s për këtë periudhë raportimi. Me urdhrin nr.51/5, datë 18.04.2023 përfaqësues i DPT është zëvendësuar me BSh.

Nga ndjekësi i kontratës, përfaqësues i DPT-s për këtë periudhë nuk është nënshkruar faturimi i kësaj periudhe.

1. Titulli i Gjetjes: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.30, datë 20.10.2022 me objekt “Rritja e Kapaciteteve Hardware për Sistemin e Fiskalizimit-për DPT”, u konstatua se:

- Raporti fillestar nuk është paraqitur brenda afatit 5 ditor sipas përcaktimeve në kontratë.
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës vetëm në një rast janë bërë përtej afatit 1 mujor, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit;

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.46, datë 06.01.2021 me objekt “Mirëmbajtja e Infrastrukturës hostuese e sistemit e- Taxation për DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, u konstatua se:

- Janë nënshkruar vetëm raportet periodike të periudhave përkatëse, por mungojnë Aktet e Pranimit për shërbimet e ofruara;
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës, janë bërë përtej afateve të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit, prej tre ditësh;
- Pagesat e kryera përkatësisht në Prill, Qershor, Nëntor dhe Dhjetor dhe jo sipas muajve, për shërbimet e ofruara.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.7047, datë 28.12.2020 me objekt “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistemi telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DRT/DPT (Faza 2)- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, u konstatua se:

- Janë nënshkruar vetëm raportet periodike të periudhave përkatëse të mirëmbajtjes, por mungojnë Aktet e Pranimit për shërbimet e ofruara;
- Aktet e pranimit nuk janë bërë sipas praktikave të ngjashme;
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës, janë bërë përtej afateve të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit prej tre ditësh;
- Pagesat e kryera përkatësisht në Prill, Qershor dhe Dhjetor, gjithnjë pas nënshkrimit të dokumenteve, por në afate kohore përtej afatit 30 ditor të përcaktuar për kryerjen e pagesave.

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr.6756, datë 27.11.2018 me objekt “Përmirësim i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, u konstatua se:

- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës nuk janë bërë duke u bazuar në afate të arsyeshme në kushtet kur në kontratë nuk është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit;

- Shënimet e vendosura nga ndjekësit e kontratës në rastet kur është kthyer për korrigjim, nuk japin arsye të plota shërbuese për mangësitë apo parregullsitë që janë konstatuar, që do të thotë se komunikimi për korrigjimet e nevojshme që duhet të pasqyrohen nga OE është zhvilluar jashtë sistemit duke mos lenë gjurmë mbi arsyet e kthimit;

- Ndjekësit e kontratës kanë nënshkruar apriori dokumentet që paraqiten nga sistemi për nënshkrim, megjithëse në rastet e kthyera për korrigjim sistemi ju paraqet një dokument pa numër protokoll, të pagjurmueshëm që nuk ka elementët e një dokumenti zyrtar.

Nga auditimi u konstatua se nuk është nënshkruar shkresa përcjellëse me protokoll, por nënshkrimi është bërë mbi një shkresë që nuk mban numër protokoll dhe datë duke ndërprerë në këtë mënyrë gjurmimin e dokumentacionit. Nisur nga fakti që ora e nënshkrimit është e njëjtë për çdo anëtar, kjo tregon se ky dokument është paraqitur automatikisht nga sistemi për nënshkrim, pra anëtari nuk ka të drejtë të zgjedhë se cilin dokument do të nënshkruaj e cilin jo, që tregon për një mangësi e sistemit të menaxhimit të kontratave protokollimi i një dokumenti i cili është kthyer për korrigjim.

- Në dokumentin e quajtur “*Procesverbal*” thuhet se “Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës dhe marrjes në dorëzim pasi ka kontrolluar dhe verifikuar shërbimet e mirëmbajtjes për periudhën A - B, merr në dorëzim shërbimin në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës”, data e nënshkrimit të këtij dokumenti është e njëjtë me kohën në të gjitha

dokumentet e tjera që janë nënshkruar nga secili anëtar. Kjo tregon se gjenerimi i këtij dokumenti bëhet automatikisht nga sistemi kur anëtari i fundit aprovon dokumentacionin e dorëzuar nga OE, ndërsa nënshkruhet elektronikisht në grup me gjithë dokumentet e tjerë.

- Në sistemin e raportimit të problematikave mbi Fiskalizimin, statusi i çështjeve vendoset nga OE dhe jo nga marrësit e shërbimit, që në fakt duhet të ishte e kundërta. Nga ndjekësit e kontratës nuk është kërkuar që statusi i çështjeve të jetë nën vlerësimin e tyre duke marrë një rol aktiv në ndjekjen e kontratës dhe raportimit periodik si nga DPT-s ashtu dhe nga AKSHI;
- Ndjekësit e kontratës nuk kanë llogaritur asnjë penalitet mbi BOE që ka ofruar mirëmbajtjen megjithëse 9 çështje të hapura për sistemin e fiskalizimit kanë mbetur në statuset: “Waiting for support”, “Pending” dhe “Work in progress”. Nga këto, 5 çështje janë krijuar në vitin 2021, ndërsa 4 prej tyre janë krijuar në vitin 2022.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave renditur më sipër u konstatuan problematika të njëjta, si më poshtë:

- Dokumenti i ngarkuar në sistem si “Plani i zbatimit të kontratës” nuk përmban një numër protokoll dhe datë protokoll;
- Plani i zbatimit të kontratës është nënshkruar me vonesë dhe nuk është nënshkruar nga OE.

Kriteri:

- Neni nr. 59, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;
- Neni 77, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”;
- Neni 124, pika 3 e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- Neni 107 në VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Pikën 54 të Udhëzimit nr.30 të datës 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Kushteve të veçanta të secilës kontratë;
- Rregulloren nr. 7157 datë 20.10.2021.

Ndikimi/Efekt: Ndjekja e kontratave nëpërmjet sistemit ka vijuar në mënyrë formale për aq sa ka qenë e mundur të kryhet nëpërmjet sistemit, duke krijuar hapësira për shmangie apo tejkallim të afateve në detyrimet që përcaktojnë aktet rregullativë, si dhe kushtet e veçanta të secilës prej kontratave.

Shkaku: Vënia në funksion e sistemit të ndjekjes së kontratave, mungesa e informimit të nevojshëm tek punonjësit që veprojnë si ndjekës të kontratës dhe punonjës finance si dhe problematikat e vetë sistemit SMK.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si institucion përfitues i shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit që ofron struktura e AKSHI-t apo Operatorët e kontraktuar prej tij, të angazhojë më shumë se një punonjës në ndjekjen e kontratave me qëllim që ndjekja e kontratave të sigurohet në përmbushjen e saj dhe të mos mbetet në kushtet e një procesi formal të realizimit të saj. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nga ana e saj të informojë dhe trajtojë ndjekësit e kontratave për detyrimet ligjore që nevojitet të plotësohen, nisur nga fakti që puna nëpërmjet një sistemi informatik nuk të përjashton nga respektimi me rigozitetin i akteve ligjore që rregullojnë ndjekjen e kontratave.

*Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit janë mbajtur:
Aktkonstatimi nr.4, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/8, datë 13.07.2023;
Aktkonstatimi nr.5, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/6, datë 13.07.2023;
Aktkonstatimi nr.6, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/5, datë 13.07.2023;
Aktkonstatimi nr.7, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/4, datë 13.07.2023;
Aktkonstatimi nr.8, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/3, datë 13.07.2023;*

Aktkonstatimi nr.9, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/2, datë 13.07.2023; Trajtuar në faqet 20-55 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione nga DPT me shkresën nr.359/5, datë 06.09.2023.

Pretendimi i subjektit: Drejtoria e Financës dhe buxhetit i është drejtuar Drejtorisë TIK në DPT me shkresën nr.12625, datë 25.07.2023 mbi kërkuesën për informacion për përcjelljen e rregullores/ manualit për SMK, pasi nuk ka qenë e përcjellë më parë që nga hapja e aksesit. Me anë të shkresë nr. 12625, datë 27.07.2023 na është vënë në dispozicion vetëm manuali i përdorimit por jo manuali i funksionimit, përgjegjësi, afateve etj.

Po ashtu, DPT shpreh gadishmërinë për trajtimin dhe përmbushjen e rekomandimit për informimin dhe trajnimin e ndjekësve të kontratës në lidhje me detyrimet ligjore që duhet të plotësojnë si dhe angazhimin kur është e mundur të më shumë se një punonjësi si ndjekës kontrate.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nisur nga angazhimi i subjektit për përmbushje e rekomandimeve të lëna në drejtim të zbatimit të kontratave, grupi i auditimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

III.2.3 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input / Output.

DPT bën pjesë në infrastrukturën kritike të miratuar me VKM nr.761, datë 12.12.2022 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave*” me sistemin e Fiskalizimit dhe atë pajisjeve fiskale Nexus si dhe me infrastrukturë të rëndësishme sistemin e-Taxation.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjendet në shtojcën nr.1 **në listën e infrastrukturave kritike të informacionit si Operator Administrues**, me sistemin e fiskalizimit dhe atë të pajisjeve fiskale Nexus. Ndërsa, në shtojcën nr.2, në listën e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit me sistemin që njihet me disa emra si: e-Taxation me modulet C@ts dhe e-Filing. Nga përditësimet e infrastrukturave prej VKM nr. 553, datë 15.7.2020 në atë me nr. 761, datë 12.12.2022, sistemi i e-Taxation është transferuar nga një infrastrukturë kritike në një infrastrukturë të rëndësishme, megjithëse rëndësia e tij është jetike jo vetëm për funksionimin e DPT, por për gjithë sistemet informatike me të cilat japin dhe marrin të dhëna në sistemin e-Taxation.

Ndërprerja e sistemit e-Taxation ka ndikim financiar të drejtpërdrejtë jo vetëm tek tatimpaguesi, por dhe tek administrata pasi në këtë sistem ruhen të dhënat e tatimpaguesit.

Ndërprerja e sistemit të pajisjeve fiskale Nexus nuk paraqet ndikim financiar të drejtpërdrejtë për arsye se është përdorur deri me datë 30 qershor 2022, pas shumë shtyrjeve për shkak të pandemisë dhe vënies në punë plotësisht të sistemit të ri të Fiskalizimit. Ky sistem aktualisht përdoret vetëm nga punonjësit e AKSHI-t, që nxjerrin të dhëna të nevojshme sipas kërkesave të ndryshme që paraqiten mbi historikun e veprimeve që gjenden në këtë sistem.

1.Titulli i Gjetjes. Me përditësimet e infrastrukturave nga VKM nr. 553, datë 15.7.2020 në atë me nr. 761, datë 12.12.2022, sistemi i e-Taxation është transferuar nga një infrastrukturë kritike në një infrastrukturë të rëndësishme, megjithëse rëndësia e tij është jetike jo vetëm për funksionimin e DPT, por për të gjithë sistemet informatike me të cilat japin dhe marrin të dhëna në sistemin e-Taxation.

Situata: Nga auditimi u konstatua se sistemi e-Taxation është transferuar nga një infrastrukturë kritike në një infrastrukturë të rëndësishme me përditësimet e infrastrukturave miratuar me VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave*”, megjithëse rëndësia e tij është jetike jo vetëm për

funksionimin e DPT, por për të gjithë sistemet informatike me të cilat japin dhe marrin të dhëna në sistemin e-Taxation. Të dhënat e sistemit e-Taxation i nevojiten dhe sistemit të Fiskalizimit, ku të dhënat e tatimpaguesve kalojnë në sistemin e Fiskalizimit në fund të çdo dite që do të thotë se në mungesë të të dhënave nga e-Tax funksionimi i rregullt i Fiskalizimit është i cenuar në lidhje me: subjektet e reja, ndryshimet e të dhënave për statusin e aktivitetit, niveli i taksimit, ndryshimet tek punonjësit si dhe kalimi automatik i librave të shitjes dhe të blerjes.

Sistemi i pajisjeve fiskale Nexus i kategorizuar si sistem kritik nuk është më në përdorim.

DPT-s si Operator Administrues nuk i është kërkuar mendim dhe nuk është vënë në dijeni për klasifikimin që është bërë nga AKSHI lidhur me kritikalitetin e sistemeve informatike që disponon.

Kriteri: Konstatimi bazohet në klasifikimet e infrastrukturave që janë miratuar me:

- VKM nr. 553, datë 15.7.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”;
- VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave”.

Ndikimi/Efekti: Sipas rëndësisë së klasifikimit, nevojiten të plotësohen kërkesat specifike me qëllim sigurimin e informacionit dhe sigurinë kibernetike.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet AKSHI-t dhe DPT-s për evidentimin e saktë të rëndësisë së sistemeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit të marrin masa për të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimet për ndryshimet ligjore në Shtojcën 1 të VKM nr.761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, ku sistemi e-Taxation nga një sistem i rëndësishëm në Shtojcën 2 të kategorizohet si një sistem kritik në Shtojcën 1, ndërsa sistemi Nexus nga sistem kritik i përcaktuar në Shtojcën 1 të hiqet nisur nga fakti që ky sistem nuk është aktualisht në përdorim nga DPT.

A. Sistemi e-taxation

Sistemi e-Taxation është sistemi bazë i Administratës Tatimore, i cili shërben për administrimin e të gjithë tatimeve dhe përmbledh gjithë funksionet që lidhen me deklarinimin dhe pagesën e tatimeve.

Ky sistem përbëhet nga 2 (dy) pjesë që komunikojnë midis tyre:

- i. Sistemi i deklarimit elektronik (e-filing), që është ndërfaqja publike e komunikimit me tatimpaguesin dhe shërben për:
 - Deklarimin dhe ndryshimin e deklaratave tatimore;
 - Deklarimin e listë pagesave, shtimin dhe largimin e punonjësve;
 - Deklarimin për Librat e Shitjes dhe Blerjes;
 - Të dhënat e kontabilitetit të tatimpaguesve, urdhrat e pagesave dhe llogaritjen e detyrimeve në kohë reale;
 - Ngarkimin e Bilanceve vjetore;
 - Menaxhimin e përdoruesve (përfaqësuesit);
 - Menaxhimin e çështjeve (kërkesat nga tatimpaguesit).
- ii. Sistemi bazë C@ts që është sistemi core dhe i shërben Administratës tatimore për administrimin e tatimeve sipas funksioneve për:
 - Regjistrimin;
 - Menaxhimin e deklaratave;
 - Marrjen e pagesave të detyrimeve tatimore;
 - Kontabilizimin e detyrimeve dhe pagesave;
 - Komunikimet e administratës tatimore me tatimpaguesin;
 - Sistemin e raportimit;

- Komunikimet e administratës tatimore me palët e treta;
- Menaxhimin e rasteve;
- Menaxhimin e Riskut;
- Menaxhimin e Kontrollit;
- Menaxhimin e Mbledhjes së Detyrimeve me Forcë.

Ndërtimi për këtë sistem informatik ka filluar në vitin 2013 në përputhje me kontratën e nënshkruar me palën zhvilluese dhe është vënë në përdorim prej datës 3 Janar 2015.

Ky sistem është mirëmbajtur vazhdimisht nëpërmjet kontratave të shërbimit dhe mirëmbajtjes dhe është përshtatur gjatë gjithë kohës, për të qenë në përputhje me ndryshimet ligjore dhe procedurale që kanë ndodhur si dhe është përmirësuar vazhdimisht sipas kërkesave të Administratës Tatimore.

Mirëmbajtja e sistemit e-Taxation, është kontraktuar nga AKSHI, me kontratën nr.3339 prot, datë 12.05.2021 dhe kohëzgjatje 24 muaj, e cila ka përfunduar në datën 12.05.2023.

Mirëmbajtja e infrastrukturës hostuese të sistemit e-Taxation, është siguruar nëpërmjet kontratës së nënshkruar nga AKSHI, me nr. 46 prot., datë 06.01.2021 dhe kohëzgjatje 24 muaj nga data e nënshkrimit, e cila ka përfunduar në datën 06.01.2023.

Në kushtet kur ka përfunduar kontrata e mirëmbajtjes së sistemit e-Taxation, me shkresën nr.11 prot., datë 04.01.2023, AKSHI duke vënë në dijeni dhe DPT, i është drejtuar OE që ka ofruar mirëmbajtjen, se kërkon mirëkuptimin dhe bashkëpunimin për vijimin e mirëmbajtjes së sistemit pa pagesë deri në shpalljen e fituesit të procedurës së prokurimit të këtij shërbimi.

Në përgjigje të kërkesës së AKSHI-t, OE ka shprehur gatishmërinë për mbulimin me suport për incidente që mund të ndodhin, por i ka bërë me dije institucionet se sistemi paraqet problematika të cilat në rast incidentesh nuk do të jetë e mundur të zgjidhen, për arsye se:

- Pjesa më e madhe e pajisjeve server, storage dhe të rrjetit, në site primar dhe sekondar janë jashtë suportit të prodhuesit;
- Storage i sistemit C@ts është në limite të hapësirës dhe kjo situatë sjell impakt direkt në funksionimin e sistemit;
- Pajisjet firewall janë të vjetra, pa suport nga prodhuesi dhe pa veçoritë e nevojshme për standardet e sigurisë së rrjetit;
- Problematika në sistemin backup për mungesë kapaciteti.

AKSHI me shkresën nr.879, datë 14.02.2023, drejtuar DPT-s ka njoftuar se ka përfunduar testimi i tregut për procedurën me objekt “*Hapësira hardware për kapacitetin e serverave (Përmirësim i sistemit e-Taxation)*”, ku përlllogaritja e këtij fondi është në vlerën 403,480,724 lekë pa TVSH dhe përfshihen:

- Vlera e implementimit: 294,233,924 lekë;
- Vlera e mirëmbajtjes: 109,246,800 lekë.

Me anë të kësaj shkrese AKSHI kërkon nga DPT konfirmimin e fondeve në dispozicion për zhvillimin e procedurës.

Në përgjigje të këtij komunikimi, DPT me shkresën nr.2478/1 prot, datë 24.02.2023 ka sqaruar në mënyrë të detajuar se fondet në dispozicion janë ato të planifikuara për përmirësimin e pajisjeve fizike ku hostohet ky sistem, ndërsa fondet e tjera nuk janë miratuar nga MFE në buxhetin e DPT-s pasi nuk janë informuar mbi detajimin dhe domosdoshmërinë e këtij investimi.

Vlen të thuhet se në zhvillimet e teknologjisë së informacionit në DPT, me shkresën nr.1380/12 prot, datë 07.12.2022, AKSHI ka konfirmuar marrjen në dorëzim të aseteve mbi sistemet informatike të transferuara nga DPT ku bën pjesë dhe E-taxation, që do të thotë se mirëmbajtja e sistemit duhet të ishte planifikuar nga AKSHI për vitin 2023.

Ndërsa, DPT disponon fonde në vlerën 120,000,000 lekë, të planifikuara në vitin 2022, për rritjen e kapacitetit hardware ku ndodhet sistemi e-Tax, të cilat nuk janë realizuar.

DPT me shkresën nr.3140/1, datë 06.03.2023 ka vënë në dijeni AKSHI-n se administrata tatimore rrezikon të kalojë në kolaps megjithëse shtimi i kapacitetit Hardware është buxhetuar nga DPT në vitin 2022 por nuk është realizuar, sepse zgjidhja e propozuar nga AKSHI është përfshirja në një procedurë për mirëmbajtje sistemi, rritje të kapacitetit hardware, si dhe zhvillimin e sistemit.

Për sa më sipër, hapat e ndërmarrë ndërmjet DPT-s dhe AKSHI-t për rinovimin e pajisjeve fizike ku qendron sistemi e-Taxation janë në nivel diskutimi dhe akoma nuk është arritur në një vendimmarrje, megjithëse risku i ndërprerjes së shërbimit është shumë i lartë. Ndërkaq, jemi njoftuar se është vijuar me hapjen e procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen e këtij sistemi.

2.Titulli i Gjetjes. Sistemi e-Taxation ndodhet në situatë kritike të funksionimit dhe mbarëvajtjes së tij.

Situata: Nga auditimi u konstatua se pajisjet fizike të sistemit e-Taxation janë në një situatë tejet kritike. Ky sistem është shumë i rëndësishëm për DPT-n, nisur nga veprimet operationale që kryhen aty si nga ana e biznesit, administratës tatimore ashtu dhe nga institucionet e tjera me të cilat janë ndërtuar ndërveprime me të dhëna të këtij sistemi. Ky konstatim bazohet në të dhënat mbi hapësirën e lirë në servera dhe në storage e cila paraqitet rreth masës 90 %, pra pothuajse në ezaurim. Megjithëse gjatë auditimit në terren u hap procedura për mirëmbajtjen e sistemit e-Taxation, ne vlerësojmë se ndërprerja nuk do të mund të sigurohet, për arsye se sistemet informatike nuk mund të jenë funksional nëse pajisjet janë në ezaurim të hapësirës së tyre dhe funksionojnë në limitet e ciklit jetësor dhe me sisteme operimi jashtë suportit teknik që do të thotë i pasigurt. Risku për ndërprerjen dhe pamundësia për ta venë në funksion në një kohë të shkurtër sistemin e-Taxation është shumë e lartë.

Hapësira fizike e zënë për serverat dhe pajisjet storage me përfundimin e auditimit në terren ishte në masën 90%, pothuajse në ezaurim.

Hapat e ndërmarrë ndërmjet DPT-s dhe AKSHI-t për rinovimin e pajisjeve fizike ku qendron sistemi e-Taxation janë në nivel diskutimi dhe akoma nuk është arritur në një vendimmarrje. DPT ka planifikuar një fond për të cilin AKSHI shprehet se nuk është i mjaftueshëm, por në kushtet kur DPT nuk i disponon më asetet rrjedhimisht planifikimi i fondeve për rinovim duhet të plotësohet nga administratori dhe poseduesi i këtyre aseteve që është AKSHI.

Kriteri: Mbarëvajtja e sistemeve dhe funksionimi i tyre.

Ndikimi/Efekt: Mundësia për ndërprerjen dhe pamundësia për ta venë në funksion në një kohë të shkurtër sistemin e-Taxation është shumë e lartë.

Shkaku: Hapësira fizike e zënë për serverat dhe pajisjet storage me përfundimin e auditimit në terren ishte në masën 90%, pothuajse në ezaurim.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin masa për të siguruar pajisjet fizike që nevojiten të rinovohen ku qëndron i hostuar sistemi informatik e-Taxation, i cili ndodhet në kushtet teknike në ezaurim dhe me risk të lartë të ndërprerjes së funksionimit, çfarë do të pengonte aktivitetin e DPT-s dhe të institucioneve të tjera të cilat marrin të dhëna nga ky sistem.

B. Sistemi i Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit - Sistemi i Fiskalizimit

Sistemi i Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit, i cili njihet si Sistemi i Fiskalizimit, kontrollon në kohë reale transaksionet me pagesë cash dhe jo cash.

Sistemi përbëhet nga njësitë e mëposhtme:

a. *Shërbimi ligjor për:*

- Regjistri i tatimpaguesve me degët e tatimpaguesve dhe API;
- Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS);

b. Modulet e Software:

- Sistemi i evidentimit dhe ndjekjes së transaksioneve me para në dorë;
- Kontrolli tatimor i tatimpaguesve në sistemin e pagesave me para në dorë;
- Sistemi për menaxhimin e riskut për pagesa me para në dorë;
- Krijimi, regjistrimi dhe ndjekja e transaksioneve jo cash;
- Data datawarehouse – magazina e të dhënave.
- Pasuria e tatimpaguesve;
- Regjistri i tatimpaguesve me degët e tatimpaguesve dhe API;

Komponentët e sistemit janë:

1. Moduli i Fiskalizimit;
2. Moduli i Portalit Qendror për Kontrollin dhe Menaxhimin - CPCM, i cili përbëhet nga:
 - Nën Moduli i Taksapagueseve (RTP);
 - Nën Moduli i Pasurive;
 - Nën Moduli i Software të licencuar;
 - Nën Moduli HRM;
 - Nën Moduli AUDIT;
 - Nën Moduli i RISK.
3. Portali i vetëshërbimit për tatimpaguesit - Self Care Portal.
4. Moduli i Inteligjencës së Biznesit - BI.

Ndërtimi i sistemit ka filluar në vitin 2018 në përputhje me kontratën e nënshkruar me palën zhvilluese dhe ka filluar të funksionojë dhe përdoret për faturat prej datës 1 Janar 2021.

Mirëmbajtja e sistemit është siguruar nëpërmjet kontratave të shërbimit dhe mirëmbajtjes dhe është përshtatur gjatë gjithë kohës, në përputhje me ndryshimet ligjore dhe procedurale që kanë ndodhur si dhe është përmirësuar vazhdimisht sipas kërkesave të Administratës Tatimore.

Gjithashtu, në vitin 2022 është kryer edhe shtimi i kapaciteteve hardware të sistemit nënshkruar nga AKSHI, me nr.30 prot., datë 20.10.2022 dhe afat lëvrimi 9 muaj kalendarik, për të përballuar shtimin e ngarkesës.

3.Titulli i Gjetjes: Për sistemin e-Taxation dhe atë të Fiskalizimit nuk janë bërë regjistrimet si baza të dhënave shtetërore.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, të dhënat e sistemit e-Taxation dhe sistemit të Fiskalizimit, nuk janë regjistruar si baza të të dhënave shtetërore. Mbi këto sisteme janë ngritur ndërveprime, në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Të dhënat e këtij sistemi nuk janë të specifikuara për nga rëndësia, për nga lloji i tyre, si dhe detyrimi për ruajtjen e tyre. Ndërveprimet me këto të dhëna nuk janë konform akteve ligjore pasi për të ndërvepruar, nevojitet që shkëmbimi të ndërtohet mbi të dhëna shtetërore.

Shkaku: -

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me DPT-n të hartojnë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e-Taxation dhe sistemin e Fiskalizimit me të dhënat e të cilëve janë ndërtuar dhe ndërveprime me sisteme të tjera.

4. Titulli i Gjetjes: DPT megjithëse përgjegjëse për të dhënat që hidhen në sistemet informatike e-Taxation dhe Fiskalizimi, nuk disponon përdoruesin me të drejta të plota – Owner.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon përdoruesin me të drejta të plota – Owner, megjithëse është përgjegjëse për të dhënat që hidhen në sistemet informatike e-Taxation dhe Fiskalizimi. Përdoruesit me të drejta të plota – Owner të të dhënave i disponon:

- Për sistemin e-Taxation: Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, strukturë e AKSHI-t megjithëse kjo e drejtë nuk është e parashikuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, si dhe në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet institucioneve AKSHI dhe DPT me nr.160, datë 05.04.2019.

- Për sistemin e fiskalizimit: Operatori Ekonomik që ofron shërbimin e mirëmbajtjes. Mbarëvajtja e këtij sistemi është ofruar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “J” Shpk”, “N” dhe “D” Shpk” që kanë zhvilluar sistemin e Fiskalizimit për vitet 2021-2022 me kontratën nr.6756 datë 27.11.2018, ndërsa me kontratën nr. 51, datë 28.02.2023 shërbimi i mirëmbajtjes ofrohet nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “P” dhe “H”.

Në asnjë prej kontratave të mirëmbajtjes nuk cilësohet se përdoruesin me të drejta të plota në bazat e të dhënave nevojitet ta ketë Operatori Ekonomik që do të ofrojë shërbimin e mirëmbajtjes, duke patur në konsideratë që ky përdorues ka të drejta pa limit për të vepruar.

Kriteri: praktikat më të mira kërkojnë që përdoruesi Owner të përdoren vetëm në raste të veçanta dhe fjalëkalimi i tij për arsye sigurie mund të ndahet në dy punonjës të cilët nëse nuk do të jenë bashkë atëherë nuk është e mundur të aksesohet nga një përdorues.

Ndikimi/Efekti: Siguria e të dhënave është e cenuar kur super-userin e disponojnë punonjës, detyrat e të cilëve nuk lidhen me të drejtat të këtij niveli.

Shkaku: -

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si institucioni i vetëm administrues i bazës së të dhënave të sistemeve informatike që mbështesin funksionalitetet dhe aktivitetin e saj, të marrë masat për menaxhimin e bazës së të dhënave, që përmban të gjitha llojet e aksesit në sistemin e bazës së të dhënave, përfshirë përditësimin e ndryshimin e informacionit të ruajtur; pasi siguria e të dhënave nuk mund të garantohet në mirëbesim.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr.3, datë 13.07.2023, protokolluar në DPT me nr. 6589/7, datë 13.07.2023, si dhe trajtuar në faqet 55-61 të Projektraportit të Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione nga AKSHI me shkresën nr.359/4, datë 04.09.2023 dhe nga DPT me shkresën nr.359/5, datë 06.09.2023.

Pretendimi i AKSHI-t: AKSHI angazhohet për përmirësimin ligjor të rekomanduar me nr.1, ndërsa është në pritje të të një analize nga Drejtoria TIK e atashuar në DPT për rivlerësimin e indikatorëve dhe kryerjen e analizave përkatëse dhe konkluzioneve për sistemin e-Taksation.

AKSHI sqaron se DPT është në proces të regjistrimit të bazave të të dhënave, ku sistemi NEXUS është zëvendësuar me sistemin e Fiskalizimit për të cilin duhet të reflektohen ndryshimet.

AKSHI shpreh gadishmërinë për të organizuar takime pune të përbashkëta për të analizuar dhe diskutuar mbi gjetjet e konstatuara dhe zgjidhje e tyre.

AKSHI sqaron se është në dijeni të situatës mbi pajisjet fizike të sistemit e-Taxation për të cilin ka përlllogaritur dhe një fond limit në vlerën 403,480,724 lekë pa TVSh. AKSHI i ka përcjellë me shkresën nr.879, datë 14.02.2023 kërkesën për fonde DPT-s. AKSHI i ka sqaruar DPT-s dhe teknikisht nevojën për rinovimin e kësaj infrastrukture.

Qëndrimi i grupit të auditimit për sqarimet e dërguara nga AKSHI: Sqarojmë se asetet ku ndodhet infrastruktura e-Taxation është kaluar tek AKSHI dhe DPT nuk ka ku bazohet për kërkimin e fondeve të një infrastrukturë të transferuar në fund të vitit 2022. Gjithashtu, disponojmë të gjithë komunikimin shkresor ndërmjet dy institucioneve AKSHI-t dhe DPT-s për situatën kritike ku ndodhet sistemi e-Taxation dhe për mungesën e dakortësisë ndërmjet institucioneve se përgjegjësi e kujt është funksionaliteti i sistemit e-Taxation e rrjedhimisht dhe investimet për funksionalitetin e tij. Parashikimin për këtë rinovim duhet ta bëjë AKSHI, ndërsa fondet e planifikuara nga DPT për vitin 2022 të cilat nuk janë shpenzuar megjithëse rëndësia e kësaj infrastrukture nuk ka asnjë kundërshtim se është e lartë.

Në gjykimin tonë si auditues, vlerësojmë se përmirësimi i sistemit e-taxation për sa kohë nuk ka ardhur si kërkesë e DPT-s, nuk ka arsye të pengojë procesin e rinovimit të pajisjeve që mundet të mos funksionojnë nga momenti në moment. Sqarojmë se rëndësia e sistemit e-Taxation është e padiskutueshme, sic shprehet dhe DPT në sqarimet që ka dhënë se sistemet kritike janë sistemi e-Taxation dhe i Fiskalizimit.

Për sa më sipër, qëndrimi i grupit të auditimit do të jetë i njëjtë në përmirësimet ligjore dhe ato organizative që rekomandohen në këtë Raport përfundimtar Auditimi.

Pretendimi i DPT-s: DPT shpreh gadishmërinë për bashkëpunim në lidhje me përmirësimet ligjore të rekomanduara nga grupi i auditimit, ndërkohë që na informon se sistemet e rëndësisë kritike në DPT janë sistemet që ka identifikuar grupi, pra sistemi e-Taxation dhe i Fiskalizimit, megjithëse AKSHI shprehet se është në pritje të të një analize nga Drejtoria TIK e atashuar në DPT për rivlerësimin e indikatorëve dhe kryerjen e analizave përkatëse dhe konkluzioneve për sistemin e-Taxation.

DPT ka shprehur gadishmërinë për zbatimin e rekomandimeve organizative për regjistrimin e të dhënave për aq sa nevojitet të përmbushet nga ana e saj nisur nga kushtet që përcakton ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” ku citohet se: *“Administrimi i bazës së të dhënave shtetërore bëhet në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi. Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji.”*

DPT sqaron se me observacionet e saj se në morinë e komunikimeve me AKSHI-n ka shprehur vazhdimisht problematikat mbi projektin e propozuar nga AKSHI “Përmirësimi i sistemit e-taxation” të ndryshuar në vitin 2022 pa asnjë argumentim dhe pa asnjë korrespondencë me DPT-n. Termat e referencës të dërguara nga AKSHI në përgjigje të nevojave urgjente për përmirësim hardware dhe software të sistemit e-taxation, janë të ndryshme nga ato që AKSHI ka përcjellë në shkurt 2022. Nevojat për investim të kërkuara nga DPT në shkurt 2022, janë përcjellë nga ish drejtori i IT në këtë periudhë tek AKSHI. DPT disponon një fond prej 120 milion lekë të miratuara në vitin 2022 për rritjen e kapacitetit e cila nuk është realizuar ende. Kjo vlerë është planifikuar për rritjen e kapacitetit dhe jo për mirëmbajtjen apo dhe zhvillimin e sistemit e-taxation megjithëse nevoja e zhvillimit të këtij sistemi DPT sqaron se nuk ka ardhur prej saj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se disponojmë të gjithë komunikimin shkresor ndërmjet dy institucioneve AKSHI-t dhe DPT-s për situatën kritike ku ndodhet sistemi e-Taxation si dhe për mungesën e dakortësisë ndërmjet institucioneve se përgjegjësi e kujt është funksionaliteti i sistemit e-Taxation e rrjedhimisht dhe investimet në drejtim të tij.

Për sa më sipër, qëndrimi i grupit të auditimit do të jetë i njëjtë në përmirësimet ligjore dhe ato organizative që rekomandohen në këtë Raport përfundimtar Auditimi.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemi e-Taxation është transferuar nga një infrastrukturë kritike në një infrastrukturë të rëndësishme me përditësimet e infrastrukturave miratuar me VKM nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave”, megjithëse rëndësia e tij është jetike jo vetëm për funksionimin e DPT, por për të gjithë sistemet informatike me të cilat japin dhe marrin të dhëna në sistemin e-Taxation. Të dhënat e sistemit e-Taxation i nevojiten dhe sistemit të Fiskalizimit, ku të dhënat e tatimpaguesve kalojnë në sistemin e Fiskalizimit në fund të çdo dite që do të thotë se në mungesë të të dhënave nga e-Tax funksionimi i rregullt i Fiskalizimit është i cenuar në lidhje me: subjektet e reja, ndryshimet e të dhënave për statusin e aktivitetit, niveli i taksimit, ndryshimet tek punonjësit si dhe kalimi automatik i librave të shitjes dhe të blerjes.

Sistemi i pajisjeve fiskale Nexus i kategorizuar si sistem kritik nuk është më në përdorim. DPT-s si Operator Administrues nuk i është kërkuar mendim dhe nuk është vënë në dijeni për klasifikimin që është bërë nga AKSHI lidhur me kritikalitetin e sistemeve informatike që disponon.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit të marrin masa për të paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimet për ndryshimet ligjore në Shtojcën 1 të VKM nr.761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, ku sistemi e-Taxation nga një sistem i rëndësishëm në Shtojcën 2 të kategorizohet si një sistem kritik në Shtojcën 1, ndërsa sistemi Nexus nga sistem kritik i përcaktuar në Shtojcën 1 të hiqet nisur nga fakti që ky sistem nuk është aktualisht në përdorim nga DPT.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, problemet dhe incidentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh dhe në mungesë të:

- Procedurave të standardizuara mbi ndryshimet, incidentet dhe problemet që kryhen në teknologjinë e informacionit, përfshirë dhe ato emergjente.
- Dokumentimit dhe aprovimit të ndryshimeve që janë kryer në teknologjinë e informacionit dhe sistemet informatike që mbështesin aktivitetin e institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë TIK të AKSHI-t, atashuar pranë DPT, të marrin masa për hartimin e procedurave të standardizuara për ndryshimet që kryhen në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet emergjente. Gjithashtu, DPT të sigurohet për dokumentimin specifik të çdo ndryshimi, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe impaktin që kanë sjellë ndryshimet e aplikuara në sistem e rrjedhimisht në të dhëna.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Manuali për politikën dhe procedurat e drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit është i pa përditësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, megjithëse në këtë dokument citohet se duhet të bëhen

azhornime të herë pas hershme. Struktura e AKSHI-t atashuar pranë DPT i referohet dhe vepron bazuar në këtë manual, megjithëse i pa përditësuar me ndryshimet e ndodhura në strukturat përkatëse të dy institucioneve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e Politikave dhe Procedurave të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, me qëllim reflektimin e ndryshimeve të strukturës dhe të teknologjisë së informacionit, të ndodhura ndër vite.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nuk bëhet dokumentimi sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet DPT dhe AKSHI-t, për shërbimet që ky i fundit ofron, saktësisht për administrimin e incidenteve, problemeve dhe disponueshmërisë. Nuk është e dokumentuar ndarja e përgjegjësisë mbi të dhënat, mënyrat se si garantohen si dhe në rast ndërprerje vazhdimësia e ofrimit të shërbimit duke siguruar në këtë mënyrë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për integritetin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre mbi shërbimet TIK të ofruara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për rishikimin dhe zbatimin e Marrëveshjes në Nivel Shërbimi, duke vendosur zëra të detajuar në përputhje me shërbimet që i ofrohen këtij institucioni.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk ka një regjistër mbi problematikat të çdo Drejtorie Rajonale Tatimore, të cilat raportohen nëpërmjet numrit të telefonit të publikuar në faqen web <https://www.tatime.gov.al/c/9/157/drejtorite-rajonale>, si dhe nuk realizohet delegimi i tyre tek personat përgjegjës.

Nga testimi i numrave të vënë në dispozicion për Tatimpaguesit, rezultoi se:

- Dy numra telefoni nuk ekzistojnë saktësisht Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Tiranë dhe Qendra e Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Kukës;
- Dy numra nuk funksionojnë që i përkasin Qendrës së Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Elbasan dhe Qendrës së Shërbimit për Tatimpaguesit e DRT Lezhë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 9-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë masa për vënien në funksion të numrave të kontaktit që janë të afishuar në faqen web për Drejtoritë Rajonale të Tatimpaguesve, me qëllim garantimin e shërbimit kundrejt qytetareve dhe bizneseve.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPT nuk disponon një infrastrukturë Business Continuity Center (BCC), si dhe nuk ka një plan mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjet nga katastrofat në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pa ndërprerje për sistemet informatike, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për hartimin dhe miratimin e një plani mbi vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat.

6. Titulli i Gjetjes: Nga auditimi mbi strukturën TIK të AKSHI-t, atashuar pranë DPT u konstatua se nga një strukturë e miratuar me 44 punonjës, pranë DPT aktualisht janë 19 pozicione vakante ose afërsisht 43% e vendeve të strukturës. Në Sektorin e Operacioneve, Sektorin e Rrjetit dhe Infrastrukturës, Sektorin e sigurisë së të dhënave si dhe në Sektorin e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së Programeve, rezultoi se janë strukturat me vende vakante me të larta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e TIK të miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me Rregulloren 1.0 , datë 02.12.2008 miratuar nga AKSHI që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Disa nga mangësitë e konstatuara janë:

- Nuk ka një rregullore të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverave;
- Sistemi i kondicionimit nuk ishte efektiv për të arritur ftohjen e duhur të serverave. Një kondicioner punonte në gjendje alert (alarm) dhe tjetri ishte i fikur, duke ndikuar negativisht në mbajtjen e parametrave optimale dhe nuk favorizon qarkullimin natyral të ajrit. Po ashtu dhe kondicioneri back up është në gjendje kritike;
- Sistemin backup UPS aktualisht nuk mundëson një autonomi të infrastrukturës nga ndërprerja e energjisë elektrike. Të dy UPS janë në gjendje alert (alarm);
- Nuk janë kryer kolaudime për sistemin kundër zjarrit;
- Nuk ka të instaluar BMS (Building Managment System) sistemi i alarmit, Sistem i cili sinjalizon problemet me rrymën elektrike, prezencën e ujit, temperaturës, sigurisë së aksesit në ambientin fizik;
- Nuk ka raporte periodike për verifikimin e logeve të aksesit në dhomën.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrë masa për standardizimin e dhomës së serverave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në përputhje me praktikën më të mira, si dhe standardet e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit e jashtëm të sistemit të Fiskalizimit, u konstatua se:

- Nuk janë aplikuar në sistem kritere të detyrueshme për rritjen e vështirësisë së fjalëkalimit si: fjalëkalim i ndryshëm nga përdoruesi, gjatësia, përfshirja e karaktereve speciale apo numrave si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij, me qëllim rritjen e sigurisë në identifikimin e përdoruesit;
- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikën e implementuar për përdoruesit fundor të sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre të aplikohen, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.
- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikën e implementuar për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b, të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK

me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrin masa për dokumentimin politikat e sigurisë për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, sipas përcaktimeve rregullatore të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit aktiv, të ndarë sipas roleve përkatëse në sistemin e e-Taxation, u konstatua se:

- Në 2 raste kërkesa për mbylljen e përdoruesve, është bërë rreth 2 muaj më vonë se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me DPT;
- 10 Përdorues të cilët kanë ushtruar auditime të jashtme në periudha të caktuara në DPT rezultojnë me status aktiv megjithëse ushtrimi i detyrës ka përfunduar;
- Në 2 raste nuk është bërë kërkesë për mbyllje të përdoruesve;
- 6 punonjës të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me rol të miratuar janë përdorues aktiv;
- Janë miratuar formate për krijim dhe mbyllje llogarie në sistemin e-Taxation, por nuk ka formate të hartuara për ndryshim llogarie nga një rol në një tjetër për punonjës që ndryshojnë pozicionin në strukturë;
- Ka përdorues që nuk janë të unifikuar pasi nuk kanë të drejta të njëjta si kopjimi dhe eksporti i të dhënave;
- Drejtorët e Drejtorive megjithëse është përcaktuar në Rregulloren për Sigurinë e Informacionit pika 4.1 nuk monitorojnë nëse janë zbatuar nga struktura e IT-së, kërkesat për hapje, ndryshim dhe mbyllje llogarie, për të siguruar akses të sigurtë;
- Nga auditimi mbi përdoruesit aktiv, të ndarë sipas roleve përkatëse në Sistemin e Fiskalizimit, u konstatua se:
 - Me emërtimin “Shofer” janë aktiv 26 përdorues të cilët nuk kanë asnjë rol të miratuar;
 - Me emërtimin “Pastrues” janë aktiv 19 përdorues të cilët nuk kanë asnjë rol të miratuar;
 - Me emërtimin “Korrier” janë aktiv 4 përdorues të cilët nuk kanë asnjë rol të miratuar;
 - Me status aktiv janë 55 përdorues të cilët nuk identifikohet se çfarë procesesh mbulojnë në sistem;
- Gjatë auditimit u kërkua lista e punonjësve të larguar nga DPT për periudhën Janar 2021 deri në Mars 2023, mbi të cilat u kryen verifikime dhe rezultoi se janë aktivë 13 punonjës; Janë miratuar formate për krijim dhe mbyllje llogarie në sistemin e Fiskalizimit, por nuk ka formate të hartuara për ndryshim llogarie nga një rol në një tjetër për punonjës që ndryshojnë pozicionin në strukturë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të marrin masa për sistemimin e problematikave mbi përdoruesit aktivë renditur më sipër të cilët rezultojnë aktivë megjithëse janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Gjithashtu, të merren masa për ç’aktivizimin e të gjithë përdoruesve të cilët nuk janë të lidhur me përdorues të identifikueshëm.

Menjëherë

9.2 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa për hartimin e procedurave të plota për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve të cilët bazuar në pozicionin e tyre nevojitet të aksesojnë sistemet informatike dhe të dhënat që ruhen në këto sisteme.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rregulloren dhe manualin e përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Kontratave, që shërbejnë si dokumentacionin udhëzues për ndjekësit e kontratës, si dhe nëpunësin zbatues punonjës të DPT-s, u konstatua se nuk jepen udhëzime:

- Se veprime kryhen nga përdoruesi që është në rolin ndjekës i kontratës dhe punonjës i financës, dy role që përdoren nga DPT;
- Mbi rastet që kthehen për korrigjim, dokumentet kthehen “në grup” apo vetëm dokumenti ku është konstatuar një parregullsi apo mangësi;
- Nënshkrimi elektronik kryhet për secilin dokument apo në të njëjtën kohë për gjithë grupin e dokumenteve;
- Se cili dokument periodik protokollohet, si element kontrolli i ndjekësve të kontratës;
- Se cili dokument nevojitet të aprovohet dhe nënshkruhet elektronikisht nga ndjekësit dhe cili dokument aprovohet dhe nënshkruhet nga punonjësit e financës;
- Se çfarë raportesh realizohen në këtë sistem si ndjekës kontrate, punonjës finance.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 22-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të kërkojë përditësimin e rregullores së hartuar për pozicionet që DPT angazhon, të cilët janë: ndjekës i kontratës dhe punonjës i financës.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratave nëpërmjet sistemit SMK u konstatuan disa problematika të vetë sistemit që i paraqiten ndjekësit të kontratës dhe punonjësit të financës, të cilat janë:

- Dokumenti i paraqitur nga OE pasi është kthyer nga ndjekësit e kontratës për korrigjim nuk pajiset me numrin e protokollit që ka marrë dokumenti kur ngarkohet për herë të parë, por ndjekësit janë të detyruar të nënshkruajnë dokumentin e radhës pa numër dhe datë protokollit;
- Sistemi është konceptuar dhe ndërtuar për nënshkrime në grup të dokumenteve periodike, si dhe dokumenteve përfundimtare të zbatimit të kontratës, megjithëse aprovimi dhe nënshkrimi i dokumenteve do të duhej të ishte më dinamik, duke patur parasysh se fatura nuk mund të nënshkruhet nëse raporti nuk është pranuar, ose procesverbali i pranimit të shërbimit nuk mund të nënshkruhet përpara se raporti të jetë nënshkruar;
- Plani i zbatimit të kontratës nuk nënshkruhet nga OE dhe ky dokument nuk pajiset me numër dhe datë protokollit;
- Procesverbali i gjeneruar automatikisht nga sistemi në fakt duhet të ishte një akt-pranimi me të drejta editimi dhe jo një model i standardizuar për arsye se grupi në rast se duhet të dokumentojë një veprim, i nevojitet të mbajë një tjetër dokument të quajtur procesverbal dhe ta ngarkojë atë në sistem në formatin pdf si dokumentet e tjerë;
- Dokumentet e ngarkuar nga ndjekësit e kontratës nuk marrin numër dhe datë protokollit;
- Nuk janë mundësuar kërkime me numër protokollit, raporte të ndryshme që nevojiten të gjenerojë çdo përdorues me qëllim kontrollimin e veprime të kryera prej tij;
- Sistemi nuk ka komunikime me sisteme të tjera që të lehtësojë veprimet operationale të punonjësve të financës që kryejnë dhe monitorimin e procesit të nënshkrimit në sistemin e SMK megjithëse ky kontroll mund të ishte zgjidhur automatikisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 22-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të adresojë tek Autoriteti Kontraktor i sistemit të ndjekjes së kontratave - SMK problematikat e konstatuara nga auditimi, për të cilat nevojiten të merren masa sistemuese me qëllim sigurimin e veprimeve të duhura, në dy pozicionet që përfshihet DPT si ndjekës kontrate dhe punonjës finance.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.30, datë 20.10.2022 me objekt “Rritja e Kapaciteteve Hardware për Sistemin e Fiskalizimit-për DPT”, u konstatua se:

- Raporti fillestar nuk është paraqitur brenda afatit 5 ditor sipas përcaktimeve në kontratë.

- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës vetëm në një rast janë bërë përtej afatit 1 muhor, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit;

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.46, datë 06.01.2021 me objekt “Mirëmbajtja e Infrastrukturës hostuese e sistemit e- Taxation për DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, u konstatua se:

- Janë nënshkruar vetëm raportet periodike të periudhave përkatëse, por mungojnë Aktet e Pranimit për shërbimet e ofruara;
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës, janë bërë përtej afateve të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit, prej tre ditësh;
- Pagesat e kryera përkatësisht në Prill, Qershor, Nëntor dhe Dhjetor dhe jo sipas muajve, për shërbimet e ofruara.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës nr.7047, datë 28.12.2020 me objekt “Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash (data center), sistemi telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DRT/DPT (Faza 2)- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, u konstatua se:

- Janë nënshkruar vetëm raportet periodike të periudhave përkatëse të mirëmbajtjes, por mungojnë Aktet e Pranimit për shërbimet e ofruara;
- Aktet e pranimit nuk janë bërë sipas praktikave të ngjashme;
- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës, janë bërë përtej afateve të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, megjithëse në kontratë është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit prej tre ditësh;
- Pagesat e kryera përkatësisht në Prill, Qershor dhe Dhjetor, gjithnjë pas nënshkrimit të dokumenteve, por në afate kohore përtej afatit 30 ditor të përcaktuar për kryerjen e pagesave.

Nga auditimi mbi ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 6756, datë 27.11.2018 me objekt “Përmirësim i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, u konstatua se:

- Nënshkrimet e dokumentacionit periodik nga ndjekësit e kontratës nuk janë bërë duke u bazuar në afate të arsyeshme në kushtet kur në kontratë nuk është përcaktuar qartë periudha e pranimit të raportimit;
- Shënimet e vendosura nga ndjekësit e kontratës në rastet kur është kthyer për korrigjim, nuk japin arsye të plota shëruese për mangësitë apo parregullsitë që janë konstatuar, që do të thotë se komunikimi për korrigjimet e nevojshme që duhet të pasqyrohen nga OE është zhvilluar jashtë sistemit duke mos lenë gjurmë mbi arsyet e kthimit;
- Ndjekësit e kontratës kanë nënshkruar apriori dokumentet që paraqiten nga sistemi për nënshkrim, megjithëse në rastet e kthyera për korrigjim sistemi ju paraqet një dokument pa numër protokollit të pagjurmueshëm që nuk ka elementët e një dokumenti zyrtar.

Nga auditimi u konstatua se nuk është nënshkruar shkresa përcjellëse me protokoll, por nënshkrimi është bërë mbi një shkresë që nuk mban numër protokollit dhe datë duke ndërprerë në këtë mënyrë gjurmimin e dokumentacionit. Nisur nga fakti që ora e nënshkrimit është e njëjtë për çdo anëtar, kjo tregon se ky dokument është paraqitur automatikisht nga sistemi për nënshkrim, pra anëtari nuk ka të drejtë të zgjedhë se cilin dokument do të nënshkruaj e cilin jo, që tregon për një mangësi e sistemit të menaxhimit të kontratave protokollimi i një dokumenti i cili është kthyer për korrigjim.

- Në dokumentin e quajtur “*Procesverbal*” thuhet se “Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës dhe marrjes në dorëzim pasi ka kontrolluar dhe verifikuar shërbimet e mirëmbajtjes për periudhën A - B, merr në dorëzim shërbimin në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës”, data e nënshkrimit të këtij dokumenti është e njëjtë me kohën në të gjitha dokumentet e tjera që janë nënshkruar nga secili anëtar. Kjo tregon se gjenerimi i këtij dokumenti bëhet automatikisht nga sistemi kur anëtari i fundit aprovon dokumentacionin e dorëzuar nga OE, ndërsa nënshkruhet elektronikisht në grup me gjithë dokumentet e tjerë.

- Në sistemin e raportimit të problematikave mbi Fiskalizimin, statusi i çështjeve vendoset nga OE dhe jo nga marrësit e shërbimit, që në fakt duhet të ishte e kundërta. Nga ndjekësit e kontratës nuk është kërkuar që statusi i çështjeve të jetë nën vlerësimin e tyre duke marrë një rol aktiv në ndjekjen e kontratës dhe raportimit periodik si nga DPT-s ashtu dhe nga AKSHI;
- Ndjekësit e kontratës nuk kanë llogaritur asnjë penalitete mbi BOE që ka ofruar mirëmbajtjen megjithëse 9 çështje të hapura për sistemin e fiskalizimit kanë mbetur në statuset: “Waiting for support”, “Pending” dhe “Work in progress”. Nga këto, 5 çështje janë krijuar në vitin 2021, ndërsa 4 prej tyre janë krijuar në vitin 2022.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave renditur më sipër u konstatuan problematika të njëjta, si më poshtë:

- Dokumenti i ngarkuar në sistem si “Plani i zbatimit të kontratës” nuk përmban një numër protokollit dhe datë protokollit;
- Plani i zbatimit të kontratës është nënshkruar me vonesë dhe nuk është nënshkruar nga OE.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 22-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si institucion përfitues i shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit që ofron struktura e AKSHI-t apo Operatorët e kontraktuar prej tij, të angazhojë më shumë se një punonjës në ndjekjen e kontratave me qëllim që ndjekja e kontratave të sigurohet në përmbushjen e saj dhe të mos mbetet në kushtet e një procesi formal të realizimit të saj. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nga ana e saj të informojë dhe trajtojë ndjekësit e kontratave për detyrimet ligjore që nevojitet të plotësohen, nisur nga fakti që puna nëpërmjet një sistemi informatik nuk të përjashton nga respektimi me rigorozitetin e akteve ligjore që rregullojnë ndjekjen e kontratave.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pajisjet fizike të sistemit e-Taxation janë në një situatë tejet kritike. Ky sistem është shumë i rëndësishëm për DPT-n, nisur nga veprimet operacionale që kryhen aty si nga ana e biznesit, administratës tatimore ashtu dhe nga institucionet e tjera me të cilat janë ndërtuar ndërveprime me të dhëna të këtij sistemi. Ky konstatim bazohet në të dhënat mbi hapësirën e lirë në servera dhe në storage e cila paraqitet rreth masës 90%, pra pothuajse në ezaurim. Megjithëse gjatë auditimit në terren u hap procedura për mirëmbajtjen e sistemit e-Taxation, ne vlerësojmë se ndërprerja nuk do të mund të sigurohet, për arsye se sistemet informatike nuk mund të jenë funksional nëse pajisjet janë në ezaurim të hapësirës së tyre dhe funksionojnë në limitet e ciklit jetësor dhe me sisteme operimi jashtë suportit teknik që do të thotë i pasigurt. Risku për ndërprerjen dhe pamundësia për ta venë në funksion në një kohë të shkurtër sistemin e-Taxation është shumë e lartë.

Hapësira fizike e zënë për serverat dhe pajisjet storage me përfundimin e auditimit në terren ishte në masën 90%, pothuajse në ezaurim.

Hapat e ndërmarrë ndërmjet DPT-s dhe AKSHI-t për rinovimin e pajisjeve fizike ku qëndron sistemi e-Taxation janë në nivel diskutimi dhe akoma nuk është arritur në një vendimmarrje. DPT ka planifikuar një fond për të cilin AKSHI shprehet se nuk është i mjaftueshëm, por në kushtet kur DPT nuk i disponon më asetet rrjedhimisht planifikimi i fondeve për rinovim duhet të plotësohet nga administratori dhe poseduesi i këtyre aseteve që është AKSHI.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrin masa për të siguruar pajisjet fizike që nevojiten të rinovohen ku qëndron i hostuar sistemi informatik e-Taxation, i cili ndodhet në kushtet teknike në ezaurim dhe me risk të lartë të ndërprerjes së funksionimit, çfarë do të pengonte aktivitetin e DPT-s dhe të institucioneve të tjera të cilat marrin të dhëna nga ky sistem.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, të dhënat e sistemit e-Taxation dhe sistemit të Fiskalizimit, nuk janë regjistruar si baza të të dhënave shtetërore. Mbi këto sisteme janë ngritur ndërveprime, në kundërshtim me ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” dhe VKM nr. 945, datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandim: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me DPT-n të hartojnë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e-Taxation dhe sistemin e Fiskalizimit me të dhënat e të cilëve janë ndërtuar dhe ndërveprime me sisteme të tjera.

Brenda vitit 2023

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk disponon përdoruesin me të drejta të plota – Owner, megjithëse është përgjegjëse për të dhënat që hidhen në sistemet informatike e-Taxation dhe Fiskalizimi. Përdoruesit me të drejta të plota – Owner të të dhënave i disponon:

- Për sistemin e-Taxation: Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, strukturë e AKSHI-t megjithëse kjo e drejtë nuk është e parashikuar në VKM nr. 673, datë 22.11.2017, si dhe në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet institucioneve AKSHI dhe DPT me nr.160, datë 05.04.2019.

- Për sistemin e fiskalizimit: Operatori Ekonomik që ofron shërbimin e mirëmbajtjes. Mbarëvajtja e këtij sistemi është ofruar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “J”Shpk”, “N” dhe “D” Shpk” që kanë zhvilluar sistemin e Fiskalizimit për vitet 2021-2022 me kontratën nr.6756 datë 27.11.2018, ndërsa me kontratën nr. 51, datë 28.02.2023 shërbimi i mirëmbajtjes ofrohet nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “P” A” dhe “H”.

Në asnjë prej kontratave të mirëmbajtjes nuk cilësohet se përdoruesin me të drejta të plota në bazat e të dhënave nevojitet ta ketë Operatori Ekonomik që do të ofrojë shërbimin e mirëmbajtjes, duke patur në konsideratë që ky përdorues ka të drejta pa limit për të vepruar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 56-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si institucioni i vetëm administrues i bazës së të dhënave të sistemeve informatike që mbështesin funksionalitetet dhe aktivitetin e saj, të marrë masat për menaxhimin e bazës së të dhënave, që përmban të gjitha llojet e aksesit në sistemin e bazës së të dhënave, përfshirë përditësimin e ndryshimin e informacionit të ruajtur; pasi siguria e të dhënave nuk mund të garantohet në mirëbesim.

Menjëherë

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT